UNIVERSITETI POLITEKNIK
FAKULTETI I INXHINIERISË ELEKTRIKE
DEPARTAMENTI I AUTOMATIKËS

DISERTACION

PËR MBROJTJEN E GRADËS SHKENCORE

DOKTOR

"*Metoda programimi dhe aplikime për sistemet e kompjuterizuara me ndjekje automatike të objekteve si dhe me komandim në distancë*"

Përgatitur nga
MSc. Ing Genti PROGRI

Udhëheqës shkencor
Prof. Dr. Petrika MARANGO

Tiranë, 2016

FALENDERIM

Së pari dëshiroj të falenderoj autoritetet e Departamentit të Automatizimit të Fakultetit të Inxhinerisë Elektrike të Universitetit Politeknik që mundësuan realizimin e suksesshëm të këtij punimi të doktoraturës.

Para së gjithash, dua të shpreh mirënjohjen time të thellë dhe falenderimin për udhëheqësin tim Prof. Dr. Petrika Maranga për bashkëpunimin miqësor e shkencor, për udhëheqjen, mbështetjen, këshillat dhe sugjerimet konstruktive gjatë gjithë kohës.

Falenderim të veçantë i shpreh mikut tim Prof. Dr. Genci Capi për disa ide profesionale që ka ofruar.

Falënderoj gjithashtu të gjithë ata që ndihmuan që ky punim të përfundojë me sukses.

Së fundi, falënderoj familjen time për mbështetjen e vazhdueshme e të pakursyer, inkurajimin, durimin, përkrahjen morale e materiale dhe për mirëkuptim gjatë gjithë kohës së kryerjes së punimit.

Disertacioni

paraqitur nga: MSc. Genti PROGRI

për marrjen e gradës shkencore

DOKTOR

TEMA

"***Metoda programimi dhe aplikime për sistemet e kompjuterizuara me ndjekje automatike të objekteve si dhe me komandim në distancë***"

Udhëheqësi shkencor: Prof. Dr. Petrika MARANGO

Mbrohet me datën ____. ____. _____ para jurisë:

1. _____ Kryetar

2. _____ Anëtar (Oponent)

3. _____ Anëtar (Oponent)

4. _____ Anëtar

5. _____ Anëtar

PERMBAJTJA

Indeksi i figurave

Lista e shkurtimeve

I/O	>	Input - Output
LPT	>	Line Printer Terminal
COM	>	Communication Port
USB	>	Universal Serial Bus
NN	>	Neural Network
GA	>	Genetic Algorithm
GUI	>	Graphical user interface
RCM	>	Robot Command Module
DE	>	Depth Estimation
RNA	>	Rrjet nervor artificial
BAM	>	Bluetooth Adapter Module

HYRJE

1.1 Formulimi i objektit.

Realizimi i komandimit prej kompjuterit, të paisjeve me elemente motorike me hapa si dhe e paisjeve robotike, për kryerjen e proceseve të caktuara është një detyrë e rëndësishme. Sistemet komanduese kompjuterike (hardware & software) së bashku me paisjet e tjera lëvizëse si dhe me paisjet sensorë I/O, përbëjnë ato që ne i quajmë paisje robotike. Në atë që përkufizuam si një paisje robotike, sistemet komanduese kompjuterike zënë një vend të rëndësishëm sepse përbëjnë atë që do ta quanim 'trurin' e sistemit robotik. Një sistem komandues kompjuterik do ta përfytyronim të përbërë nga dy pjesë të përshkruara në vijim, të lidhura ngushtë me njëra- tjetrën.

- Pjesa fizike që përfshin kompjuterin, mikrokontrollerin dhe sensorët (I/O). Kjo njihet si pjesa hardware.
- Pjesa e programeve që përpunojnë vlerat e marra nga sensorët (input) si dhe realizojnë komandimet e motorëve. Kjo njihet si pjesa software.

Sistemi komandues kompjuterik emërtohet dhe rregullator i sistemit të kontrollit në terminologjinë e kontrollit automatik të proceseve.
Për sa i takon pjesës hardware dhe pjesës software ato janë të lidhura ngushtësisht me njëra- tjetrën dhe funksionaliteti është rrjedhojë e sinkronizimit të tyre.

1.2 Objektivat përfundimtare që kërkohen të arrihen

Qëllimi kryesor i këtij punimi është të tregojë komandimin e robotit prej kompjuterit, me ndihmën e kamerave, në kontrollin e distancës prej një objekti në lëvizje. Për realizimin e kësaj detyre duhet të zhvillohen disa hapa që janë :

- Mënyrat e komandimit të motorëve me hapa prej kompjuterit, në funksion të portës I/O ku lidhet indirekt paisja motorike, si dhe metoda programimi në mjedise të ndryshme programimi.
- Lokalizim i objekteve që vëzhgohen në imazhet e marra prej kamerave.
- Ndjekja e objekteve në fushën e imazhit të kamerave.
- Përcaktimi i distancës së objekteve prej planit të kamerave.
- Komandim i sistemit robotik në ndjekje të objektit në lëvizje.

Nisur nga qëllimi kryesor i përshkruar më sipër, objektivat që kërkohen të arrihen në këtë punim përshkruhen në disa hapa në vijim :

- Realizimi i komandimit të lëvizjes dhe shpejtësisë së motorit me hapa duke shfrytëzuar portat I/O të kompjuterit, të emërtuara LPT, COM, USB. Gjithashtu do të tregohet realizimi i komandimit nga kompjuteri në distancë pa tel (wireless) të motorit me hapa.

- Realizimi teorik dhe praktik i pozicionimit, ndjekjes dhe vlerësimit të distancës së një objekti të shënjuar prej një sistemi kontrolli të përbërë prej një kamere dhe lazerit pikësor, dy kamerash dhe prej një kamere referuar vlerësimit të thellësisë (perspektivës).

- Realizimi i kontrollit të distancës së robotit prej një objekti në lëvizje me ndihmën e kameras duke shfrytëzuar metoda klasike të ndjekjes përcaktuar nga shpejtësia e lëvizjes së objektit.

- Realizimi i kontrollit të distancës së robotit prej një objekti në lëvizje me ndihmën e kameras duke shfrytëzuar rrjetat neurale (NN) të optimizuara me algoritmat gjenetike (GA).

1.3 Struktura e disertacionit

Komandim i motorit me hapa. Motorët me hapa. Parametrat e motorave me hapa EM259/2019033-1 dhe 28BYJ-48 5VDC. Komandimi i motorave me hapa prej kompjuterit nëpërmjet portës LPT. Porta paralele LPT në PC. Skema elektronike. Programet e realizuara në Visual Basic, Matlab për komandimin prej portës LPT	Jan-13 Feb-13
Komandimi i motorave me hapa prej kompjuterit nëpërmjet portës USB.Porta USB në PC. Skema elektronike Programet e realizuara në Visual Basic për komandimin prej portës USB.	May-13 Jun-13
Komandimi nëpërmjet PIC18F4550-I/P Microchip Microcontroller & ULN2803	Jul-13
Komandimi i motorit me hapa në distancë me valë nga kompjuteri	Aug-13
Programet e realizuara në C++ dhe Visual Studio 6 për komandimin në distancë, me valë	Sep-13
Disa metoda optike të vlerësimit të distancës së objekteve prej sistemeve të kontrollit. Metoda e vlerësimit të distancës së objekteve nëpërmjet një sistemi i përbërë prej një kamere dhe lazerit pikësor.. Algoritmika dhe programet e realizuara Visual Studio 6 (VB).	Oct-13
Metoda e vlerësimit të distancës së objekteve nëpërmjet një sistemi prej dy kamerash.. Algoritmika dhe programet e realizuara Visual Studio 6 (VB) dhe Matlab R2013b Metoda e vlerësimit të distancës së objekteve prej një kamere referuar vlerësimit të thellësisë (Depth Estimation).	Nov-13
Algoritmika dhe programet e realizuara në Matlab R2013b	Dec-13
Sisteme të thjeshta robotike të komanduara nga kompjuteri në ndjekjen sipas një drejtimi të një objekti të paracaktuar.	Jan-14 Feb-14 Mar-14
Sisteme moderne robotësh të programueshëm. Roboti model iRobot Create.	Feb-14 Mar-14
Specifikime dhe libraria e komandave në mjedisin Matlab.	Apr-14 May-14 Jun-14
Specifikime dhe libraria e komandave në Visual Studio .Net (VB). Komunikimet me kabëll (wire) dhe me valë (wireless and bluetooth)..	May-14 Jun-14 Jul-14
Specifikime dhe libraria e komandave në Visual Studio 6 (VB). Komunikimet me kabëll (wire) dhe me valë (wireless and bluetooth)..	Aug-14 Sep-14 Oct-14
Specifikime dhe libraria e komandave në Basic4Androide (Java). Komunikimet me kabëll (wire) dhe me valë (wireless and bluetooth)..	Oct-14 Nov-14
Përdorimi i sistemit robotik iRobot Create në fusha të ndryshme sociale.	Dec-14
Ndjekja e një objekti prej iRobot Create sipas metodave klasike të ndjekjes përcaktuar nga shpejtësia e lëvizjes së objektit.	Jan-15
Teoria e algoritmatve neuronikë (ANN)..	Feb-15 Mar-15
Teoria e algoritmatve gjenetikë (GA)..	Mar-15 Apr-15
Përdorimi i algoritmave neuronikë (ANN) në realizimin e orientimit dhe kontrollit të distancës së iRobot Create prej një objekti në lëvizje...	May-15 Jun-15
Përdorimi i algoritmave gjenetikë (GA) në realizimin e orientimit dhe kontrollit të distancës së iRobot Create prej një objekti në lëvizje. Simulimi i kontrollit të distancës së iRobot Create prej një objekti qëllim në Matlab R2013b.	Jun-15 Jul-15 Aug-15
Realizimi ekperimental i kontrollit të distancës së iRobot Create prej një objekti qëllim në Matlab R2013b	Jul-15 Aug-15 Sep-15 Oct-15 Nov-15
Programet e simulimeve dhe ato në kohë reale Matlab R2013b	Sep- Oct- Nov- Dec-

	15 15 15 15
Prezantimi i posterave	Dec-15
Shkrimi i materialeve dhe sistemii i tyre	Aug-13 Dec-15

KAPITULLI II

Hyrje

Në këtë kapitull do të përshkruhen disa mënyra komandimi të drejpërdrejta të një dhe dy motorave me hapa, prej kompjuterit nëpërmjet portave paralele LPT, portave seriale COM, portave USB dhe me valë.
Realizimi i këtyre komandimeve bëhet me ndihmën e qarqeve te integruar ULN2003A, ULN2803A të cilët ndërmjetësojnë lidhjen me motorin me hapa që do të komandojmë.
Gjithashtu do të përshkruhet mënyra e komandimi të shpejtësisë së lëvizjes dhe e pozicionit të motorit me hapa, prej kompjuterit. Kjo pjesë në thelb përmbledh komandimin bazë të një motori me hapa, i përdoruar gjerësisht në robotë, si elementi bazë i robotëve.

Në pjesën e fundit të kapitullit jepen algoritmikat e përdorura dhe programet e realizuara në gjuhët e programimit Visual Studio .Net (VB) [5], Visual Studio 6 (VB) [4], Visual Studio C# [6], Matlab R2013b [14] për komandimin e motorit me hapa. Programet do të sigurojnë të gjitha lëvizjet e mundëshme të motorit me hapa (psh gjysëm hap para, gjysëm hap prapa, hap para, hap prapa, rrotullim me një kënd të përcaktuar etj.)

2.1 Komandimi i motorit me hapa.

Në praktikë problemet inxhinerike janë të vështira të zgjidhen gjithmonë me metodat klasike. Procese të ndryshme kontrollohen nëpërmejt kompjuterave. Kjo bëhet për disa arsye, ku ndër më kryesoret mund të përmendim :

- Një kontroll i tillë siguron drejtimin e proceseve industriale me një algoritëm të parametrizuar, gjë që siguron hapësirë në proceset e kontrollit.
- Me të njëjtin sistem kontrolli të komjuterizuar mund të sigurosh kontroll për disa procese industriale të kategorizuara në një drejtim (programe të ndryshme për procese të ndryshme).
- Një kontroll i tillë siguron drejtimin e proceseve industriale me përpikmëri të programuar duke rritur shkallën e saktësisë.

Në këtë kuadër për të ndërtuar këto sisteme të ndërlikuara kontrolli, nevojitet analiza e kontrolli të elementeve përbërës të tyre. Kjo është arsyeja që në këtë pjesë po japim një mënyrë të realizimit të kontrollit të motorit me hapa prej kompjuterit. Për të realizua këtë qëllim të parë është e nevojshme të japim skemën bazë të kontrollit prej kompjuterit të motori me hapa Fig 2.1 nëpërmjet një qarku të integruar që do të përbëjë modulin e kontrollit (device control).



Fig 2.1. *Skema bazë për kontrollit e motorit me hapa*

Komunikimi me motorin do të realizohet nëpërmjet modulit të kontrollit i cili lidhet me kompjuterin nëpërmjet portës LPT ose USB.

Elementët që do të na nevojiten për kryerjen e detyrës së shtruar janë paraqitur më poshtë :

- **Hardware (pjesët fizike)**
  a. Motor me hapa njëpolar me 5 përcjellësa (5-wire Unipolar stepper motor)
  b. Qarku i integruar ULN 2003 A që do jetë qarku komandues për motorin me hapa.
  c. Fishë mashkull për portën LPT model DB-25 pin.
  d. Stripboard
  e. PC me portë paralele LPT

- **Software (programe)**
  a. Visual Basic 6
  b. Visual Basic Express Editions 2010 (.Net)
  c. Visual C#

2.1.1 Motori me hapa

Në teori një motor me hapa është një paisje shumë e thjeshtë. Një motor me hapa në fakt është një paisje elektromekanike e cila konverton sinjalet pulsante elektrike në lëvizje diskrete mekanike rrotulluese. Lëvizja rrotulluese e rotorit të motorit me hapa është e përcaktuar nga sekuencat e sinjave elektrike që zbatohen në motor [1]. Sekuencat e impulseve të zbatuara do të përcaktojnë dhe mënyrën e rrotullimit të rotorit të motorit. Shpejtësia e zbatimit të tyre do të përcaktojë dhe shpejtësinë e rrotullimit të motorit, brenda disa kufijve që lidhen me parametrat fizikë të paisjes. Në formë simbolike mund të themi se këta motorë rrotullohen vetëm me një hap në çdo çast kohe. Nisur nga kjo veti, motorët me hapa kanë një përdorim shumë të madh, duke u përdorur në të gjitha lëvizjet ku kërkohet kontroll të pozicionit pra kur kërkohen rrotullime me kënde të përcaktuara [3]. Dallohen disa tipe motorësh me hapa. Shkutimisht disa prej modeleve të type po i paraqesim skematikisht më poshtë [3].

a. Variable Reluctance Motor



Motori i mësipërm ka tre pështjella me fundet e tyre të lidhura së bashku. Pozicioni i tyre është me sfazim 30^0 siç tregohet në figurën e mësipërme. Dhënia e tensionit në të tre pështjellat në mënyrë sekuenciale do të siguroje rrotullimin e rotorit të motorit në mënyrë të vazhdueshme.

Pështjella 1 : 10010010010010010010010010
Pështjella 2 : 01001001001001001001001001
Pështjella 3 : 00100100100100100100100100

b. Unipolar Motor



Në këtë tip motori prej secilës pështjellë është nxjerrë prej meseve të tyre daljet 1 dhe 2 siç tregohen në figurën e mësipërme. Pikat 1 dhe 2 do të jenë pikat me potencial pozitiv që do të lidhen me burimin e ushqimit DC. Për të siguruar fushën magnetike në pështjella është e nevojshme që dy skajet e sejcilës prej dy përshtjellave të tokëzohen. Ky motor rrotullohet 30^0 për çdo hap. Dy sekuenca kontrolli për motorin e mësipërm jepen si më poshtë :

Bobina 1a : 10001000100010001000100010001
Bobina 1b : 00100010001000100010001000100
Bobina 2a : 01000100010001000100010001000
Bobina 2b : 00010001000100010001000100010
time --->

Bobina 1a : 11001100110011001100110011001
Bobina 1b : 00110011001100110011001100110
Bobina 2a : 01100110011001100110011001100
Bobina 2b : 10011001100110011001100110011
time --->

Kombinimi i dy sekuencave do të sigurojë rrotullimin e motorit me gjysëm hapi.

Bobina 1a : 11000001110000011100000111
Bobina 1b : 00011100000111000001110000
Bobina 2a : 01110000011100000111000001
Bobina 2b : 00000111000001110000011100

c. Bipolar Motor



Motori në figurën e mësipërme ka të njëjtin ndërtim si dhe motori Unipolar me dy pështjella por pa dalje prej mesit të tyre. Qarku elektrik për ushqimin e pështjellave të motorit është më i ndërlikuar, duke përdorur një qark kontrolli H-Bridge për çdo përshtjellë. Në vazhdim sekuencat me shenjat + dhe − tregojnë polaritetin e tensionit të zbatuar në pështjella prej qarkut të kontrollit H-Bridge.

d. Bifilar Motor



Motori në figurën e mësipërme ka të njëjtin ndërtim si dhe motori unipolar. Tek ky motor pështjellat janë te lidhura në paralel siç tregohet në figurë. Në këtë rast do të kemi tetë

përcjellësa. Dy përcjellësa të çdo bobine janë të lidhur në seri dhe pika e lidhjes është përdorur si dalje duke përdorur motorin bifilar si një unipolar, ndërsa për ta përdorur motorin bifilar si një motor bipolar, telat e secilës bobinë do të lidhen në seri ose paralel.

e. Multiphase Motor



Pështjellat e këtij motori janë të lidhura siç tregohet në figurën e mësipërme. Ato janë të lidhura dy e nga dy në seri sipas skemave trekëndësh, yll ose në yll të hapur në skaje. Tensioni që zbatohet në pështjella jepet nëpërmjet qarkut të kontrollit H-Bridge.

Në Fig 2.2 jepet skema principiale e ndërtimit të motorit me hapa me katër pole ose dhëmbë në stator dhe dy pole në rrotor. Rrotori dhe statori janë ndërtuar prej materiali çelik. Statori ka dy çifte pështjellash (bobinash) të lidhura në seri siç tregohet në figurën e mëposhtëme [7].



Fig 2.2. *Skema principiale e motorit me hapa*.

Secili çift pështjellash përbën një fazë të motorit me hapa. Parimi i thjeshtuar i punës i këtyre motorave shpjegohet në Fig 2.3.



Fig 2.3. *Rotullimi i magnetit të përhershëm (rotorit) me hap të plotë.*

Në Fig 2.3-1 rotori ka orientimin e treguar si rezultat i fushës magnetike të krijuar kur në bobinën 1 kalon rrymë e vazhduar. Pas ndërprerjes së impulsit në bobinën 1 dhe lëshimit në bobinën 2, rotori do të marrë pozicionin e ri të treguar në Fig 2.3-2. Më tej rotori kalon në pozicionin drejtuar bobinës 3 treguar në Fig 2.3-3 dhe më tej bobinës 4 treguar në Fig 2.3-4.
Në tabelën e mëposhtme jepet shpërndarja e inpulseve në bobina për të siguruar rrotullimin me hapa.

Impulsi i zbatuar	Bobina 1	Bobina 2	Bobina 3	Bobina 4
1	1	0	0	0
2	0	1	0	0
3	0	0	1	0
4	0	0	0	1

Një motor i shpjeguar si më sipër do të funksiononte me katër hapa. Për të rritur saktësinë e pozicionit një motor i tillë do të mund të funksiononte edhe me gjysëm hapi. Në këto kushte një motor që funksionon me 4 hapa ose 90 gradë për hap, në rastin e rrotullimit me gjysëm hapi do të realizonte një rrotullim të plotë pas 8 hapash ose 45 gradë për hap. Për të siguruar rrotullimin me gjysëm hapi, tensionet nëpër bobina në momente të caktuara të kohës do të jepeshin siç tregohet në Fig 2.4.



Fig 2.4. *Rotullimi i magnetit të përhershëm (rotorit) me ½ hapi.*

Në tabelën e mëposhtme jepet shpërndarja e impulseve në bobina për të siguruar rrotullimin me ½ hap.

Impulsi i zbatuar	Bobina 1	Bobina 2	Bobina 3	Bobina 4
1	1	0	0	0
2	1	1	0	0
3	0	1	0	0
4	0	1	1	0
5	0	0	1	0
6	0	0	1	1
7	0	0	0	1
8	1	0	0	1

Përveç rrotullimeve me gjysëm hapi dhe me hap të plotë, më këtë motor mund të realizohet edhe një rrotullim hap i plotë me pozicionim midis dy bobinave. Kjo lëvizje realizohet atëhere kur tensioni zbatohet njëherësh në dy bobina të njëpasnjëshme si në Fig 2.5.



Fig 2.5. *Rotullimi i magnetit të përhershëm (rotorit) me hap të plotë me pozicionim midis dy bobinave.*

Në tabelën e mëposhtme jepet shpërndarja e impulseve në bobina për të siguruar rrotullimin me hap të plotë me pozicionim midis dy boboinave.

Impulsi i zbatuar	Bobina 1	Bobina 2	Bobina 3	Bobina 4
1	1	1	0	0
2	0	1	1	0
3	0	0	1	1
4	1	0	0	1

Në mënyrë të përmbledhur llogaritja e këndit të rrotullimit të rrotorit te motorit do të bëhej në këtë mënyrë :

$$\theta_{rrot} = \frac{360^0}{S}$$

$$S = m \cdot N_r \qquad (2.1)$$

$ku: m =$ numri i fazave

$N_r =$ numri i çift dhëmbëve të rrotorit

Për motorin e marrë në trajtimin teorik llogaritja e këndit të rotullimit do të bëhej si në vijim :

$$m = 2$$
$$N_r = 2 \qquad (2.2)$$
$$S = m \cdot N_r$$
$$\theta_{rrot} = \frac{360^0}{S} = 90^0 \text{ për hap}$$

Përgjithësisht këndi i rrotullimit në motorët me hapa të sotëm është 5^0.

2.1.2. Parametrat e motorave me hapa EM259/2019033-1 dhe 28BYJ-48 5VDC.

Motori që ne do të përdorim në trajtimet e mëposhtëme do të jetë një motor Uniolar [1].
Për kryerjen e provave u përdor një motor printeri Lx300+ (bipolar motor) i cili është motor me 4 përcjellësa dalës (dy bobina të pavarura) dhe motori me hapa model 28BYJ-48 5VDC [15]. Pas modifikimit të motorit të printerit Lx300+, duke nxjerrë pikat e mesit të secilës prej bobinave u sigurua motori me hapa i cili skematikisht është përdorur në skemat elektronike të dhëna në vijim.

Parametrat e motorit me hapa model EM259/EM221/EM211/2019033-1 janë :

Rated voltage : 12VDC
Number of Phase 4
Speed Variation Ratio 1/64
Stride Angle 5.625° /64
Frequency 100Hz
DC resistance 50Ω±7%(25℃)
Idle In-traction Frequency > 600Hz
Idle Out-traction Frequency > 1000Hz
In-traction Torque >34.3mN.m(120Hz)
Self-positioning Torque >34.3mN.m
Friction torque 600-1200 gf.cm
Pull in torque 300 gf.cm
Insulation grade A

Parametrat e motorit me hapa model 28BYJ-48 5VDC janë :



Rated voltage : 5VDC
Number of Phase 4
Speed Variation Ratio 1/64
Stride Angle 5.625° /64
Frequency 100Hz
DC resistance 50Ω±7%(25℃)
Idle In-traction Frequency > 600Hz
Idle Out-traction Frequency > 1000Hz
In-traction Torque >34.3mN.m(120Hz)
Self-positioning Torque >34.3mN.m
Friction torque 600-1200 gf.cm
Pull in torque 300 gf.cm
Insulation grade A

2.2. Komandimi i motorave me hapa prej kompjuterit nëpërmjet portës LPT

Realizimi i komandimit të motorit me hapa prej kompjuterit nëpërmjet portës paralele LPT jepet skematikisht nëpërmjet Fig 2.6 [16].



Fig 2.6. *Skema e bazë e komandimit të motorit nëpërmjet modulit të ULN2003*



Fig 2.7. *Komandimi i* motorit *28BYJ-48 nëpërmjet modulit të ULN2003*

2.2.1. Porta paralele LPT në PC.

Një portë paralele është një socket në kompjutera që mundëson lidhjen e tyre me një numër të madh paisjesh si printera, skanera, modema dhe disa web kamera. Në kohët e sotme, kjo portë në bordet kryesore nuk po montohet duke siguruar uljen e kostos së paisjeve. Porta në fjalë ka 25 kontakte (pins) dhe qëllimi i tyre shpjegohet në Fig 2.8 [17].



Fig 2.8. *Porta DB - 25 pin*

Shpjegimi më i hollësishëm i kontakteve të kësaj porte jepet në tabelën e mëposhtëme.

Pin-i	Emri	Përshkrimi
1	Strobe	Gjendja e këtij pin-i është me nivel (1) kur nuk kemi dërgim të dhënash në portë. Kur prej kompjuterit dërgohet 1 byte informacion në portë, gjendja e këtij pin-i kalon në (0).
2 - 9	D0 - D7	8 pin-et ku jepen datat e dërguara nga kompjuteri.
10	nAck	Dërgim sinjali për pranim informacioni nga printeri për në kompjuter.
11	Busy	Kur printeri është duke trajtuar të dhënat, gjendja e këtij pin-i është (1) . Gjendja e tij do të ndryshojë atëhere kur të dhënat do të kenë përfunduar së trajtuari.
12	Paper Out	Nëpërmjet këtij pin-i printeri i tregon kompjuterit nëse letra në printer është apo mungon.
13	Select	Nëpërmjet këtij pin-i tregohet gjendja gati ose jo gati e paisjes së lidhur në portë.
14	Autofeed	Nëpërmjet këtij pin-i kompjuteri dërgon sinjal për tërheqjen e letrës brenda printerit.
15	Error	Nqs printeri ka ndonjë problem atëhere pin-i 15 kalon prej nivelit (1) në (0) prej printerit duke siguruar që në kompjuter të identifikohet gabimi.
16	Initalize	Ky pin merr vlerën (0) sa herë që një punë e re do të shkojë në printer.
17	Select-In	Pin 17 përdoret nga kompjuteri për të shkëputur printerin prej tij nëpërmjet komunikimit.
18-25	Ground	Pin-e të tjera të pa përdorshme për rastet në trajtim.

2.2.2. Skema elektronike.

ULN2003 është një qark monolit për tensione dhe rryma të mëdha të siguruara nga skemat Darlington Fig 2.9. Ai është i ndërtuar nga shtatë çifte Darlington me emiter të përbashkët. Çdo çift

Darlington është i përbërë nga dy tranzistorë dypolarë. ULN2003 i përket familjes së ULN200X të qarqeve të integruar (ICs). ULN2003 punon me tension + 5 TTL (Transistor-Transistor Logic), nga paisja logjike CMOS. Ky qark i integruar ka një përdorim të gjerë si një rele e komanduar. Përdorimin më të rëndësishëm e ka për komandimin e motorëve me hapa.



Fig 2.9. *Qarku ULN2003.*

Në Fig 2.10 jepet skema elektronike e ndërtimit të brendshëm për 1H1D të qarkut ULN2003.



Fig 2.10. *Skema e detajuar për 1H1D në qarkun ULN2003.*

Në skemën e Fig 2.11 kompjuteri nuk është paraqitur por në vend të tij jepet vetëm porta LPT DB-25 pins. Daljet prej saj shkojnë në qarkun e integruar ULN2003A dhe më tej në motorin me hapa.



Fig 2.11. *Skema e detajuar e lidhjes së elementëve për realizimin e komandimit nga porta LPT .*

Pin-i D0 i portës së kompjuterit lidhet me pin-in (1) tek ULN2003.
Pin-i D1 i lidhet me pin-in (2) tek ULN2003.
Pin-i D2 i lidhet me pin-in (3) tek ULN2003.
Pin-i D3 i lidhet me pin-in (4) tek ULN2003.

Nga ana e motorit me hapa, skema e lidhjes realizohet nga pin-et 16, 15, 14, 13 me katër fijet e motorit duke respektuar rreshtimin e tyre. Toka e sistemit lidhet në pin-in 8. Ushqimi +12 V – +24 V jepet në pin-in 9.
Në Fig 2.12 jepet mënyra e realizimit të komandimit të dy motorëve me hapa duke shfrytëzuar të njëjtën portë LPT të kompjuterit. Kjo do të thotë se me një 8 bit data (1 byte) përcaktojmë një gjendje të të dy motorëve.



Fig 2.12. *Skema e detajuar e lidhjes së elementëve për realizimin e komandimit të 2 motorëve me të njejtën portë LPT*

2.2.3. Programet e realizuara në Visual Basic, Matlab për komandimin prej portës LPT

Përdorimi i portës paralele LPT shpjeguar ne paragrafin 2.2, është një mënyrë e thjeshtë për të realizuar komunikimet me pasisje të ndryshme. Ky komunikim ka qenë i drejtpërdrejtë në fillim (në versionet e para të sistemeve operative Windows) duke u realizuar me komandat *inportb() dhe outportb()*. Në versionet e sotme të sistemit operativ Windows, komunikimi realizohet nëpërmjet librarisë *inpout32.dll*. Shfrytëzimi i kësaj librarie u bë mënyra më e e mirë dhe e pagabueshme për të komunikuar me portën paralele LPT.

Përdorimi i *inpout32.dll* në tre gjuhët e programimit *C# , Visual Basic 6 dhe Visual Basic .Net* jepet si më poshtë.

C#:

```
private class PortAccess
{
   [DllImport("inpout32.dll", EntryPoint="Out32")]
   public static extern void Output(int address, int value);
}
```

Visual Basic 6 :

```
' Inp dhe Out deklarimet per porten I/O duke perdorur inpout32.dll.

Public Declare Function Inp Lib "inpout32.dll" _
Alias "Inp32" (ByVal portaddress As Integer) As Integer

Public Declare Sub Out Lib "inpout32.dll" _
Alias "Out32" (ByVal portaddress As Integer, ByVal value As Integer)
```

Visual Basic .Net:

```
Private Class PortAccess
   Public Declare Sub Output Lib "inpout32.dll" Alias "Out32" (ByVal address As Integer, ByVal value As Integer)
End Class
```

Metoda *PortAccess.Output* merr dy parametra, *adresen (address)* dhe *vleren (value)* . Njohja e adresës së portës paralele LPT bëhet në Control Panel të Windows_it. Adresa e kësaj porte përcaktohet në dritaren e vetive në Windows dhënë në vijim :



Sic shihet në figurën e mësipërme porta LPT ka adresën 0378-037F. Vlera në hexadecimal '0x378', në decimal do të jetë '888'. Nqs do të përdornim portën LPT2 me adresë në hexadecimal '0x278', vlera e saj në decimal do të qe '632' .
Forma e dërgimit të informacioneve binare apo decimale në portë do të jetë nëpërmjet thirrjes së funksioneve si më poshtë :

C#:

```
PortAccess.Output(888, 255);
```

Visual Basic 6 dhe Visual Basic.Net :

```
PortAccess.Output(888, 255)
```

Në funksionet e mësipërme në pjesën e vlerës jepet numri decimal '*255*' i cili në sistemin binary do të shprehej '*1111 1111*'.Dërgimi i '*1111 1111*' do të thotë se gjendjet e portave D0-D7, janë me +5 V (gjendja e tyre '1'). Kalimi i tyre në gjendjet '0' bëhet duke thirrur funksionet :

C#:

```
PortAccess.Output(888, 0);
```

Visual Basic 6 dhe Visual Basic.Net :

```
PortAccess.Output(888, 0)
```

Për të kryer lëvizjen e motorit me hap të plotë kodet që do të përdoreshin për këtë rast do të qenë si më poshtë :

C#:

```
PortAccess.Output(888, 1);          // 1 decimal = 0001 binary. This will set D0 to high
System.Threading.Thread.Sleep(100); // delay
PortAccess.Output(888, 2);          // 2 decimal = 0010 binary. This will set D1 to high
System.Threading.Thread.Sleep(100); // delay
PortAccess.Output(888, 4);          // 4 decimal = 0100 binary. This will set D2 to high
System.Threading.Thread.Sleep(100); // delay
PortAccess.Output(888, 8);          // 8 decimal = 1000 binary. This will set D3 to high
```

Visual Basic 6:

```
Output(888, 1)                  ' 1 decimal = 0001 binary. This will set D0 to high
Sleep(100)                      ' delay
Output(888, 2)                   ' 2 decimal = 0010 binary. This will set D1 to high
Sleep(100)                      ' delay
Output(888, 4)                  ' 4 decimal = 0100 binary. This will set D2 to high
Sleep(100)                      ' delay
```

Visual Basic.Net :

```
PortAccess.Output(888, 1)           ' 1 decimal = 0001 binary. This will set D0 to high
System.Threading.Thread.Sleep(100)  ' delay
PortAccess.Output(888, 2)           ' 2 decimal = 0010 binary. This will set D1 to high
System.Threading.Thread.Sleep(100)  ' delay
PortAccess.Output(888, 4)           ' 4 decimal = 0100 binary. This will set D2 to high
System.Threading.Thread.Sleep(100)  ' delay
PortAccess.Output(888, 8)           ' 8 decimal = 1000 binary. This will set D3 to high
```

Për të realizuar dërgimin e informacioneve binare në drejtim të bllokut të kontrollit të motorit, duhet të realizohet kalimi i këtij informacioni prej formës binare në atë decimale. Për të realizuar këtë konvertim përdoret funksioni i mëposhtëm i shkruar për Viasual Basic 6 dhe Visual Basic .Net.

```
Public Function BinToDec(BinNum As String) As String
  Dim i          As Integer
  Dim DecNum     As Long

  On Error GoTo ErrorHandler

'  Cikli binar
  For i = Len(BinNum) To 1 Step -1
    ' Kontrollo stringun per karaktere jo te rregult
    If Asc(Mid(BinNum, i, 1)) < 48 Or _
       Asc(Mid(BinNum, i, 1)) > 49 Then
       DecNum = ""
       Err.Raise 1002, "BinToDec", "Invalid Input"
    End If
     If Mid(BinNum, i, 1) And 1 Then
        DecNum = DecNum + 2 ^ (Len(BinNum) - i)
     End If
  Next i
  BinToDec = DecNum

  Exit Function

ErrorHandler:
  Msgbox "Messazh gabimi ne konvertim :" & " " & Err.Number  &  " " & Err.Desctription
End Function
```

Pamja e një programimi të thjeshtë në Visual Basic 6 për kontrollin e motorit me hapa jepet më poshtë.

Në faqen kryesore të këtij programi demostrues, paraqiten disa mundësi të këtij kontrolli kompjuterik mbi motorin me hapa si psh :

- Rrotullim me frekunca të ndryshme me hap të plotë.
- Rrotullim me frekunca të ndryshme me gjysëm hapi.
- Ndalim të menjëhershëm për cdo gjendje të tij.
- Rrotullime në kahun orar ose në atë jo orar.

Mbështetur në këto ide mund të ndërtohen programe të tjera më të sofistikuara për të realizuar detyra të caktuara të cilat përfshijnë elementet e trajuar në këtë pjesë.

Për të komunikuar me portën LPT prej programit Matlab R2013b [14], për dërgimin e komandave në motor sipas skemës elektronike të përshkruar më sipër, ekzekutohen instruksionet e mëposhtme :

```
dio = digitalio('parallel','LPT1');      % --> Krijohet një object
lines = addline(dio,0:7,0,'out');        % --> Inicializohen pinet 2-9
putvalue(lines,infordata);               % --> Dërgohet 'data' në portë
```

Instruksioni : `dio = digitalio('parallel','LPT1');` krijon një objekt për portë paralele që adresohet tek LPT1.
Instruksioni : `lines = addline(dio,0:7,0,'out');` inicializon pinet 2 deri 9 si pine dalëse, me gjendjet e sinjaleve në vlerat 0 V ose 5 V që korespondojnë me gjendjet binare 0 dhe 1.
Instruksioni : `putvalue(lines, infordata);` kryen dërgimin e paketës `infordata` në portën paralele.

Datat e dërguara `infordata` mund të dërgohen në kodin decimal ose binar si në shembullin e dhënë më poshtë :

```
putvalue(dio,8)
putvalue(dio,[0 0 0 1 0 0 0 0])
```

Kështu për të ndaluar rrotullimin e motorit instruksionet që do të përdoren jepen si më poshtë :

```
dio = digitalio('parallel','LPT1');
lines = addline(dio,0:7,0,'out');
putvalue(lines,0);
```

Në Shtojcën-1 po japim programet e realizuara për komandimin e shpejtesisë dhe pozicionit të motorit me hapa prej portë LPT.

2.3. Komandimi i motorave me hapa prej kompjuterit nëpërmjet portës COM

2.3.1. Porta seriale COM në PC.

Një portë seriale është një ndërfaqe fizike në kompjutera që mundëson lidhjen e tyre me një numër të madh paisjesh si printera, skanera, modema. Transferimi i datave nëpërmjet kësaj porte realizohet në hyrje dhe dalje në mënyrë seriale që do të thotë se në çdo çast kohe transmetohet një informacion prej një biti. Në kohët e sotme, kjo portë në bordet kryesore nuk po montohet duke siguruar uljen e kostos së paisjeve. Porta në fjalë ka 9 kontakte (pins) dhe qëllimi i tyre shpjegohet më poshtë.



2.3.2. Skema elektronike.

Në Fig 2.13 jepet mënyra e realizimit të komandimit të motorit me hapa me 6 përcjellësa prej portës seriale RS232 nëpërmjet modulit M2-ENGINE & ULN2803. Qarku ULN2803 siguron rryma më të mëdha në dalje nëpërmjet tranzistorëve të lidhur sipas skemës Darlington.



Fig 2.13. *Skema e detajuar e lidhjes së elementëve për realizimin e komandimit nga porta COM (RS232).*

Moduli M2-ENGINE përfaqëson një qark i cili converton sinjalin e transmetuar nëpërmjet RS232 në format për qarkun ULN2803. Në Fig 2.14 jepet moduli M2-ENGINE së bashku me elementet e tij [8].



Fig 2.14. *Moduli M2-ENGINE.*

1- RS232 RJ45 connector
2- Power ON LED
3- Connection Headers
4- Time Base Quartz Crystal
5- Board Power Supply
6- 5V DC Voltage Regulator
7- RS232 -TTL Interface IC
8- Analog to Digital Converter
9- WiZ232 Microcontroller

Specifikimet për M2-ENGINE jepen si më poshtë :

- Serial Interface: EIA RS232 , 9600 to 115200 Bauds
- Serial Port Connection: RJ45, 8-positions, 8-contacts

- Digital I/O: 24 bits, TTL compatible
- Serial Peripheral Interface Port: 3 wires (Serial Clock, Data Input, Data Output)
- Analog To Digital Converter: 2 channels, 0-5 VDC, 10-bit
- Power Requirements: 7.5 to 12 VDC,100mA
- Dimensions (L,W,H): 28.1 x 117.1 x 29 (mm)

2.3.3. Programet e realizuara në Visual Basic për komandimin prej portës COM



Në Shtojcën-2 po japim programet e realizuara për komandimin e shpejtësisë dhe pozicionit të motorit me hapa prej portës COM.

2.4. Komandimi i motorave me hapa prej kompjuterit nëpërmjet portës USB

Për të realizuar komandimin e motorit Unipolar me hapa me 6 përcjellësa prej portës USB të kompjuterit ndërmjet disa mënyrave që ekzistojnë, do të analizohen dy mënyra të komandimit të motorit me hapa nëpërmjet USB :

- Komandimi nëpërmjet moduli Stepper-Bee
- Komandimi nëpërmjet PIC18F4550-I/P Microchip Microcontroller & ULN2803

Komandimi nëpërmjet moduli Stepper-Bee përshkruhet në paragrafin në vijim.
Komandimi nëpërmjet PIC18F4550-I/P Microchip Microcontroller & ULN2803 do të jepet në kapitullin pasardhës përdorur në zbatime praktike.

2.4.1. Porta USB në PC.

Një portë USB (Universal Serial Bus) është një socket në kompjutera që mundëson lidhjen e tyre me një numër të madh paisjesh. USB ka patur për qëllim zëvendësimin e shumë llojeve të portave seriale dhe paralele, gjithashtu mund të lidhë pajisje periferike të kompjuterit si miun kompjuterik, tastierën kompjuterike, aparate fotografikë dixhitalë, printues, lojra mediatike personale etj. Për shumë nga këto pajisje, USB është bërë metodë standarde lidhjeje. USB është projektuar për

kompjutera personalë, por është bërë e zakonshme edhe në pajisje të tjera si smart phone, videolojrat etj. Posaçërisht USB HardDisk dhe USB Stick janë ndër më të pëlqyerit për bartjen e të dhënave në mënyrë të shpejtë dhe të pa komplikuar. Me disa nga USB-Stick mund të startohet edhe Sistemi Operues. Modeli më i ri është USB 2.0 e cila është më e shpejtë dhe moderne! Një USB-1.1-stick lexon të dhënat me një shpejtësi prej 0,8-0,9 MB/s kurse shkruan me një shpejtësi 0,6-0,8 MB/s, kurse USB 2.0 transferojnë të dhëna deri 480 Mbit/s. Porta në fjalë ka 4 kontakte (pins) dhe qëllimi i tyre shpjegohet më poshtë.



2.4.2. Skema elektronike.

Moduli Stepper-Bee që jepet në Fig 2.15, mund të lidhet njëkohësisht me dy motorë me të cilët komunikon në mënyrë të pavarur. Kjo do të thotë se gjatë kohës së komunikimit me motorin e parë duke kryer lëvizje rrotulluese me hapa në intervale kohore të përcaktuara, mund të komunikohet me motorin e dytë i cili mund të kryejë gjithashtu lëvizje rrotulluese me hapa të pavarura nga i pari dhe në intervale kohore të ndryshme me të parin. Mundësia e komandimit të dy motorëve në mënyrë të pavarur nga njeri-tjetri bën të mundur që moduli Stepper-Bee të ketë një përdorim shumë të madh në aplikacione të shumta që lidhen me komandimin e motorëve me hapa [20].



Fig 2.15. *Moduli Stepper Bee.*

Skema bazë e komandimit të motorëve Uniolarë me hapa nëpërmjet modulit Stepper-Bee jepet në Fig 2.16.



Fig 2.16. *Moduli Stepper-Bee dhe lidhja me dy motorë me hapa.*

2.4.3. Programet e realizuara në Visual Basic për komandimin prej portës USB.

Moduli Stepper-Bee vjen me një mundësi për të gjithë ata përdorues që kërkojnë një zgjidhje të shpejtë duke e përdorur atë në projektet e automatizimit. Ky modul ka një ndërfaqës midis përdoruesit (programuesit) dhe modulit i cili e lehtëson punën e komandimit të motorëve. Ndërfaqësi është një dynamic link library (dll) që emërtohet 'stp.dll', e cila përmbledh një numër funksionesh dhe komandash që krijojnë mundësinë e një komandimi profesional të motorëve me hapa. Dll siguron një ndërfaqe të thjeshtë dhe të shpejtë duke eleminuar problemet e komunikimeve me portën USB, probleme që shfaqen shpesh në dërgimin dhe marrjen e të dhënave në sinkron me paisjen komunikuese.

Funksionet bazë për të realizuar komandimet nëpërmjet stp.dll po i japim në vijim :

```
InitStp()
RunMotor1(steps, interval, direction, outputs)
RunMotor2(steps, interval, direction, outputs)
StopMotor1(outputs)
StopMotor2(outputs)
GetCurrentStatus(M1Active, M2Active, M1Steps, M2Steps, Inputs)
```

Deklarimet në Visual Basic 6.0 dhe Visual Basic.Net janë si më poshtë :

```
Declare Function InitStp Lib "stp.dll" () As Integer

Declare Function RunMotor1 Lib "stp.dll" ( ByVal steps As Integer,
ByVal interval As Integer,
ByVal direction As Integer,
ByVal outputs As Integer,
) As Boolean

Declare Function RunMotor2 Lib "stp.dll" ( ByVal steps As Integer,
ByVal interval As Integer,
ByVal direction As Integer,
ByVal outputs As Integer,
) As Boolean
```

```
Declare Function StopMotor1 Lib "stp.dll" ( ByVal outputs As Integer, ) As Boolean
Declare Function StopMotor2 Lib "stp.dll" ( ByVal outputs As Integer, ) As Boolean

Declare Function SetStepMode Lib "stp.dll" ( ByVal M1Mode As Integer,
ByVal M2Mode As Integer,
) As Boolean

Declare Function GetStatus Lib "stp.dll" ( ByRef M1Active As Integer,
ByRef M2Active As Integer,
ByRef M1Steps As Integer,
ByRef M2Steps As Integer,
ByRef Inputs As Integer,
) As Boolean
```

Para se të përdorim ndonjë nga funksionet e kontrollit të motorit në fillim kalojmë StepperBee në gjendje gati për punë duke përdorur funksionin InitStp().
Vënien në punë të motorit 1 dhe 2 e bëjmë nëpërmjet funksionit RunMotor1 dhe RunMotor2, të cilët kanë katër parametra që do të përcaktojnë mënyrën e punës së motorit. Parametrat e funksionit po përshkruhen më poshtë :

Steps - numër i plotë në diapazonin nga 1 deri 16000 e cila lidhet me numrin e hapave që kërkojmë të kryhen.

Interval - numër i plotë në diapazonin nga 1 deri 16000 e cila lidhet me hohën e ekzekutimit të hapit nga hapi.

Direction - numër i plotë me vlerat 0 ose 1. Zero nënkupton lëvizjen sipas një kahu dhe 1 lëvizjen në kahun e kundërt.

Outputs - numër i plotë me vlerat nga 0 deri 7 e cila nënkupton gjendjet 'on/off' të switching outputs të lidhura me motorin 1 ose 2. Kështu n.q.s Outputs është 5 (e cila në sistemin binar është 00000101) kjo do të thotë se daljet 1 dhe 3 janë 'on'.

Për të kuptuar me shumë funksionimin e këtij funksioni po japim një shembull. Për të rrotulluar motorin sipas drejtimit para me 400 hapa, ku hapi nga hapi bëhet çdo 50 ms, me switchet me gjendje off , komanda që duhet të jepet është :

```
RunMotor1(400, 50, 0, 0)
```

Kur kërkohet që njëkohësisht të kryhet dhe lëvizja e motorit tjetër me 300 hapa, me interval hapi prej hapit 30 ms, sipas drejtimit prapa dhe me switche me gjendjen off, komanda do të jetë :

```
RunMotor2(300, 30, 1, 0)
```

Lëvizjet e motorave me hapa janë të pavarur nga njeri tjetri duke bërë të mundur një rritje të mundësisë për realizimin cilësor të kontrolleve në projektet e automatizimit.

Funksioni GetCurrentStatus() function mund të thirret në çdo moment dhe nëpërmjet tij mund të përcaktohet gjendja e secilit prej motorëve me hapa si dhe gjendja e sinjaleve dixhitale në hyrje të motorëve. Ky funksion ka pesë parametra të cilët përshkruajnë gjendjet e motorëve. Thirrja e tij përshkruhet më poshtë :

```
Dim M1Active, M2Active, M1Steps, M2Steps, Inputs As Integer
GetCurrentStatus(M1Active, M2Active, M1Steps, M2Steps, Inputs)
```

Pas ekzekutimit të funksionit të mësipërm parametrat marrin vlerat që përshkruajnë gjëndjen.

M1Active merr vlerën 1 kur motori 1 është aktivizuar në lëvizje, 0 për motorin 1 të ndaluar.

M2Active	merr vlerën 1 kur motori 2 është aktivizuar në lëvizje, 0 për motorin 2 të ndaluar.
M1Steps	numër i plotë në diapazonin 0 - 16000 që përcakton numrin e hapave që motori 1 ka përfunduar deri në atë moment.
M2Steps	numër i plotë në diapazonin 0 - 16000 që përcakton numrin e hapave që motori 2 ka përfunduar deri në atë moment.
Inputs	numër i plotë në diapazonin 0 - 31 dhe lidhet me gjendjen e switcheve on/off.

Më poshtë po paraqesim GUI e ndërtuar për komandimin e motorave 1 dhe 2 në gjuhën e programimit Visual Basic.Net.



Në Shtojcën-3 po japim programet e realizuara për komandimin e shpejtësisë dhe pozicionit të motorit me hapa prej portë USB.

2.4.4. Komandimi nëpërmjet PIC18F4550-I/P Microchip Microcontroller & ULN2803

Komandimi i motorit me hapa realizohet nëpërmjet PIC18F4550-I/P i cili vë në lëvizje motorin me hapa nëpërmjet ULN2803. Në skemat e mëposhtëme jepet PIC18F4550 dhe emërtimet e kontakteve të tij.
Hapat që ndiqen në komandimin e motorit me hapa jepen në përshkrimin e mëposhtëm.
Programohet PIC18F4550-I/P nëpërmjet programit MicroCode Studio – PicBasic Pro V 3.0.7.0. Me ndihmën e aplikacionit EasyHID USB Wizard i ndërtuar për të punuar me USB 2.0, pjesë e programit PicBasic Pro, gjenerohen dy programe provizorë të kompiluar : i pari për kompjuterin si program PC Host i kompiluar edhe për Microsoft Visual Basic 6.0 dhe i dyti për paisjen (device) PIC18F4550-I/P të cilin e shkarkojmë nëpërmjet USB të kompiluar prej Compiler Proton310. Gjatë ndërtimit të programeve futet në konfigurimet e tyre për të personalizuar programet emri i aplikacionit (ProductID) si dhe një Unique ID (VendorID) për të siguruar personalizimin e programeve të kompjuterit dhe paisjes (PIC18F4550-I/P). Programi në kompjuter (PC Host) përmban një librari dinamike mcHID.dll, funksionet e të cilës si lidhja (connection), dërgimi i

datave (send data), marrja e datave (receive data) dhe shkëputja e lidhjes (disconnection), mund të shfrytëzohen prej aplikacionit GUI të ndërtuar në Microsoft Visual Basic 6.0 prej të cilit dërgohen komandat për rrotullimin e motorit me hapa.



(a)



(b)

(a) *Skema pricipiale elektronike e komandimit të motorit me hapa prej mikrokontrollerit.*
(b) Emërtimet e kontakteve për PIC18F4450

Në vazhdim po japim programin për PIC18F4550-I/P të ndërtuar në MicroCode Studio – PicBasic Pro V 3.0.7.0.

```
' select MCU and clock speed
Device = 18F4550
XTAL = 48
Declare PORTB_PULLUPS 1
' descriptor file, located in \inc\usb_18 - a copy
' is located in the same folder as this file
USB_DESCRIPTOR = "STEPUSBDESC.inc"
```

```
' USB Buffer...
Symbol USBBufferSizeMax = 8
Symbol USBBufferSizeTX  = 8
Symbol USBBufferSizeRX  = 8
Dim    USBBuffer[USBBufferSizeMax] As Byte

' some useful flags...
Dim PP0 As Byte SYSTEM        ' USBPOLL status return
Symbol CARRY_FLAG = STATUS.0  ' high if microcontroller does not have control over the
buffer
Symbol ATTACHED_STATE = 6     ' is USB attached

' ************************************************************
' * main program loop - remember, you must keep the USB      *
' * connection alive with a call to USBPoll, USBIn or USBOut *
' * every couple of milliseconds or so                       *
' ************************************************************
TRISD = %00000000
PORTD = %00000001
GoSub MakeSleep
PORTD = %00000011
GoSub MakeSleep
PORTD = %00000111
GoSub MakeSleep
PORTD = %00001111
GoSub MakeSleep
PORTD = %00000111
GoSub MakeSleep
PORTD = %00000011
GoSub MakeSleep
PORTD = %00000001
GoSub MakeSleep

' ************************************************************

GoSub AttachToUSB
ProgramLoop:
   USBIn 1, USBBuffer, USBBufferSizeRX, ProgramLoop
   PORTD = USBBuffer[0]
   GoTo ProgramLoop

' ************************************************************
' * receive data from the USB bus                            *
' ************************************************************
DoUSBIn:
   USBIn 1, USBBuffer, USBBufferSizeRX, DoUSBIn
   Return

' ************************************************************
' * transmit data                                            *
' ************************************************************
DoUSBOut:
   USBOut 1, USBBuffer, USBBufferSizeTX, DoUSBOut
   Return

' ************************************************************
' * wait for USB interface to attach                         *
' ************************************************************
AttachToUSB:
   Repeat
      USBPoll
   Until PP0 = ATTACHED_STATE
   Return

' ************************************************************
' * wait after command                                       *
```

```
' ************************************************************
MakeSleep:
 For i=0 To 255 Step 1
     For j=0 To 255 Step 1
         For k=0 To 10 Step 1
         Next
     Next
 Next
Return
```

Aplikacioni GUI i ndërtuar në Microsoft Visual Basic 6.0, i cili paraqitet në figurën e mëposhtme, prej të cilit dërgohen komandat për rrotullimin e motorit me hapa para dhe prapa si dhe mund të ndryshohet shpejtësia e rrotullimi. Nëpërmjet D0, D1, D2, D3 që identifikojnë katër portat e PIC18F4550-I/P ku janë lidhur katër portat e ULN2803, kryhet dërgimi i sinjaleve në motor. Parametri 'Interval' te një Timer Control në Visual Basic siguron një shpejtësi të ndryshueshme në rrotullimin e motorit me hapa. Dërgimi i sinjaleve në portat D0, D1, D2, D3 siguron rrotullimin para ose prapa të motorit ndërsa koha e dërgimit të këtyre sinjaleve përcakton dhe shpejtësinë e tij.

GUI për komandimin e motorit me hapa nëpërmjet PIC18F4450-I/P

Në programin e ndërtuar përshkruhen funksionet e komunikimeve si më poshtë :

- Lidhja nëpërmjet portës USB me PIC18F4550 > ConnectToHID (Me.hwnd)
- Ndërprerja e komunikimit me PIC18F4550 > DisconnectFromHID
- Dërgimi i datave në portë për rrotullimin e motorit me hapa :
  BufferOut(0) = 0
  BufferOut(1) = 10
  hidWriteEx VendorID, ProductID, BufferOut(0)
- Ndalimi i rrotullimit realizohet pas thirrjes dhe ekzekutimit të instruksioneve :
  BufferOut(0) = 0
  hidWriteEx VendorID, ProductID, BufferOut(0)

Programin e detajuar po e japim në Shtojcën 3.

2.5. Komandimi i motorave me hapa prej kompjuterit në distancë

Detyra e komandimit të motorit me hapa në distancë është një detyrë e shtruar prej kohësh. Realizimi i saj është bërë në mënyra të ndryshme të lidhura me nivelin e teknologjisë. Në kohët e sotme ky problem është bërë më i thjeshtë nisur nga zhvillimet e mëdha teknologjike dhe ulja e kostove të paisjeve që do të përdoren. Për të realizuar komandimin e një motori me hapa në distancë zgjidhjet që ofrohen janë rrjedhojë e kërkesave të proceseve industriale dhe zhvillimeve shoqërore.

Në këtë pjesë do të parashtroj dy mënyra komandimi që lidhen me kontrollin në distancë midis panelit kompjuterik të komandimit dhe bllokut që merr komandat tek i cili ndodhet dhe motori me hapa.

- Komandimi i motorit me hapa në distancë me valë (wireless) nga kompjuteri.
- Komandimi i motorit me hapa në distancë në LAN dhe WEB nga kompjuteri (trajtimi i këtij problemi nuk është pjesë e këtij materiali por do të jetë një punë e së ardhmes).

2.5.1. Komandimi i motorit me hapa në distancë me valë (wireless) nga kompjuteri.

Realizimi i këtij komandimi do të bëhet bazuar në bllok diagramën e dhënë në Fig 2.17 . Në bllok diagramë jepen të gjithë elementet që nevojiten për të realizuar detyrën e shtruar.



Fig 2.17. *Bllok diagrama e komandimit me vale te motorit me hapa* .

Nga kompjuteri (PC) nëpërmjet portës seriale, informacioni (komandat) jepet në hyrjen seriale të microcontrollerit ATMega 2560. Programi i ndërtuar për microcontroller ATMega2560 lexon të dhënat prej portës seriale dhe i kalon të koduara drejt dhënësit valor. Sinjali i transmetuar merret prej marrësit dhe kalon në hyrjen seriale të mikrokontrollerit të dytë ATMega2560 (ose microcontroller ATMega328) në bllokun e poshtëm në Fig 2.17. Prej microcontroller ATMega2560 (ose microcontroller ATMega328), ku është ekzekutuar programi që përpunon informacionet e marra nga porta hyrëse, sinjalet jepen në modulin ULN2003 (ose ULN2803) që përbën driverin e motorit me hapa. Këto sinjale elektrike ne dalje te modulit ULN2003 (ose ULN2803) vënë në lëvizje motorin me hapa.

Në Fig 2.18 jepen shpjegime mbi portat (pins) e ATMega2560 [19].



Fig 2.18. *Shpjegime për portat e ATMega2560.*

Shpjegime për pinet e burimit të ushqimit :

- V_{in} : *Kur ushqimi i paisjes bëhet nga jashtë nëpërmjet një konvertuesi* $AC->DC$ *përdoret kontakti* V_{in} *për të zbatuar tensionin*.
- $5V$: Arduino ATMega përdor tensionin prej $5V$ për të ushqyer të gjitha pjesët e veta. Tensioni i $5V$ mund të sigurohet nëpërmjet portës USB ose prej një gjeneratori tensioni ku për këtë rast tensioni zbatohet në V_{in} .
- $3.3V$: Në Arduino ATMega mund të zbatohet një tension $3.3V$ prej një gjeneratori tensioni. Në këtë rast rrymat maksimale të punës janë të rendit $50mA$.
- GND : Pika me potencial zero.

Arduino ATMega2560 ka 51 pine (pins) hyrëse dhe dalëse digitale që shërbejnë për të siguruar komunikimet me paisje të tjera (nga këto 15 pine mund të shërbejnë si dalje PWM (Pulse-Width Modulation)), 16 hyrje analoge, 4 UARTs (hardware serial ports), 1 element 16 MHz crystal oscillator, 1 USB connection, 1 power jack, 1 ICSP header dhe 1 buron reset.

Secili prej pineve tyre mund të këtë dy nivele tensionesh $0\ V$ (gjendja '0') dhe $5\ V$ (gjendja '1'). Rezistencat elektrike të hyrjes së tyre janë në vlerat $20-50\ \Omega$. Rrymat maksimale që lejohen në këto kontakte (pins) janë të rendit $40mA$. Më poshtë po japim specifikimet e mikrokontroller ATMega2560 :

Microcontroller ATmega2560
Operating Voltage 5V
Input Voltage (recommended) 7-12V
Input Voltage (limits) 6-20V
Digital I/O Pins 54 (of which 15 provide PWM output)
Analog Input Pins 16
DC Current per I/O Pin 40 mA
DC Current for 3.3V Pin 50 mA
Flash Memory 256 KB of which 8 KB used by bootloader
SRAM 8 KB
EEPROM 4 KB
Clock Speed 16 MHz

Në Fig 2.19 jepen paisjet dhënëse dhe marrëse model STT-433 RF Transmitter/Receiver [18].



Fig 2.19. *Dhënësi dhe marrësi model STT-433 RF Transmitter/Receiver.*

Dhënës-Marrësi model STT-433 RF është një paisje me një përdorim jo të vogël dhe me një kosto të ulët. Dhënës-Marrësi STT-433 RF është një transmetues ideal për aplikacione ndërlidhjeje të tipit remote control. Për të vënë në punë këtë transmetues është i nevojshëm një burim ushqimi me tension në kufijtë $1.5-12\,V$. Në përbërje të tij gjendet një SAW-stabilized oscillator, për kontrollin sa më të saktë të frekuencave të sinjaleve.

Karakteristikat e STT-433 RF Transmitter/Receiver jepen si më poshtë :

Parametrat	**Simboli**	**Min.**	**Tipi**	**Max.**	**Njesia**
Operating Voltage	*Vcc*	*4.5*	*5.0*	*5.5*	*VDC*
Operating Current	*Icc*	-	*3.5*	*4.5*	*mA*
Reception Bandwidth BW	*rx*	-	*1.0*	-	*MHz*
Center Frequency	*Fc*	-	*433.92*	*MHz*	*MHz*
Sensitivity	-	-	*-105*	-	*dBm*
Max Data Rate	-	300	*1k*	*3K*	*Kbit/s*
Turn On Time	-	-	*25*	-	*ms*
Operating Temperature	*Top*	-10	-	*+60*	*°C*

Për të shpjeguar pinet e STT-433 RF Transmitter/Receiver po japim skematikisht emërtimet e tyre në Fig 2.20 dhe Fig 2.21.



Fig 2.20. *STT-433 RF Transmitter.*

Në Fig 2.20, DATA jep kontaktin ku dërgohet sinjali pas kodimit të kryer në daljen e mikrokontrollerit Tx0.



Fig 2.21. *STT-433 RF Receiver.*

Në Fig 2.21, DATA jep kontaktin ku merret sinjali dhe më pas jepet në hyrjen Rx0 të mikrokontrollerit ku bëhet dhe dekodimi.

Në Fig 2.22 jepet moduli ULN2003 me dioda led që shërben si modul ndërmjetës midis mikrokontroller ATMega dhe motorit me hapa. Gjatë dhënies së impulseve të ndryshme në hyrje, blloku i diodave led (A B C D) shpreh visualisht nivelet e tyre në pinet 1N1, 1N2, 1N3 dhe 1N4. I njëjti modul ndërtohet edhe me CIs ULN2803, duke zëvendësuar ULN2003 me ULN2803 [15][16].



Fig 2.22. *Moduli ULN2003.*

Pasi kemi përshkruar të gjithë modulet që do të përdorim në kryerjen e komandimit me valë të motorit me hapa prej kompjuterit, jemi gati të japim dhe skemën e përgjithshme të punës. Në Fig 2.23 dhe Fig 2.24 jepen dy skema funksionale të komandimit me blloqet IC të motorit me hapa.



Fig 2.23. *Skema e komandimit me valë të motorit me hapa duke përdorur dy qarqe ATMega2560.*



Fig 2.24. *Skema e komandimit me valë të motorit me hapa duke përdorur ATMega2560 dhe ATMega328.*

2.6. Programet e realizuara në C++ dhe Visual Studio 6 për komandimin në distancë, me valë

Programet që realizojnë komandimin me valë të motorit me hapa përbëhen prej tre pjesësh. Programi i parë, realizuar në Visual Basic 6.0 që përbën dhe GUI (Fig 2.25), siguron mundësinë e dërgimit të komandave drej mikrokontrollerit ATMega2560 nëpërmjet portës seriale të kompjuterit (COM 1-9). Pas zgjedhjes së portës seriale, përcaktohet bound rate për portën në vlerat (9600, N, 8, 1), që përcaktojnë shpejtësinë e komunikimit të kompjuterit (nëpërmjet portës seriale) me

mikrokontrollerin ATMega2560 (nëpërmjet portës seriale 0 në mikrokontroller). Instruksionet që dërgojnë komandat (për rrotullim të motorit sipas një drejtimi të caktuar me shpejtësi të ndryshueshme) drejt portës së mikrokontrollerit ATMega2560 janë :

```
CommObject.Output = "+"      ' (+) karakteri për rritje shpejtësie rrotullimi për motorin ( x 2)
CommObject.Output = "-"      ' (-)  karakteri për ulje shpejtësie rrotullimi për motorin ( / 2)
CommObject.Output = "R"      ' (R) karakteri për rrotullim orar
CommObject.Output = "L"      ' (L) karakteri për rrotullim anti-orar
CommObject.Output = "0"      ' (0) karakteri për resetim gjendjesh
```

Karakteret komanda të dërguara nga GUI, lexohen prej programit të startuar në mikrokontrollerit ATMega2560.



Fig 2.25. *GUI ne VisualBasic 6.0.*

Programi në mikrokontrollerin ATMega2560, i ndërtuar në C++, lexon datat e hyra në portën seriale 0 dhe në bazë të tyre, sipas programit, dërgon në portën seriale 1, të lidhur me transmetuesin, komandat e koduara. Instruksionet që kryejnë këtë detyrë jepen si më poshtë :

```
void loop() {
// lexoj nga porta seriale 0, dergoj data ne porten seriale 1:
if (Serial.available()) {
char inByte = Serial.read();     (LEXIMI I KARAKTEREVE KOMANDA PREJ SERIAL 0)

// Ndertoj protokollin e komunikimit per dergimin e komandave
if(inByte=='l'||inByte=='L') {                      // drejtimi antiorar
        writeUInt(100);          (DERGIMI I KOMANDAVE TE KODUARA DREJT SERIAL 1)
        blink(4);
        }
    else if(inByte=='r'||inByte=='R') {             // drejtimi orar
        writeUInt(101);          (DERGIMI I KOMANDAVE TE KODUARA DREJT SERIAL 1)
        blink(4);
        }
    else if(inByte=='+') {                          // rritje e shpejtesise se rrotullimit
        writeUInt(102);          (DERGIMI I KOMANDAVE TE KODUARA DREJT SERIAL 1)
        blink(6);
```

```
        }
    else if(inByte=='-') {                          // ulja e shpejtesise se rrotullimit
        writeUInt(103);          (DERGIMI I KOMANDAVE TE KODUARA DREJT SERIAL 1)
        blink(6);
        }
    else if(inByte=='0'){              // Reset gjendjet
        writeUInt(104);          (DERGIMI I KOMANDAVE TE KODUARA DREJT SERIAL 1)
        blink(8);
        }
    }
}
```

Pas transmetimit prej RF-Transiter, informacion nëpërmjet RF-Receiver hyn në mikrokontroller ATMega2560 (ose ATMega328) në portën seriale 0. Programi në mikrokontrollerin ATMega2560 (ose ATMega328), i ndërtuar në C++, lexon datat e hyra në portën seriale 0 dhe në bazë të tyre, sipas programit, dërgon në pinet [8, 9, 10, 11] impulset e duhura.

```
void loop() {
// print the string when a newline arrives:
rfDataCommand=readUInt(true);                       (LEXIMI I KARAKTEREVE KOMANDA PREJ SERIAL 0)

//kontroll i shpejtesise
if(rfDataCommand==100){
    blink(2);                                       // pulso Led dy here
    stepperDirection=true;                          // drejtimi anti-orar
    }
else if(rfDataCommand==101){
    blink(3);                                       // Pulso Led tre here
    stepperDirection=false;                         // drejtimi orar
    }
else if(rfDataCommand==102){
    blink(4);                                       // Pulso Led kater here
    if(speedDefaind<2048) speedDefaind=speedDefaind*2;
    stringComplete = true;
    }
else if(rfDataCommand==103){
    blink(5);                                       // Pulso Led pese here
    if(speedDefaind>4) speedDefaind=speedDefaind/2;
    stringComplete = true;
    }
else if(rfDataCommand==104){
    blink(6);                                       // Pulso Led gjashte here
    speedDefaind=32;
    stepperDirection = false;
    stringComplete = true;
    }

if(stringComplete){
    OCR1A=(156624/speedDefaind); (NDRYSHIMI I FREKUENCES SE DHENIES SE SINJALEVE NE PINET 8,9,10,11)
    stringComplete = false;
    }
}
// timer 1 interuppt service routine
ISR(TIMER1_COMPA_vect){
    if ((count2 == 0) || (count2 == 1)) {
    count2 = 16;
    }
count2>>=1;
                                                        (DERGIMI I IMPULSEVE NE PINET 8,9,10,11)
if(stepperDirection==false) {
        for (count = 3; count >= 0; count--) {
        digitalWrite(motorPins[3 - count], count2>>count&0x01);
        }
```

```
    }
else if(stepperDirection) {
        for (count = 3; count >= 0; count--) {
        digitalWrite(motorPins[count], count2>>count&0x01);
        }
    }
}
```

Gjendjet në pinet [8, 9, 10, 11] përcillen drejt modulit ULN2003 (ose ULN2803) prej nga më tej në motorin me hapa.
Në Shtojcën-4 po japim tre programet e realizuara për komandimin valor të motorit me hapa, për komandimin e shpejtësisë dhe pozicionit të tij.

Si përfundim mund të themi se :

- Nëpërmjet materialeve të këtij kapitulli u treguan disa mënyra se si mund të kryhet komandimi i motorit me hapa prej kompjuterit, si një prej elementëve kryesorë në paisjet e komanduara dhe robotike, nëpërmjet portave I/O.

- Mënyrat e komunikimeve na tregojnë përparësitë apo problematikat e tyre. Një prej parametrave që specifikon këto mënyra komunikimi lidhet me shpejtësinë e komunikimeve në dërgimin dhe marrjen e të dhënave. Në të gjitha rastet e komunikimeve me motorin me hapa, shpejtësia e dërgimit të komandave (frekuenca e veprimeve komanduese) është jo më e madhe se parametri i frekuencës së motorit me hapa.

KAPITULLI III

Hyrje

Robotistët po punojnë për realizimin e robotëve autonomë të lëvizshëm që mund të performojnë detyra të dobishme në mjediset njerëzore. Këto mjedise janë një sfidë e konsiderueshme për shkak të kompleksitetit të tyre.
Navigimi i robotëve në mjediset njerëzorë është shqyrtuar edhe më parë. Në pjesën më të madhe të teknikave që përdoren, robotët llogaritin distancën dhe zhvendosjen kundrejt objekteve të caktuara, të cila përcaktohen nëpërmjet sensorëve lazër, termike ose ultrasonikë, për të naviguar në mjedise të mbyllura. Megjithatë, disavantazhet e sensorëve lazer, termike dhe ultrasonikë qëndrojnë në faktin që vlerat e marra nga sensorët kërkohen për çdo njësi distance, që do të thotë se për të krijuar një ide të plotë të mjedisit përreth, duhen përdorur një numër i madh sensorësh. Për më tepër, për të arritur llogaritje të sakta, ato do të duhet të vendosen pingul me shënjestrën.
Kohët e fundit, navigimi i robotëve me ndihmën e pamjes vizuale ka tërhequr shumë studiues. Metodat e ndërtuara kanë përfshirë përdorimin e sinjaleve të marra prej sensorëve bazuar në Stereo Vision, Monocular Vision si dhe në kombinimet e pamjeve vizuale me informacionet e sensorëve të tjerë. Metodat gjithashtu ndryshojnë në mënyrën se si ato merren me informacionin e përkohshëm, që nga përpunimi i pamjeve (frame) individuale deri në llogaritjet, rrjedhojë e krahasimeve të shumë pamjeve vizuale të njëpasnjëshme [21].

3.1. Disa metoda optike të vlerësimit të distancës së objekteve prej sistemeve të kontrollit.

Në procesin e kontrollit të pozicionit dhe të shpejtësisë në rastin e ndjekjes së objekteve në sistemet robotike, një vend të rëndësishëm zë përcaktimi i distancës dhe zhvendosjes së sistemit të kontrollit prej objektit në vëzhgim. Ekzistojnë tre teknika tipike për matjen e distancës (position measurement systems -PMS) [27] së një roboti prej një objekti të paracaktuar.
Këto teknika për vlerësimin e PMS-së janë :

- trekëndëshave (triangulation)
- analizimi i skenës (scene analysis)
- afërsia (proximity)

Teknika e trekëndëshave (triangulation) përdor vetitë gjeometrike të trekëndëshit për të llogaritur vendndodhjen e objekteve. Teknika më e njohur është Global Positioning System (GPS). Megjithatë, GPS-i, duke qenë i varur nga sateliti, karakterizohet nga një problem i cili nuk e lejon të përcaktojë me saktësi vendndodhjen e objekteve brenda një ndërtese. Një teknikë e llogaritjes së afërsisë (proximity) përcakton se kur një objekt është afër një vendi të njohur, dhe prania e objektit mund të "ndihet" me anë të analizave për fenomene të ndryshme fizike që shfaqen. Disa teknika të famshme janë duke zbuluar kontaktin fizik ose duke monitoruar Access Point-ët e telefonave celular [28, 29]. Teknika e analizimit të skenës (scene analysis) përdor vecoritë nga vëzhgimi i skenës nga një pikë e caktuar dhe nxjerr konkluzione për vendndodhjen e sistemit të vëzhgimit dhe të objektit që ndiqet. Disa teknika të njohura janë :

- sistemi i radarëve
- sistemi i lokalizimit të pamjeve vizuale

Në teknikën e lokalizimit në ambjente të brendshme, rrezet infrared [28], ultrasonike [33], laser range finder [31, 32], RFID [30] dhe radari janë teknikat më të njohura wireless. Teknologjia infrared përdoret gjerësisht për të lokalizuar vendndodhje të objekteve, por transmetimi i sinjalit dhe

kërkesa lidhen me fushë pamjen që ka sistemi vëzhgues me objektin. Lokalizimi ultrasonik përdor një teknikë që njihet me emrin "time-of-flight" për të përftuar vendndodhjen e objektit në vëzhgim. Megjithatë, përdorimi i ultratingujve kërkon një infrastrukturë të zhvilluar në mënyrë që teknika të jetë e saktë dhe efektive. Matja e distancës me anë të lazerave bëhet duke matur kohën që i duhet dritës së lazerit të reflektohet mbrapsht nga shënjestra dhe të kthehet te dërguesi. Duke qenë se laser range finder është një aparat matës shumë i shpejtë dhe i saktë, përdoret gjërësisht në shumë aplikacione. Në [31, 32], Subramanian dhe Barawid propozuan një sistem drejtuesi automjetesh autonom të bazuar në një laser rangefinder. Laser rangefinder-i u përdor për të përftuar informacionin për distancën e objekteve në ambient që më pas do të përdorej për të naviguar dhe për të shmangur pengesat. Në [33], Thrun solli një metodë navigimi të pavarur të bazuar në një algoritëm të vecantë. Këto punime konfirmojnë që laser rangefinders-at janë të performancave të larta dhe të matjeve të sakta. Megjithatë, perfomanca e tyre e lartë bazohet në hardwaret me kosto të lartë. Lokalizimi i bazuar në RFID, përdor ndjekjen e RF-ve me një lexues me antenë që të lokalizojë objekte, por gjetja e secilës RF mund të funksionojë në distancë afërsisht 4 deri në 6 metra. Për të përmirësuar saktësinë e ulët në lokalizimin e pozicionit, teknologjia e njohur SpotON përdor disa algoritma, të bazuar në analizën e forcës së sinjaleve të radios për ndjijimin e vendndodhjeve 3D. Megjithatë një sistem i tillë nuk është akoma i plotë. Një sistem RADAR, i bazuar në RF, përdor përshtatësin e network-ut 802.11, për të matur fuqinë e sinjaleve në një numër të madh stacionesh bazë. Fatkeqësisht, pjesa më e madhe e rasteve nuk sjell një saktësi të dëshiruar. Në lokalizimin e robotëve kundrejt objekteve, në ambiente të brendshme, pjesa më e madhe e këtyre teknikave valore (wireless) përdoren për të performuar skanime të pengesave statike rreth robotëve, dhe pozicioni llogaritet duke i lidhur ato skanime me një hartë metrike të ambientit. Në ambiente dinamike vecorite e dalluara ndonjëherë nuk janë mjaftueshëm për të vlerësuar lokalizimin.
Siç dihet për të realizuar gjetjen e distancave dhe llogaritjen e zhvendosjeve, ka shumë mënyra bazuar ne fizikën optike, në funksion të paisjeve që përdoren. Një klasifikim i metodave optike i bazuar dhe në dukuritë fizike që shfrytëzohen do të qe si më poshtë [26]:

- Intensity-Based Sensors.
- Triangulation Sensors
- Time-of-Flight Sensors
- Confocal Sensors
- Interferometric Sensors
- Multiple-Wavelength and Scanning Interferometry
- Frequency Modulated Continuous Wave Time-of-Flight

Në këtë punim ne do të merremi vetëm me metodat optike dhe për të qenë të saktë me tre prej tyre, për realizimin e idesë përfundimtare të navigimit të robotëve drejt objekteve të paracaktuar në mjedise të ndryshme.

Në materialin në vazhdim do të tregohet se si bëhet ky vlerësim i distancës dhe zhvendosjes nëpërmjet tre teknikave pa sensorë, të cilat në formë të përmbledhur po i japim më poshtë :

- Një sistemi të përbërë prej kompjuterit, një kamere (Monocular Vision) dhe një gjeneruesi lazeri pikësor. Imazhi i marë nga kamerat përpunohen duke përcaktuar nëpërmjet një algoritmi të thjeshtë pozicionin e rezes së dritës (lazer) mbi objektin që vëzhgojmë. Nëpërmjet këtij pozicionimi mundemi të përcaktojmë më tej distancën e objektit prej sistemit të kontrollit.

- Një sistemi të përbërë prej kompjuterit dhe dy kamerash (Stereo Vision).
  Llogaritjet për përcaktimin e distancës mbështeten në parimet e funksionimit të sistemit të kamerave si dhe në përdorimin e koncepteve gjeometrike. Objekti të cilit i përcaktohet distanca në këtë rast është një trup i targuar d.m.th një trup ne një shenjë të dallueshme nga mjedisi përreth ose mbi të cilin godet një reze drite lazer duke siguruar shënjimin e objektit.

- Një sistemi të përbërë prej kompjuterit dhe një kamere (Monocular Vision) ku nëpërmjet përpunimit të imazhit dhe analizave gjeometrike duke shfrytëzuar principet e prespektivës, llogaritet distanca e një objekti prej planit të kamerës. Kjo njihet si metoda e vlerësimit të distancës së objekteve prej një kamere referuar vlerësimit të thellësisë (Depth Estimation).

Përpunimet e të dhënave kryhen nëpërmjet programeve në kompjuter të ndërtuar në mjediset Visual Studio 6.0 (Visual Basic), Visual Studio.Net si dhe në Matlab R2013b.
Në këtë kapitull do të paraqiten metodat dhe rezultatet e aritura prej realizimeve eksperimentale për sejcilën prej tyre.

3.2. Metoda e vlerësimit të distancës së objekteve nëpërmjet një sistemi i përbërë prej një kamere dhe lazerit pikësor.

Përdorimi i teknikave të dhëna më sipër bëhet me një qëllim të vetëm; evidentimin dhe shmangien e pengesave që dalin gjatë lëvizjes së sistemeve robotikë. Në vijim do të shtjellohet se si distanca e një objekti mund të përcaktohet me ndihmën e një kamere, lazeri pikësor dhe kompjuterit. Pas aktivizimit të lazerit Fig 3.1, mbi objektin të cilit do t'i përcaktojmë largësinë nga sistemi i kontrollit projektohet njolla e rrezes së lazerit (objekti ndodhet në fushën e pamjes së kamerës). Matematika që do të përdoret është e thjeshtë kështu që kjo teknikë funksionon plotësisht. Modeli llogaritës është paraqitur në figurën e mëposhtëme.



Fig 3.1. *Imazhi i objekteve prej një lenteje*

Kjo rreze lazer është në mënyre ideale paralele me boshtin optik të kameras. Supozohet se ne pamjen e marrë në kamera pika e lazerit është pika më e shdritshme. Nëpërmjet një algoritmi të

thjeshtë të shprehur në njërën prej gjuhëve të programimit Visual Studio 6.0 (Visual Basic), Visual Studio.Net, MatLab R2013b, bëjmë të mundur përcaktimin e njollës së lazerit ne imazhin e marrë. Sa më afër qendrës se imazhit të jetë njolla e lazerit, aq më larg ndodhet objekti që vëzhgohet. Distanca midis kameras dhe lazerit pikësor është e njohur dhe zgjidhet prej nesh (h). Distanca e panjohur D përcaktohet si më poshtë :

$$D = \frac{h}{\tan(\theta)}$$

Për të përcaktuar distancën e panjohur është e kuptueshme që duhet të njohim këndin θ. Përcaktimi i tij bëhet nëpërmjet formulave të mëposhtme.

$$tg(\theta) = \frac{h}{D}$$
$$\theta = pfc \cdot rpc + r_0$$

Përfundimisht mund të themi se shprehja llogaritëse përfundimtare do të jetë si në vijon [22], [23]:

$$pfc \cdot rpc + r_0 = arctg(\frac{h}{D})$$

ku :

pfc - pika prej qendrës deri tek projeksioni i lazerit

rpc - radianë për pixel

r_o - vlerë korrigjuese për mbulimin e gabimit

Nga termat e mësipërme për këndin θ ato që duhet të përcaktohen janë pfc, rpc dhe r_o. Madhësia pfc përcaktohet duke analizuar figurën e marë prej kameras. Vlerësohet numri i pikave prej qendrës së kameras deri në shenjën e bërë prej rrezeve lazer. Dy madhësitë e tjera përcaktohen në mënyrë eksperimentale duke shfrytëzuar distanca të njohura.

pfc (pixel)	distancë e zgjedhur (cm)
105	29
100	28.5
65	58.3
57	73
49	90
45	110
42	128
40	158
37	189
35	218

Nisur nga vlera të njohura të distancave krijohen sisteme ekuacionesh algjebrikë linearë nga ku përcaktojmë madhësinë e rpc dhe r_o, për çdo çift vlerash të distancës së njohur si më poshtë:

$$pfc^{(1)} \cdot rpc + r_0 = arctg(\frac{h^{(1)}}{D})$$

$$pfc^{(2)} \cdot rpc + r_0 = arctg(\frac{h^{(2)}}{D})$$

$$\dots$$

$$pfc^{(n-1)} \cdot rpc + r_0 = arctg(\frac{h^{(n-1)}}{D})$$

$$pfc^{(n)} \cdot rpc + r_0 = arctg(\frac{h^{(n)}}{D})$$

Për të patur vlera sa më të sakta me gabime minimale, llogaritjet e madhësive rpc dhe r_o bëhen disa herë për distanca të ndyshme.

$$rpc = \frac{arctg(\frac{h^{(2)}}{D}) - arctg(\frac{h^{(1)}}{D})}{pfc^{(2)} - pfc^{(1)}}$$

$$r_0 = arctg(\frac{h^{(1)}}{D}) - pfc^{(1)} \cdot \frac{arctg(\frac{h^{(2)}}{D}) - arctg(\frac{h^{(1)}}{D})}{pfc^{(2)} - pfc^{(1)}}$$

Më tej llogaritet një vlerë mesatare për këto madhësi [25].

Provat eksperimentale janë kryer me paisjet e mëposhtme :

- Kamera HAMY c-200 Wireless Camera
- Lazer Pikësor Sin 2013908 Wavelength 650 nm±10 Max Output <5mW

Bazuar në paisjet e përdorura dhe nisur nga formulat e mësipërme bëhet llogaritja e madhësive rpc dhe r_o sipas metodës së treguar më sipër.

Vlerat e llogaritura janë :

rpc = -0.0565 rad

r_o = 0.002426 rad / pixel

Duke përdorur rezultatet e llogaritjeve të mësipërme nëpërmjet formulës $D = \frac{h}{\tan(pfc \cdot rpc + r_0)}$ bëhet e mundur llogaritja e distancës së kërkuar h.

$$h = D \cdot \tan(pfc \cdot rpc + r_0)$$

Në tabelën e mëposhtëme jepen distancat e llogaritura nga sistemi i kontrollit të distancës duke zgjedhur të njëjtat vlera të *pfc* si në tabelën e mësipërme.

pfc (pixel)	distancë e llogaritur (cm)	distancë e zgjedhur (cm)	gabimi relativ %
105	29.4	29	1.36
100	29.2	28.5	2.40
65	60.0	58.3	2.83
57	76	73	3.95
49	92	90	2.17
45	114.3	110	3.76
42	125.2	128	-2.24
40	164	158	3.66
37	192	189	1.56
35	210	218	-3.81



Fig 3.2. *Grafiku i shmagjeve midis vlerave të matura dhe atyre të zgjedhura për të njëjtën pfc.*

Në tabelën e mësipërme, kolona e fundit shpreh gabimin e realizuar prej sistemit të kontrollit të distancës, krahasuar me vlerat e matura paraprakisht. Kjo tregon se gabimi nuk kalon vlerat e 4 %.
Në Fig 3.2 jepet shmangia midis vlerave të matura dhe atyre të zgjedhura për të njëjtën *pfc* .
Për realizimin e tabelave të mësipërme u përdorën programet e ndërtuara në gjuhët e programimit Visual Studio 6.0 (Visual Basic), Visual Studio.Net si dhe në MatLab R2013b.
Sistemi i realizuar sipas përshkrimit të mësipërm krijon avantazhin e dukshëm të thjeshtësisë së tij si dhe të saktësisë relative të kërkuar. Kufizimi i këtij sistemi për përcaktimin e distancës është problemi i pozicionimit majtas apo djathtas i objektit. Që ky sistem të japë vlerësime pozicioni jo vetëm sipas një drejtimi lëvizjeje është e nevojshme të modifikohen algoritmat e tij, pjesë kjo e një pune në të ardhmen.

3.3. Algoritmika dhe programet e realizuara Visual Studio 6 (VB)

Për të realizuar përcaktimin e distancës së një objekti të shënjestruar, prej një sistemi kamerash & lazer të përshkruar në paragrafin e mësipërm, po japim algoritmin dhe programin e ndërtuar në Visual Studio 6 (VB).
Hapi i parë që kryhet është kalibrimi i sistemit të përcaktimit të distancës. Kjo do të realizohet në këtë mënyrë :

1. Ekzekutohet programi dhe pasi në GUI shfaqet imazhi i marrë nga kamera, ndizet lazeri pikësor. Sigurohemi që pika e ndricimit të lazerit godet në objektin tonë në shqyrtim.
2. Vendosim sistemin kamera lazer (këto paisje janë të vendosura mbi trupin e robotit) në një distancë të përcaktuar (të njohur). Në textbox ngjitur me butonin 'Kalibrimi', vendosim vlerën e distancës së njohur.
3. Shypim butonin 'Kalibrimi' i cili ekzekuton kodet e mëposhtme dhe nëpërmjet tyre bëhet llogaritja e variablit Koeficienti_Sys_Lazer_Kamera i cili do të shfrytëzohet më tej në llogaritjet e distancave të panjohura. Llogaritjen e madhësisë Koeficienti_Sys_Lazer_Kamera mund ta bëjmë bazuar në një matje kalibruese të vetme (siç jepet në kodet e programit) :

```
Private Sub cmdKalibrim_Click()
   Dim DistPikeLazerNgaQendra  As Integer
   Set Image2.Picture = dspPreview(1).Snap
   DistPikeLazerNgaQendra = DistanceKalibrimiPrejQendres(Image2)
   Koeficienti_Sys_Lazer_Kamera = DistPikeLazerNgaQendra * CDbl(txtDist.Text)
End Sub

Private Function DistanceKalibrimiPrejQendres(ByVal picColor As PictureBox) As Integer
   Dim PozicionLazerit As LAZER_DISTANCE
   Const pixR As Integer = 3
   Const pixG As Integer = 2
   Const pixB As Integer = 1
   Dim bitmap_info                 As BITMAPINFO
   Dim pixels()                    As Byte
   Dim bytes_per_scanLine          As Long
   Dim pad_per_scanLine            As Integer
   Dim X                           As Integer
   Dim Y                           As Integer
   Dim lartesia, gjeresia          As Integer
   Dim rreshti                     As Integer
   Dim kolona                      As Integer
   Dim max_rreshti                 As Integer
   Dim max_kolona                  As Integer
   Dim max_rreshtiR                As Integer

   Dim koeficient_radian_pixel             As Double
   Dim koeficient_kompesimi_gabimi         As Double


   ' Inicializim per bitmap_info bitmap .
   With bitmap_info.bmiHeader
      .biSize = 40
```

```
        .biWidth = picColor.ScaleWidth
        .biHeight = -picColor.ScaleHeight
        .biPlanes = 1
        .biBitCount = 32
        .biCompression = BI_RGB
        bytes_per_scanLine = ((((.biWidth * .biBitCount) + 31) \ 32) * 4)
        pad_per_scanLine = bytes_per_scanLine - (((.biWidth * .biBitCount) + 7) \ 8)
        .biSizeImage = bytes_per_scanLine * Abs(.biHeight)
    End With

    max_rreshtiR = 0

    ' Ngarkim bitmap datash
    ReDim pixels(1 To 4, 1 To picColor.ScaleWidth, 1 To picColor.ScaleHeight)
    GetDIBits picColor.hdc, picColor.Image, 0, picColor.ScaleHeight, pixels(1, 1, 1), bitmap_info,
DIB_RGB_COLORS

    lartesia = picColor.Height / Screen.TwipsPerPixelY
    gjeresia = picColor.Width / Screen.TwipsPerPixelX

    ' Kodet per procesimin e imazhit
    For rreshti = 1 To lartesia - 1 Step 10
        For kolona = 1 To gjeresia - 1 Step 10
            If pixels(pixR, kolona, rreshti) > max_rreshtiR Then
                max_rreshtiR = pixels(pixR, kolona, rreshti)        ‘ Variabli që mban vlerën më të
                max_rreshti = rreshti                               ‘ madhe te matrices pixels(3,..,..)
                max_kolona = kolona                                 ‘ duke siguruan gjetjen e koordinatave
            End If                                                  ‘ te pikes lazer ne image.
        Next
    Next

    ' Llogarit distancen prej pikes lazer deri ne qender te pamjes
    Dim x_gender, y_gender

    x_gender = CInt(gjeresia / 2)
    y_gender = CInt(lartesia / 2)

    DistanceKalibrimiPrejQendres = Sqr((y_gender - max_rreshti) ^ 2 + (x_gender - max_kolona) ^
2)
    End Function
```

Llogaritjen e madhësisë Koeficienti_Sys_Lazer_Kamera mund ta bejmë edhe disa herë për disa kalibrime të kryera për distanca të ndryshme, duke përfituar disa vlera për madhësitë :

Koeficienti_Sys_Lazer_Kamera1
Koeficienti_Sys_Lazer_Kamera2
...
Koeficienti_Sys_Lazer_KameraN

Më tej mund të llogaritim një vlerë mesatare për Koeficienti_Sys_Lazer_Kamera, nisur nga formula llogaritëse për mesataren aritmetike. Një rrugë e tretë është llogaritja e madhësive rpc dhe r_0 sipas vlerësimeve të bëra në paragrafin 3.2.

4. Pas përfundimit të kalibrimit, procesi i vlerësimit të distancës kryhet automatikisht në çdo interval kohor prej 500 ms. Imazhi i marrë prej kamerës që do të përpunohet kalohet në objektin Image2 prej instruksionit Set Image2.Picture = dspPreview(1).Snap. Objekti dspPreview është ai që lidhet drejpërdrejt me paisjen e kamerës duke na përcjellë imazhet e saj. Subrutina Timer1_Timer siguron thirrjen e përsëritur të funksionit GjetjeDistancePrejObjektit që shërben për të llogaritur distancën e kërkuar.

```
Private Sub Timer1_Timer()
   Dim DistLazer As LAZER_DISTANCE

   ' Set Image1.Picture = dspPreview(0).Snap
   ' DistLazer = GjetjeDistancePrejObjektit(Image1)
  '  valRreshti(0).Caption = DistLazer.NrRreshtitLazerit
  '  valKolona(0).Caption = DistLazer.NrKolonesLazerit
  '  valDistanca(0).Caption = DistLazer.distanca

   Set Image2.Picture = dspPreview(1).Snap
   DistLazer = GjetjeDistancePrejObjektit(Image2)
   valRreshti(1).Caption = DistLazer.NrRreshtitLazerit
   valKolona(1).Caption = DistLazer.NrKolonesLazerit
   valDistanca(1).Caption = DistLazer.distanca
End Sub

Private Function GjetjeDistancePrejObjektit(ByVal picColor As PictureBox) As LAZER_DISTANCE
   Dim PozicionLazerit As LAZER_DISTANCE
   Const pixR As Integer = 3
   Const pixG As Integer = 2
   Const pixB As Integer = 1
   Dim bitmap_info             As BITMAPINFO
   Dim pixels()                As Byte
   Dim bytes_per_scanLine      As Long
   Dim pad_per_scanLine        As Integer
   Dim X                                   As Integer
   Dim Y                                   As Integer
   Dim lartesia, gjeresia                  As Integer
   Dim rreshti                 As Integer
   Dim kolona                  As Integer
   Dim max_rreshti                         As Integer
   Dim max_kolona                          As Integer
   Dim max_rreshtiR                        As Integer
   Dim koeficient_radian_pixel             As Double
   Dim koeficient_kompesimi_gabimi  As Double
   Dim pixels_prej_qendres                 As Double
   Dim distanca                As Double

   ' Prepare the bitmap description.
   With bitmap_info.bmiHeader
      .biSize = 40
      .biWidth = picColor.ScaleWidth
      ' Use negative height to scan top-down.
      .biHeight = -picColor.ScaleHeight
      .biPlanes = 1
      .biBitCount = 32
      .biCompression = BI_RGB
      bytes_per_scanLine = ((((.biWidth * .biBitCount) + 31) \ 32) * 4)
      pad_per_scanLine = bytes_per_scanLine - (((.biWidth * .biBitCount) + 7) \ 8)
      .biSizeImage = bytes_per_scanLine * Abs(.biHeight)
```

```
    End With

    max_rreshtiR = 0

    ' Load the bitmap's data.
    ReDim pixels(1 To 4, 1 To picColor.ScaleWidth, 1 To picColor.ScaleHeight)
    GetDIBits picColor.hdc, picColor.Image, 0, picColor.ScaleHeight, pixels(1, 1, 1), bitmap_info,
DIB_RGB_COLORS

    lartesia = picColor.Height / Screen.TwipsPerPixelY
    gjeresia = picColor.Width / Screen.TwipsPerPixelX

    ' Kodet per procesimin e imazhit
    For rreshti = 1 To lartesia - 1 Step 10
        For kolona = 1 To gjeresia - 1 Step 10
            If pixels(pixR, kolona, rreshti) > max_rreshtiR Then
                max_rreshtiR = pixels(pixR, kolona, rreshti)        ' Variabli që mban vlerën më të
                max_rreshti = rreshti                                ' madhe te matrices pixels(3,..,..)
                max_kolona = kolona                                  ' duke siguruan gjetjen e koordinatave
            End If                                                   ' te pikes lazer ne image.
        Next
    Next

    max_rreshti = max_rreshti + 5
    max_kolona = max_kolona + 5

    ' llogaritja e distaces prej pikes lazer deri ne qendra e faqes se imazhit
    Dim x_gender, y_gender

    x_gender = CInt(gjeresia / 2)
    y_gender = CInt(lartesia / 2)

    pixels_prej_qendres = Sqr((y_gender - max_rreshti) ^ 2 + (x_gender - max_kolona) ^ 2)

    ' Llogaritja e distances ne baze te madhesive 'pixels_prej_qendres' dhe kalibrimit
'Koeficienti_Sys_Lazer_Kamera'
    distanca = Koeficienti_Sys_Lazer_Kamera / pixels_prej_qendres

    ' Percakto pozicionin e rreshtit dhe kolones se pikes lazer.
    PozicionLazerit.NrRreshtitLazerit = max_rreshti
    PozicionLazerit.NrKolonesLazerit = max_kolona

    ' Percakto distancen e bojektit nga kamera
    PozicionLazerit.distanca = distanca

    If max_kolona > 0 And rreshti > 0 Then

        ' Vizato nje vije te kuqe vertikale qe kalon ne piken lazer
        If max_rreshti > 50 Then
            For rreshti = max_rreshti - 50 To max_rreshti
                pixels(pixR, max_kolona, rreshti) = 255
            Next
        End If

        For rreshti = lartesia / 2 - 50 To lartesia / 2 + 50
            pixels(pixR, x_gender, rreshti) = 127
        Next

        ' Vizato nje vije te kuqe horizontale qe kalon ne piken lazer
```

```
        If max_kolona > 50 Then
           For kolona = max_kolona - 50 To max_kolona - 1
              pixels(pixR, kolona, max_rreshti) = 255
           Next
        End If

        For kolona = gjeresia / 2 - 50 To gjeresia / 2 + 50
           pixels(pixR, kolona, y_gender) = 127
        Next

        ' Shfaq imazhin e targuar.
        SetDIBits picColor.hdc, picColor.Image, 0, picColor.ScaleHeight, pixels(1, 1, 1), bitmap_info,
DIB_RGB_COLORS
        picColor.Picture = picColor.Image
     End If
     GjetjeDistancePrejObjektit = PozicionLazerit
End Function
```

Në Shtojcën-5 po japim programin për llogaritjen e distancës së sistemit kamera & lazer prej një objekti të caktuar.

3.4. Metoda e vlerësimit të distancës së objekteve nëpërmjet një sistemi prej dy kamerash

Modeli i pranuar për kamerën.

Në vlerësimin e distancës së objekteve nga një sistem prej dy kamerash, do të bazohemi në parimin e punës së këtyre aparateve . Ne jemi gjithashtu duke supozuar një model të përsosur lidhur me lenten, duke pranuar një lente të hollë . për të lehtësuar llogaritjen lidhur me imazhin dixhital të prodhuar nga kamera. Metoda që përdoret mbështetet në faktin që nje objekt me lartësi h_0 do të ketë imazhin e tij djathtas lentes ne madhësinë h_I . Kur objekti origjinal zmadhohet me madhësinë δ , imazhi i tij do të zmadhohet me $f(\delta)$. Prej Fig 3.3, shohim që : $h_0^{'} = h_0 + \delta$ dhe $h_I^{'} = h_I + f(\delta)$. Duke u mbështetur në një gjeometri të thjeshtë mund të shkruajmë : $\frac{h_0}{h_I} = \frac{R-f}{f}$ dhe $\frac{h_0^{'}}{h_I^{'}} = \frac{R-f}{f}$

Prej ekuacionit të fundit mund të shkruajmë :

$$h_I^{'} = h_0^{'} \cdot \frac{f}{R-f} = (h_0 + \delta) \cdot \frac{f}{R-f} = h_I + \delta \cdot \frac{f}{R-f} \qquad (1)$$



Fig 3.3. *Imazhi i objekteve prej një lenteje*

Duke mbajtur objektin në të njëjtën distancë, madhësia $\frac{f}{R-f}$ mbetet e pandryshueshme. Kjo do të thotë se varësia e ndryshimit të madhësisë së imazhit në funksion të ndryshimit të madhësisë së objektit është lineare. Nisur nga ky përfundim mund të themi se përcaktimi i distancës së objektit prej kameras do të mund të realizohet nëpërmjet konvertimit të numrit të pikave që numërohen në imazhin e objektit sipas një varësie lineare (shënojmë me ρ koeficientin konvertues). Në vlerësimin e distancës kërkohet njohja e disa madhësive ndërmjet të cilave është njohja e distacës midis dy kamerave si dhe këndi i pamjes së kamerave përcaktuar nga shprehja $\theta = \arctan\left(\frac{D}{2 \cdot f}\right)$ ku f largësia vatrore dhe D diametri i fushës së kameras. Formula e fundit na lejon të përcaktojmë këndin e pamjes së kamerës në plan.

Vlerësimi i distancës së objektit nga një sistem prej dy kamerash.

Për të vlerësuar distancën e objekteve nga një sistem kontrolli të përbërë nga dy kamera, algoritmi që do të përdoret mbështetet në vlerësimet e mësipërme. Objekti mund të jetë i pozicionuar në lidhje me kamerat sipas mundësive të dhëna në vijim :

- Ndërmjet të dy kamerave.
- Majtas ose djathtas ndaj të dy kamerave.
- Përballë kamerës së majtë ose të djathtë.

Për të gjitha këto pozicionime të objektit ajo që shihet është që objekti gjithmonë gjendet në zonën e përbashkët të të dy kamerave. Analiza për rastet kur objekti ndodhet jashtë kësaj zone përbën një tjetër rast që do të trajtohet në një material tjetër si punë e së ardhmes.

Vlerësimi i distancës së objektit të pozicionuar ndërmjet dy kamerave.

Duke u mbështetur në Fig 3.4, llogaritja e distancës së objektit (R) do të kryhet si më poshtë.



Fig 3.4. *Objekti i pozicionuar ndërmejet dy kamerave në zonën e përbashkët*

Përcaktimi i madhësive θ_1 dhe α_1 do të kryhet nga shprehjet :

$$\tan(\theta_1) = \frac{\frac{pix_1}{2} \cdot \rho_1}{R} \qquad \text{dhe} \qquad \tan(\alpha_1) = \frac{\left(P_1 - \frac{pix_1}{2}\right) \cdot \rho_1}{R} \qquad (2)$$

Në mënyrë të ngjashme do të përcaktohen madhësitë θ_2 dhe α_2.

$$\tan(\theta_2) = \frac{\frac{pix_2}{2} \cdot \rho_2}{R} \qquad \text{dhe} \qquad \tan(\alpha_2) = \frac{\left(\frac{pix_2}{2} - P_2\right) \cdot \rho_2}{R} \qquad (3)$$

ku :

pix_1 përcakton numrin total të pikave në të gjithë zonën që kontrollon kamera majtas,

ρ_1 koeficientin konvertues për kameran majtas

P_1 përcakton numrin total të pikave prej kufirit majtas deri në objekti (kamera majtas).

pix_2 përcakton numrin total të pikave në të gjithë zonën që kontrollon kamera djathtas,

ρ_2 koeficientin konvertues për kamerën majtas

P_2 përcakton numrin total të pikave prej kufirit majtas deri në objekti (kamera djathtas).

Prej ekuacioneve (2) dhe (3) përcaktojmë :

$$\alpha_1 = \arctan\left(\frac{P_1 - \frac{pix_1}{2}}{\frac{pix_1}{2}} \cdot \tan(\theta_1)\right) \qquad \text{dhe} \qquad \alpha_2 = \arctan\left(\frac{\frac{pix_2}{2} - P_2}{\frac{pix_2}{2}} \cdot \tan(\theta_2)\right) \qquad (4)$$

Prej fig 2, mund të shkruajmë :

për kamerën majtas : $\tan(\frac{\pi}{2} - \alpha_1) = \frac{R}{X_1}$ (5)

për kamerën djathtas : $\tan(\frac{\pi}{2} - \alpha_2) = \frac{R}{\Delta X - X_1}$ (6)

ku : ΔX përcakton distancën ndërmjet dy kamerave.

Duke u nisur nga ekuacionet (5) dhe (6) mund të përcaktojmë :

$$\frac{\tan(\frac{\pi}{2} - \alpha_1)}{\tan(\frac{\pi}{2} - \alpha_2)} = \frac{\Delta X - X_1}{X_1} \qquad (7)$$

Duke e zgjidhur ekuacionin (7) sipas X_1 llogaritim :

$$X_1 = \frac{\tan(\frac{\pi}{2} - \alpha_2)}{\tan(\frac{\pi}{2} - \alpha_1) + \tan(\frac{\pi}{2} - \alpha_2)} \cdot \Delta X \qquad (8)$$

Përfundimisht mund të përcaktojmë distancën e kërkuar të objektit prej kamerave prej ekuacioneve (5) dhe (8).

$$R = \frac{\tan(\frac{\pi}{2} - \alpha_1) \cdot \tan(\frac{\pi}{2} - \alpha_2)}{\tan(\frac{\pi}{2} - \alpha_1) + \tan(\frac{\pi}{2} - \alpha_2)} \cdot \Delta X \qquad (9)$$

ose

$$R = \frac{1}{\tan(\alpha_1) + \tan(\alpha_2)} \cdot \Delta X \qquad (9')$$

Përfundimisht duke shfrytëzuar formulat (4) dhe (9) jemi në gjendje të përcaktojmë distancën e objektit nga kamerat kur njohim madhësitë $\alpha_1, \alpha_2, \Delta X$.

Vlerësimi i distancës së objektit të pozicionuar majtas ose djathtas ndaj të dy kamerave.

Në të njëjtën mënyrë si u trajtua rasti i mësipërm do të trajtohet edhe rasti i dhënë në Fig 3.5.



Fig 3.5. *Objekti i pozicionuar majtas të dy kamerave në zonën e përbashkët*

Këndi α_1, α_2 do të përcaktohen nga shprehjet e mëposhtëme :

$$\alpha_1 = \arctan\left(\frac{\frac{pix_1}{2} - P_1}{\frac{pix_1}{2}} \cdot \tan(\theta_1)\right) \qquad \text{dhe} \qquad \alpha_2 = \arctan\left(\frac{\frac{pix_2}{2} - P_2}{\frac{pix_2}{2}} \cdot \tan(\theta_2)\right) \qquad (10)$$

Nga fig 3 mund të përcaktojmë : $\beta = \pi - \left[\left(\alpha_1 + \frac{\pi}{2}\right) + \left(\frac{\pi}{2} - \alpha_2\right)\right] = \alpha_2 - \alpha_1$

Prej fig 3, mund të shkruajmë :

$$\tan(\frac{\pi}{2} - \alpha_1) = \frac{R}{X_1} \qquad (11) \qquad\qquad \tan(\frac{\pi}{2} - \alpha_2) = \frac{R}{\Delta X + X_1} \qquad (12)$$

ku : ΔX përcakton distancën ndërmjet dy kamerave.

Prej ekuacioneve (11) dhe (12) nxjerrim : $X_1 = \dfrac{\tan(\frac{\pi}{2} - \alpha_2)}{\tan(\frac{\pi}{2} - \alpha_1) - \tan(\frac{\pi}{2} - \alpha_2)} \cdot \Delta X \qquad (13)$

Përfundimisht mund të përcaktojmë distancën e kërkuar të objektit prej kamerave prej ekuacioneve (11) dhe (13).

$$R = \frac{\tan(\frac{\pi}{2} - \alpha_1) \cdot \tan(\frac{\pi}{2} - \alpha_2)}{\tan(\frac{\pi}{2} - \alpha_1) - \tan(\frac{\pi}{2} - \alpha_2)} \cdot \Delta X \qquad (14)$$

ose

$$R = \frac{1}{\tan(\alpha_2) - \tan(\alpha_1)} \cdot \Delta X \qquad (14')$$

Përcaktimi i distancës për rastin kur objekti ndodhet në të djathtë të kameras së djathtë, do të jetë sipas ekuacionit :

$$R = \frac{\tan(\frac{\pi}{2} - \alpha_1) \cdot \tan(\frac{\pi}{2} - \alpha_2)}{\tan(\frac{\pi}{2} - \alpha_2) - \tan(\frac{\pi}{2} - \alpha_1)} \cdot \Delta X \qquad (15)$$

ose

$$R = \frac{1}{\tan(\alpha_1) - \tan(\alpha_2)} \cdot \Delta X \qquad (15')$$

Vlerësimi i distancës së objektit të pozicionuar përballë kameras të majtë ose të djathtë.

Në Fig 3.6 jepet objekti i pozicionuar përballë me kameran e majtë në zonën e përbashkët.



Fig 3.6. *Objekti i pozicionuar përballë me kamerën e majtë në zonën e përbashkët*

Për rastin kur objekti ndodhet përballë me kamerën e majtë ($\alpha_1 = 0$), llogaritjet e distancës do të bëhen si vijon :

$$R = \Delta X \cdot \tan(\frac{\pi}{2} - \alpha_2) \qquad (16)$$

Në mënyrë të ngjashme llogaritet distanca kur objekti ndodhet përballë me kamerën e djathtë ($\alpha_2 = 0$).

$$R = \Delta X \cdot \tan(\frac{\pi}{2} - \alpha_1) \qquad (17)$$

Realizimi eksperimental i vlerësimit të distancës së objektit prej planit të kamerave.

Në vlerësimin eksperimental të distancës së objektit nga plani i kamerave, do të na nevojitet një çift kamerash si në Fig 3.7, për të cilat është e domosdoshme të njihen parametrat si largësia vatrore f dhe diametri i lentes D. Objekti për të cilin do të bëhen vlerësimet e distancës do të jetë i dallueshëm nga mjedisi në sfond. Për të realizuar dallueshmërinë midis objektit dhe pjesës tjetër në sfond është e nevojshme që objekti të ketë një ngjyrë të vecantë nga pjesa tjetër e mjedisit.
Programi që realizon vlerësimin e distancës së objektit nga plani i kamerave është ndërtuar në disa mjedise programimi, Matlab R2013b, Visual Basic .Net dheVisual Basic 6.0.



Fig 3.7. *Skema eksperimentale*

Rezultatet e matjeve të kryera jepen në tabelën e mëposhtëme. Realizimi i tyre është kryer për distanca të njohura të planit të kamerave nga plani i objektit.

Kamerat të përdorura janë PcCamera HAMY c-200 Wireless Camera me këto të dhëna : $D = 1cm$, $f = 3cm, \Delta X = 11cm$

Nr	Distanca e matur (në cm)	Distanca e llogaritur (në cm)	Shmangia (në cm)	Gabimi relativ në % (vlera relative e tyre)
1	20	20.8545	-0,8545	4,2725
2	22	21.8396	0,1604	0,7291

3	24	23.6540	0,3460	1,4417
4	26	25.6523	0,3477	1,3373
5	28	28.2352	-0,2352	0,8400
6	30	30.0365	-0,0365	0,1217
7	40	41.2145	-1,2145	3,0363
8	50	51.1256	-1,1256	2,2512
9	60	61.4125	-1,4125	2,3542



Grafiku 3.8. *Distancat e matura dhe të llogaritura*



Grafiku 3.9. *Gabimet absolute dhe relative në varësi të distancës së matur*

Llogaritjet e kryera janë për rastin kur objekti ndodhet në pozicionin përballë kamerave, në mes të distancës ndërmjet dy kamerave.

Si përfundim mund të themi se :

- Nëpërmjet kësaj metode tregohet se si mund të vlerësohet distanca e një objekti prej një cifti kamerash.
- Metoda siguron rezultate të sakta për sa kohë njihen parametrat e kamerave si largësia vatrore f dhe diametri i lentes D.
- Kjo metodë përdoret vetem në rastin kur sistemi shihet në plan dhe jo për rastin 3D.
- Nisur nga tabela dhe grafikët e mësipërm mund të themi se kur distanca me objektin zvogëlohet, gabimi në vlerësim rritet (vlera 20 cm me gabim relativ 4.27%). Nga tabelat e rezultateve shihet edhe që me rritjen e distances midis kamerave dhe objektit rritet dhe masa e gabimit ne vlerësimin e distancës (vlerat per distancën 50 dhe 60 cm në tabelë).

3.5. Algoritmika dhe programet e realizuara Visual Studio 6 (VB) dhe Matlab R2013

Visual Basic 6.0

Më poshtë po japim një funksion llogaritës të distances dhe disa pamje prej programit të realizuar në Visual Basic 6.0



Fig 3.10. *GUI-ja në Visual Basic 6.0 për llogaritjen e distancës*

```
Public Function VleresoDistancenObjektit(PLeft As Double, PRight As Double, imageSize As Long) As Double
   Const PI As Double = 3.14159265358979
   Dim teta1, teta2              As Single
   Dim alpha1, alpha2   As Single
   Dim numurues          As Double
   Dim emerues           As Double
   Dim object_distance As Double

   ' llogaritje e kendeve teta1, teta2
   teta1 = Atn(gDiametriMajtas / (gDistVatroreMajtas * 2))              ' gjysem kendi i pamjes se kameras se majte
```

```
   teta2 = Atn(gDiametriDjathtas / (gDistVatroreDjathtas * 2))          ' gjysem kendi i pamjes se kameras se djathte

   ' objekti gjendet midis lenteve te majte dhe te djathte
   If ((PLeft > (imageSize / 2)) And (PRight < imageSize / 2)) Then
      'Rasti i pare
      alpha1 = Atn(((PLeft - (imageSize / 2)) / (imageSize / 2)) * Tan(teta1))
      alpha2 = Atn((((imageSize / 2) - PRight) / (imageSize / 2)) * Tan(teta2))
      numurues = DistancaNdermjet2Kamerave
      emerues = Tan(alpha1) + Tan(alpha2)
      object_distance = numurues / emerues
   End If

   If ((PLeft > (imageSize / 2)) And (PRight > (imageSize / 2)) Or (PLeft < (imageSize / 2)) And (PRight < (imageSize / 2))) Then
          alpha1 = Atn((((imageSize / 2) - PLeft) / (imageSize / 2)) * Tan(teta1))
          alpha2 = Atn(((PRight - (imageSize / 2)) / (imageSize / 2)) * Tan(teta2))
          If ((PLeft > (imageSize / 2)) And (PRight > (imageSize / 2))) Then
              object_distance = DistancaNdermjet2Kamerave / (Tan(alpha2) - Tan(alpha1))
          Else
              object_distance = DistancaNdermjet2Kamerave / (Tan(alpha1) - Tan(alpha2))
          End If
   End If

   If (PLeft = (imageSize / 2)) Then
      ' objekti perballe me lenten majtas
      alpha2 = Atn((((imageSize / 2) - PRight) / (imageSize / 2)) * Tan(teta2))
      object_distance = Tan((PI / 2) - alpha2) * DistancaNdermjet2Kamerave
   End If

   If (PRight = (imageSize / 2)) Then
     ' objekti perballe me lenten djathtas
      alpha1 = Atn(((PLeft - (imageSize / 2)) / (imageSize / 2)) * Tan(teta1))
      object_distance = Tan((PI / 2) - alpha1) * DistancaNdermjet2Kamerave
   End If

   VleresoDistancenObjektit = object_distance
End Function
```

Fig 3.11. *GUI-ja në Visual Basic 6.0 gjate llogaritjes së distancës*

Fig 3.12. *GUI-ja në Visual Basic 6.0, rezultatet*

Në Shtojcën-5 po japim programin për llogaritjen e distancës së sistemit të dy kamerave prej një objekti të caktuar.

Matlab R2013b

Për të realizuar gjetjen e distancës së një objekti të shënjestruar nëpërmjet dy kamerave në Matlab R2013b, do të shfrytëzoj programin që po e shpjegojmë në vijim.
Programi përbëhet nga dy module që emërtohen :

- Distaca2Kamera.m që përbman funksione dhe subrutina
- Distaca2Kamera.fig që përbën ndërfaqësin grafik për përdoruesin ose e njohur si GUI.

Funksionet e ndryshme që janë përdorur në këtë program po i përshkruajmë më poshtë :

`Function Distaca2Kamera_OpeningFcn(hObject, eventdata, handles, varargin)`
Ky funksion ekzekutohet para se dritarja e `Distaca2Kamera` të jetë bërë e dukshme. Ky funksion nuk rikthen ndonjë madhësi pas ekzekutimit. Gjatë ekzekutimit të këtij funksioni krijohen, inicializohen dhe startohen objektet për imazhet video të të dy kamerave, si psh për kamerën 1 instruksionet janë si më poshtë :

```
vid1 = videoinput('winvideo', 1);
% only capture one frame per trigger, we are not recording a video
vid1.FramesPerTrigger = 1;
% output would image in RGB color space
vid1.ReturnedColorspace = 'rgb';
% tell matlab to start the webcam on user request, not automatically
triggerconfig(vid1, 'manual');
% we need this to know the image height and width
vidRes = get(vid1, 'VideoResolution');
% image width
imWidth = vidRes(1);
% image height
imHeight = vidRes(2);
% number of bands of our image (should be 3 because it's RGB)
nBands = get(vid1, 'NumberOfBands');
% create an empty image container and show it on axPreview
hImageL = image(zeros(imHeight, imWidth, nBands), 'parent', handles.axPreview1);
% begin the webcam preview
preview(vid1, hImageL);
```

Pas përcaktimit të parametrave të kamerave si :

- largësia e vatrave ()
  ```
  focal_left = str2double(get(handles.edit1,'String'));
  focal_right = str2double(get(handles.edit3,'String'));
  ```
- diametri i lenteve të kamerave
  ```
  diam_left = str2double(get(handles.edit2,'String'));
  diam_right = str2double(get(handles.edit4,'String'));
  ```
- distanca midis kamerave
  ```
  cam_distance = str2double(get(handles.edit5,'String'));
  ```

thirret për tu ekzekutuar funksioni kryesor i cili kryen llogaritjet për distancën.

`Function pushbutton1_Callback(hObject, eventdata, handles)`
Ky funksion ekzekutohet pas shtypjes së butonit `LLOGARITJE`. Ky funksion siguron marrjen e imazheve nga të dy kamerat, ruajtjen e imazhit me emrat `'imgleft.jpg'` dhe `'imgright.jpg'`. Instruksionet që kryejnë këtë proces jepen më poshtë :

```
left_image_file ='imgleft.jpg';
FLeft = getframe(handles.axPreview1);
% image(FLeft.cdata);
ImageL = frame2im(FLeft);
% imwrite(FLeft.cdata, left_image_file);
imwrite(ImageL, left_image_file);
focal_left = str2double(get(handles.edit1,'String'));


right_image_file ='imgright.jpg';
FRight = getframe(handles.axPreview2);
% image(FRight.cdata);
ImageR = frame2im(FLeft);
% imwrite(FRight.cdata, right_image_file);
imwrite(ImageR, right_image_file);
focal_right = str2double(get(handles.edit3,'String'));
```

Imazhet e ruajtura thirren dhe më tej kryhet procesi i analizës për përcaktimin e distancës së një objekti, i cili zgjidhet në mënyrë manuale nga përdoruesi i programit nëpërmjet zgjedhjes me mouse të tij. Rezultati llogaritet, bazuar në teknikën e përshkruar në paragrafin e mësipërm, prej instruksioneve të mëposhtëme :

```
%Vlerat e qendres se objektit ne imazhin e majte dhe te djathte
PLeft = (object_left(1)+object_left(1)+object_left(3))/2
PRight = (xbegin + xend)/2

% llogaritja e distances dhe kthimi I vleres
teta1 = atan(diam_left/(focal_left*2)) % gjysem kendi i pamjes se kameres se majte
teta2 = atan(diam_right/(focal_right*2)) % gjysem kendi i pamjes se kameres se
djathte

% objekti eshte midis lentes se najte dhe te dhjathte
if ((PLeft  > (imageSize/2))&&(PRight < (imageSize/2)))
    disp('CASE 1!!!');
    alpha1 = atan(((PLeft - (imageSize/2))/(imageSize/2))*tan(teta1));
    alpha2 = atan((((imageSize/2) - PRight)/(imageSize/2))*tan(teta2));
    mone = tan((pi/2) - alpha1)*tan((pi/2) - alpha2)*cam_distance;
    mehane = tan((pi/2) - alpha1) + tan((pi/2) - alpha2);
    object_distance = mone /mehane
end
if ((PLeft  > (imageSize/2))&&(PRight > (imageSize/2))||(PLeft  <
(imageSize/2))&&(PRight < (imageSize/2)))
         alpha1 = atan((((imageSize/2) - PLeft)/(imageSize/2))*tan(teta1));
         alpha2 = atan(((PRight - (imageSize/2))/(imageSize/2))*tan(teta2));
         if ((PLeft  > (imageSize/2))&&(PRight > (imageSize/2)))
             % objekti eshte ne te majte te lentes se majte dhe te djathte
             disp('CASE 2!!!');
             object_distance = (sin((pi/2) - alpha1)*(sin((pi/2) -
alpha2))*cam_distance)/(sin(-alpha1 + alpha2))
         else
              %objekti eshte ne te djathte te lentes se majte dhe te djathte
             disp('CASE 3!!!');
             object_distance = (sin((pi/2) - alpha1)*(sin((pi/2) -
alpha2))*cam_distance)/(sin(-alpha2 + alpha1))
         end
end
if  (PLeft  == (imageSize/2))
    % objekti eshte perpara kameres se majte
    disp('CASE 4!!!\n');
    alpha2 = atan((((imageSize/2) - PRight)/(imageSize/2))*tan(teta2));
    object_distance = tan((pi/2) - alpha2)*cam_distance
end
if (PRight == (imageSize/2))
    %objekti eshte perpara kameres se djathte
    disp('CASE 5!!!\n');
```

```
        alpha1 = atan(((PLeft - (imageSize/2))/(imageSize/2))*tan(teta1));
        object_distance = tan((pi/2) - alpha1)*cam_distance
    end
```

`Function figure1_CloseRequestFcn(hObject, eventdata, handles)`
Ky funksion ekzekutohet kur aktivizohet mbyllja e GUI.

Në Shtojcën-6 po japim programin në MatLab R2013b për llogaritjen e distancës së sistemit të dy kamerave prej një objekti të caktuar.

3.6. Metoda e vlerësimit të distancës së objekteve prej një kamere referuar vlerësimit të thellësisë (Depth Estimation).

Në këtë paragraf do të trajtojmë një teknikë për vlerësimin e thellësisë duke përdorur kameran dhe më tej përpunimin e imazhit. Sistemi është i ndërtuar duke shfytëzuar parametrat specifikë të kamerave. Sisteme ndihmëse në fushën e drejtimit të automjeteve si Lane Departure warning (LDW), Dynamic High Beam (DHB), Forward Collision Warning (FCW) etj, përdorin kamera monoculare dhe aplikacione të ndërtuara për ato. Përdorimi i kamerave monoculare dhe aplikacioneve në sistemet e drejtimit te automjeteve, sot ka marrë një përdorim të gjerë. Shumë sisteme ekzistuese automjetesh (Mercedes E Class, BMW 7 series etj) kanë implementuar në një platformë të vetme të gjitha sistemet ndihmese të përshkruara më lart, duke reduktuar në maksimum kostot e tyre. Vlerësimi i thellësisë (pra i distancës së objektit nga plani i kamerës) është një detyrë e rëndësishme në aplikime të tilla si shmangia nga përplasjet, autoparkimet etj. Përdorimi i një kamere të vetme në këto raste është sfiduese sepse imazhi i kamerës është subjekt i shtrembërimeve të prespektivës. Në këto kushte vlerësimi i thellësisë mund të arrihet duke shfytëzuar vetitë fizike të kamerave si dhe duke përdorur analizat gjeometrike, të cilat bëjnë të mundur lidhjen e imazheve 2D të marra nga kamerat me ato 3D të mjedisit real [35]. Përpunimi i imazhit duke përdorur Matlab-in është përdorur tashmë në disa aplikime industriale. Me kamera të reja portative të përdorura gjerësisht sot është e mundur për të zhvilluar teknologji të kontrollit automatik të bazuara në përpunimin e imazhit në Matlab me besueshmëri të lartë të matjes [34]. Qëllimi kryesor i këtij paragrafi është të vlerësojë performancën e përpunimit të imazhit në Matlab duke punuar me një kamera, me qëllimin e matjes së distancës. Realizimi i kësaj detyre kërkon plotësimin e disa kushteve ku më kryesorët janë fakti që objekti që vëzhgohet duhet të jetë më i ndriçuar se pjesa tjetër në mjedisin rreth tij dhe mundësisht qëndra gjeometrike e objektit të jetë sa më afër aksit të kameres. Hapat që do të ndiqen deri në vlerësimin e distancës jepen në vijim :

- Merret imazhi prej kameres, ku brenda këtij imazhi ndodhet objekti që vëzhgohet (i ndriçuar).
- Objekti sillet në një distancë 20 cm larg prej planit të kamerës dhe pas përcaktimit të kontureve në imazhin e marrë nga kamera, llogaritet gjerësia w_k dhe lartësia h_k e tij. Kjo përbën dhe atë që njhet si procesi i kalibrimit për sistemin tonë.
- Gjatë ndryshimit të vendodhjes së objektit, llogaritja e distancës bëhet duke shfrytëzuar principet e gjeometrisë së prepektivës. Nisur nga llogaritjet e bëra në procesin e kalibrimit si dhe llogaritjet e gjerësisë w dhe lartësisë h së objektit në kushtet e një pozicionimi të ri, bëhet e mundur gjetja e distancës së re.
  Llogaritja e distancës kryhet nëpërmjet një formule empirike :

$$\text{Distanca} = -10.73 \cdot \log\left[\frac{w \cdot h}{w_k \cdot h_k} \cdot 21720\right] + 127.15$$

Rezultatet e matjeve të kryera jepen në tabelën e mëposhtme. Realizimi i tyre është kryer për distanca të njohura të planit të kamerave nga plani i objektit.

Kamerat e përdorura janë PcCamera HAMY c-200 Wireless Camera (të njëjta që janë përdorur si në metodat e përshkruara në paragrafet e mëparshëm), me këto të dhëna :

$$D = 1cm,\ f = 3cm, \Delta X = 11cm$$

Nr	Distanca e matur (në cm)	Distanca e llogaritur (në cm)	Shmangia (në cm)	Gabimi relativ në %
1	20	20.0035	-0.0035	0.0175
2	40	40.5006	-0.5006	1.2515
3	60	61.2640	-1.2640	2.1067
4	80	82.8723	-2.8723	3.5904
5	100	101.6982	-1.6982	1.6982
6	120	120.9165	-0.9165	0.7637
7	140	141.2765	-1.2765	0.9118
8	160	162.0316	-2.0316	1.2697
9	180	182.4126	-2.4126	1.3403



Grafiku 3.13. *Distancat e matura dhe të llogaritura*



Grafiku 3.14. *Gabimet absolute dhe relative në varësi të distancës së matur*

3.7. Algoritmika dhe programi i realizuar në Matlab R2013

Për të realizuar gjetjen e distancës së një objekti të shënjestruar nëpërmjet një kamere në Matlab R2013b, do të shfrytëzoj programin që po e shpjegojmë në vijim.
Programi përbëhet nga dy module që emërtohen :

- MatDistancenKamera.m që përbman funksione dhe subrutina
- MatDistancenKamera.fig që përbën ndërfaqësin grafik për përdoruesin ose e njohur si GUI.

Funksionet e ndryshme që janë përdorur në këtë program po i përshkruajmë më poshtë :

```
Function MatDistancenKamera_OpeningFcn(hObject, eventdata,
handles, varargin)
```

Ky funksion ekzekutohet para se dritarja e `MatDistancenKamera` të jetë bërë e dukshme. Funksioni nuk rikthen ndonjë madhësi pas ekzekutimit. Gjatë ekzekutimit të këtij funksioni krijohet dhe inicializohet objekti për imazhin video.

```
Function HapeKameran_Callback(hObject, eventdata, handles)
```

Ky funksion ekzekutohet pas shtypjes së butonin në `HapeKameran`. Funksioni siguron aktivizimin e objektit video dhe në GUI shfaqen imazhet e përcjella nga kamera.

```
Function Kalibrim_Callback(hObject, eventdata, handles)
```

Ky funksion ekzekutohet pas shtypjes së butonin `Kalibrim`. Funksioni siguron përcaktimin e madhësisë `factor` që do të shërbejë më tej për vlerësimin e distacave të objektit kundrejt planit të kameres.

```
Function [w, h, minc, minf] =
LlogaritGjeresiGjatesiObjektiPlan(video)
```
Ky funksion ekzekutohet gjthmonë kur kërkohet të vlerësohen koordinatat `minc, minf` si dhe gjerësia `w` dhe lartësia `h,` e objektit në vëzhgim.

```
Function [ ] = LlogaritDistancen(video,dist)
```
Ky funksion llogarit distancën e kërkuar për objektin në vëzhgim. Llogaritjet bëhen pas përcaktimit të koordinatave dhe përmasave të objektit për gjendjen e re, duke shfytëzuar shprehjen e mëposhtëme :

```
area = w*h;
distancia =( -10.73*log((area/factor)*21720)) + 127.15;
```

```
Function [ ] = DrawRect(video,dist)
```
Ky funksion shërben për të konturuar vizualisht objektin në GUI.

```
Function cameraGUI_CloseRequestFcn(hObject, eventdata, handles)
```
Ky funksion ekzekutohet kur aktivizohet mbyllja e GUI.

Në Shtojcën-7 po japim programin në MatLab R2013b, për llogaritjen e distancës së sistemit të kamerës prej objektit të caktuar.

Si përfundim mund të themi se :

- Nëpërmjet kësaj metode tregohet se si mund të vlerësohet distanca e një objekti prej një kamere të vetme duke shfrytëzuar principet e gjeometrisë së prespektivës.
- Metoda siguron rezultate të sakta edhe pa një njohje të parametrave të kamerës si largësia vatrore f dhe diametri i lentes D.
- Kjo metodë përdoret në rastin kur sistemi shihet në 3D sepse shfytëzon principet e dhëna më sipër
- Objekti duhet të jetë sa më i dukshëm ndaj kamerës që do të thotë se pozicioni më i mirë i tij do të qe në aksin që kalon nga qëndra e lentes së kamerës, pingul me planin e kamerës .
- Nga tabelat e rezultateve shihet se me rritjen e distancës midis kamerave dhe objektit rritet dhe masa e gabimit në vlerësimin e distancës (vlerat per distancën 120, 140, 160 dhe 180 cm në tabelë). Në matjet e dhëna gabimi relativ më i madh i marrë është në masën 3.6 %.

KAPITULLI IV

Hyrje

Në këtë kapitull do të përshkruhet një sistem i thjeshtë ndjekës objektesh nëpërmjet përpunimit të imazheve të sjella nga një kamer. Sistemi ndjekës i përshkruar dhe realizuar në këtë kapitull mund të shërbejë për ndjekjen e çfarëdo lloj objekti të cilësuar në një imazh të kameras, pra ai përbën një sistem ndjekës pothuajse universal. Sistemi ndjekës skematikisht i paraqitur në Fig.4.1, shpreh një mënyrë se si duke ndjekur lëvizjen e diellit, paneli diellor me fotoelementë pozicionohet sipas drejtimit ku sipërfaqja aktive për fluksin e dritës merr vlerën maksimale.



Fig. 4.1. *Skema pricipiale e sistemit ndjekës së objekteve me kamera*

Rrjedhojë e këtij pozicionimi të panelit dhe rryma e gjeneruar ka vlerën maksimale. Parimisht sistemi është i përbërë nga dy motorë me hapa të cilët sigurojnë lëvizjen në dy plane të panelit diellor duke siguruar mundësinë e ndjekjes së diellit. Në vazhdim po japim disa mënyra të realizimit të skemës së komandimit të motorëve me hapa, komanda të cilat janë rezultat i përpunimit të imazheve të mara nga kamera.

4.1. Sisteme të thjeshta robotike të komanduara nga kompjuteri, në ndjekjen sipas një, dy dhe tre drejtimeve të një objekti të paracaktuar të ndritshëm.

Në mënyrë të detajuar sistemi i plotë i ndjekjes së një objekti të ndritshëm jepet në Fig 4.1.1.



Fig. 4.1.1. *Sistemi i ndjekjes së objektit të paracaktuar të ndritshëm*

Elementët përbërës të sistemit që ndjek lëvizjen e diellit janë :

- Paisja kompjuterike.
- Moduli i kontrollit të motorit/motorëve me hapa.
- Kamera.
- Paisja e panelit diellor me sistemet mekeanike për lëvizjen rrotulluese të planit të panelit sipas një, dy dhe tre drejtimeve.
- Paisjet e kontrolluesit të nivelit të ngarkimit të baterive, sistemi i baterive, invertori etj.

Hapat kryesorë në realizimin e ndjekjes së objektit të ndritshëm do të paraqiteshin më poshtë nëpërmjet bllok diagramës :



Realizimi i ndjekjes së objektit të ndritshëm, i përshkruar në diagramën e mësipërme, kryhet sipas hapave të mëposhtëm :

- Prej kamerës merret imazhi në kompjuter.
- Përpunohet duke u konvertuar në bardh e zi (green scale).

- Kryhet identifikimi i pozicionimit që ka objekti i ndritshëm në imazh.
- Kryhet llogaritja e zhvendosjes që ka qëndra e objektit të ndritshëm prej qendrës së imazhit.
- Kontrollohet nëse zhvendosjet nga qëndra janë më të mëdha se një vlerë që përbën vlerën minimale për aksion lëvizjeje.
- Kryhet konvertimi i numrit të pikseleve të llogaritur nga pika 4 në numër hapash për motorët me hapa.
- Ekzekutohet komanda që ve në lëvizje motorët me hapa për të kryer rrotullimin e tyre në masën që lidhet me hapat e përcaktuar në pikën 6.
- Procesi ripërsëritet prej pikës 1, pas një intervali kohor.

Do të analizohen dy sisteme të thjeshta të komanduara nga kompjuteri, në ndjekje të një objekti të ndritshëm:

- Komandimi i panelit diellor prej kompjuterit nëpërmjet PIC18F4550-I/P Microchip Microcontroller & ULN2803.
- Komandimi i panelit diellor prej kompjuterit nëpërmjet modulit Stepper-Bee.

Në kapitullin III treguam funksionet që duhen përdorur për komandimin e motorit me hapa prej portës USB nëpërmjet PIC18F4550-I/P & ULN2803 si dhe modulit Stepper-Bee.
Programi që do të kontrollojë ndjekjen e objektit të lëvizshëm (diellit) duke orientuar panelin diellor të pozicionohet kundrejt diellit në mënyrë që energjia e gjeneruar prej fotoelementeve të jetë maksimale. Eshtë i qartë se pozicioni i panelit duhet të jetë i tillë që ai ta shohë 'ballë për ballë' diellin ose thënë ndryshe sipërfaqja e panelit dhe rrezet e diellit të formojnë këndin 90 gradë. Në këtë rast kamera e lidhur ngurtësisht me panelin diellor, me aks të saj perpendikular me planin e panelit do të ketë në qëndër të fokusit diellin. Në mënyrë që kamera të mos dëmtohet nga shkëlqimi diellor, lenta e saj lyhet me bojë të zezë ose mbi lente vendoset një xham i zi.
Gjatë lëvizjes së diellit, imazhi i ndritshëm i marrë nga kamera në një sfont të zi (realizuar nga lyerja me të zezë e lentes ose nga xhami i zi) do të zhvendoset prej pozicionit të tij fillestar. Si rezultat rrezet e diellit nuk do të bien pingul me planin e panelit diellor. Që ato të jenë pingul me këtë panel duhet që imazhi i ndritshëm i diellit të zhvendoset në qender të imazhit të marrë nga kamera. Kjo mund të bëhet vetëm duke realizuar rrotullimin e panelit diellor derisa imazhi i ndritshëm i diellit të zhvendoset në qendër të imazhit. Rrotullimi i panelit mund të bëhet nëpërmjet një motori me hapa, vetëm sipas një drejtimi duke ndjekur lëvizjen e diellit nga lindja drejt perëndimit. Në këtë rast komandimi i panelit djellor realizohet prej kompjuterit dhënë në Fig 4.1.3, nëpërmjet PIC18F4550-I/P Microchip Microcontroller & ULN2803.

Fig. 4.1.3 *Komandimi i panelit diellor prej kompjuterit nëpërmjet PIC18F4550-I/P Microchip Microcontroller & ULN2803*

Rrotullimi i panelit mund të bëhet edhe nëpërmjet dy motorëve me hapa. Në këtë rast lëvizja e diellit do të ndiqej në dy plane, sipas drejtimit nga lindja drejt perëndimit si dhe sipas drejtimit veri-jug.

Fig. 4.1.4 *Komandimi i panelit diellor prej kompjuterit nëpërmjet modulit Stepper-Bee*

Sistemi i ndjekjes së diellit gjatë lëvizjes së tij do të përshkruhet nëpërmjet skemës së dhënë në Fig. 4.1.5. Programi i ndërtuar në Visual Basic 6.0 realizon komandimin e sistemeve të paraqitura në Fig 4.1.3 dhe Fig 4.1.4. Pas identifikimit të pozicionit të imazhit të ndritshëm të diellit në imazhin e përgjithëshëm të kameras, llogaritet numri i pixeleve prej qendës së imazhit të diellit deri në qendrën e imazhit të kamerës. Në figurë këto madhësi përfaqësohen nga NrRreshtaPixelNgaQendraObjektit dhe NrKolonaPixelNgaQendraObjektit. Këto dy madhësi do të konvertohen në numër hapash për motorët me hapa dhe më tej do të jepen komandat që secili prej tyre të kryejë rrotullimin sipas hapave të llogaritur . Kjo do të sigurojë që objekti në ndjekje (dielli) do të zhvendoset drejt qendrës së imazhit të kamerës.



Fig. 4.1.5 *Skema e ndjekjes së djellit prej sistemit pas analizimit të imazhit të marrë nga kamera*

Programi GUI i ndërtuar për komandimin e lëvizjes së panelit sipas një aksi dhe dy akseve jepet në Fig 4.1.6. Aktivizimi fillestar i programit nis me shtypjen e butonit 'INICIALIZIME PER MOTORET' i cili krijon lidhjen me modulin PIC18F4550-I/P Microchip Microcontroller & ULN2803 apo me modulin Stepper-Bee. Programi ka dy mënyra funksionimi, komandimin manual dhe atë automatik të moduleve. Komandimi manual i modulit lejon sistemin të funksionojë në mënyrë manuale duke lejuar përdoruesin të veprojë për komandimin e motorëve A dhe B. Motorët marrin lëvizjet duke vepruar me shigjetat e treguara në GUI dhe ndalojnë pas shtypjes së butonave 'Stop'.
Në program komandat e vënies në lëvizje të motorëve jepen si më poshtë :

```
FilloLevizjenMotori 1, CInt(Abs(.NrRreshtitQenderObjekti - .NrRreshtitQenderImazhi) / txtInterval.Text), txtInterval.Text, 0, 1

FilloLevizjenMotori 2, CInt(Abs(.NrKolonesQenderObjekti - .NrKolonesQenderImazhi) / txtInterval.Text), txtInterval.Text, 1, 1
```

Në GUI jepen të llogaritura koordinatat e qendrës së objektit në ndjekje, koordinatat e qendrës së imazhit si dhe distanca midis tyre në pixel.

Në program koordinatat jepen nëpërmjet kodeve si më poshtë :

```
LlogaritKordinataXY = GjejPozicioninObjektit(Picture1, txtStep.Text)

valRreshtiQenderObjekti.Caption = LlogaritKordinataXY.NrRreshtitQenderObjekti
valKolonaQenderObjekti.Caption = LlogaritKordinataXY.NrKolonesQenderObjekti

valRreshtiQenderImazhi.Caption = LlogaritKordinataXY.NrRreshtitQenderImazhi
valKolonaQenderImazhi.Caption = LlogaritKordinataXY.NrKolonesQenderImazhi

lDistanca_QenderObjekti_QenderImazhi.Caption = LlogaritKordinataXY.Distanca_QenderObjekti_QenderImazhi
```

Kur programi funksionon në komandim automatik të modulit, ai kryhen me rigorozitet të gjitha hapat e dhëna në fillim të këtij paragrafi. Një parametër i rëndësishëm në këtë moment do të jetë 'Gabimi i lejuar në pixel' i cili jep vlerën më të vogël të lejuar të differencës së koordinatave midis

qëndrave të objektit në ndjekje dhe imazhit, për të cilën motorët nuk vihen në lëvizje. Intervalet për çdo rillogaritje të koordinatave të objektit në ndjekje, përcaktohen nga një parametër tjetër i cili shprehet nëpërmejt një komponenti Timer në Visual Basic. Ai do të aktivizohet vetëm atëhere kur të ketë përfunduar lëvizja me hapa e motorëve duke rifilluar ciklin nga e para që me marrjen e imazhit të ri prej kamerës.

Në program komandimi i motorit jepet me kodet :

```
' Fillim i levizjes - Motor 1
Public Function FilloLevizjenMotori(ByVal NumberMotor As Integer, _
                    ByVal Steps As Integer, _
                    ByVal Interval As Integer, _
                    ByVal Direction As Integer, _
                    ByVal Outputs As Integer) As Boolean
  Select Case NumberMotor
  Case 1
    ' Startim i motorit 1
    FilloLevizjenMotori = RunMotor1(Steps, Interval, Direction, Outputs)
  Case 2
    ' Startim i motorit 2
    FilloLevizjenMotori = RunMotor2(Steps, Interval, Direction, Outputs)
  Case Else
  End Select
End Function
```



Fig. 4.1.6. *GUI i ndërtuar për komandimin e lëvizjes së panelit sipas një aksi dhe dy akseve*

Në Shtojcën-8 po japim programin e plotë të ndërtuar në Visual Basic 6.0 për komandimin e modulit PIC18F4550-I/P Microchip Microcontroller & ULN2803 dhe modulit Stepper-Bee në ndjekje të objektit në lëvizje që për rastin në trajtim lidhet me panelin diellor.

Si përfundim mund të themi se :

- Përshkruam një sistem të thjeshtë ndjekës objektesh nëpërmjet përpunimit të imazheve të sjella nga një kamer. Sistemi ndjekës i përshkruar dhe realizuar në këtë kapitull mund të shërbejë për ndjekjen e çfarëdolloj objekti të ndritshëm, pra ai përbën një sistem ndjekës universal. Sistemi ndjekës shpreh një mënyrë se si duke ndjekur lëvizjen e diellit, paneli diellor me fotoelementë pozicionohet sipas drejtimit ku sipërfaqja aktive për fluksin e dritës merr vlerën maksimale.
- Treguam funksionet që duhen përdorur për komandimin e motorit me hapa prej portës USB nëpërmjet :
    - PIC18F4550-I/P & ULN2803
    - Modulit Stepper-Bee.

KAPITULLI V

Hyrje

Pasi kemi përshkruar në kapitullin e parë mënyrat e komandimit të një motori me hapa prej kompjuterit nëpërmjet portave hyrëse dhe dalëse (I/O) e cila përbën bazën kryesore në komandimin e paisjeve robotike, në vazhdim do të shohim se si një sistem robotik i përparuar mund të programohet në realizimin e dy detyrave të shtruara për zgjidhje në këtë material; komandimit dhe orientimit të sistemit robotik në ndjekje të objekteve në lëvizje. Detyrat e shtruara do të zgjidhen bazuar në skemen pricipiale të dhënë në Fig. 5.1, ku paraqitet thelbi i rrugës që do të ndiqet.



Fig. 5.1. *Skema pricipiale e komandimit per robotin*

Në realizimin e detyrave të shtruara më sipër është e nevojshme që përveç paisjeve fizike (pjesës hardware) të sigurohen dhe programet (pjesa software). Programet ose pjesa software përbëhet nga dy pjesë :

- Programi i komandave, i cili shpreh detyrën që duhet të kryhet, nëpërmjet një algoritmi të caktuar.
- Programet e komunikimit me robotin që përfaqësojnë një librari funksionesh dhe komandash, të ndërtuara për mjedise të ndryshme programimi.

Në këtë kapitull do të trajtohen pjesa hardware dhe konkretisht roboti iRobot Create Roomba 4400, i njohur si Roomba 4400 së bashku me aksesorët e tij si dhe paisjet BAM (Bluetooth Adaptor Module), DEBR (Direct Element Bluetooth Radio) dhe Camera Wireless 2.432 GHz.
Gjithashtu, do të tregohet si janë ndërtuar programet e komunikimit me robotin që emërtohen si libraritë e funksioneve dhe komandave për mjedisin Matlab, Visual Basic 6.0, Visual Studio 2005, 2008, 2010, 2012 .Net dhe Basic4Androide (Java).

5.1. Sisteme moderne robotikë të programueshëm.

Sistemet e sotëm robotikë shprehin në mënyrë direkte nivelin e lartë të teknollogjisë në botë. Përdorimet e këtyre sistemeve janë në të gjitha fushat e shoqërisë. Duke u kufizuar vetëm në modelet e iRobot Create, mund të themi se drejtimet kryesore të përdorimit të tyre janë :

- Përdorimet për qëllime të biznesit (a).
- Përdorimet në ambjentet familjare (b).
- Përdorimet në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë (c).

(a) (b) (c)

Fig. 5.2. *Përdorimet në fushat bisnes, familje, mbrojtje dhe siguri.*

Në mënyrë të përmbledhur përdorimet e tyre do të jepeshin si më poshtë.

Përdorimet më të njohura në fushën e biznesit janë kryesisht përdorimet e tyre në :

- Telepresence – video & audio konferenca duke lidhur me pamje dhe figurë njerëz të ndryshëm në lëvizje të lirë të tyre.
- Telemedicine - video & audio biseda midis pacientëve dhe mjekëve që ndodhen larg prej pacientit. Në këtë rast robotët janë të shoqëruar dhe me një numër aplikacionesh ndihmëse për pacientin në zonën e shërbimit për të.
- FitnessRobotike – e cila nënkupton përdorimin e këtyre robotëve si instruktorë të lëvizshëm për persona që zhvillojnë ushtrime fizike në palestra dhe më tej.

Përdorimet më të njohura në ambjentet familjare janë kryesisht përdorimet e tyre si :

- Pastruesa të sipërfaqeve të dhomave dhe sallave të ndryshme.
- Pastruesa të pjesëve të brendëshme të pishinave.
- Pastruesa të pjesëve specifike të çative (ulluqeve) kur ato janë të mbuluara nga gjethet apo plurat e baltosur.

Përdorimet më të njohura në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë janë kryesisht përdorimet e tyre në :

- Shërbime publike - këta robotë janë të aftë për të mbajtur njeriun larg nga zona e rezikut duke zgjidhur problemet në distancë, në mënyrë të përsosur. Përdorime të tilla mund të jenë rastet kur duhet të punohet në mjedise me agjentë të dëmshëm për njeriun si p.sh në zona me radioaktivitet apo në mjedise acide, helmuese etj.
- Fushën e sigurisë - përdorimi i tyre për hetim, mbulim, verifikime dhe çaktivizime të lëndëve plasëse etj. Këta robotë janë të paisur me sisteme të sofistikuara sensorësh bazuar në ultratingujt, kamerat, infrared, blutouth, Wi-Fi dhe GPS për kontroll në distancë.
- Fushën e mbrojtjes - robotë të fuqishëm me një lëvizmëri të madhe në terrene të vështira dhe shkallë me aftësi ngritje peshash deri në 150 kg, të pajisur me sisteme vëzhgimi, infrared, blutouth, sensore nxehtësie dhe Wi-Fi dhe GPS për kontroll në distancë.

iRobot Create Roomba 4400 është pjesë e grupit të robotëve që përdoren në ambjentet familjare si dhe për qëllime studimi si një robot i programueshëm.

5.2. Roboti model Roomba 4400.

iRobot Create Roomba 4400 është një robot i programueshëm i cili të lejon të ndërtosh programe që do të kontrollonin dhe drejtonin sjelljen e tij, pa u shqetësuar për gjuhën e programimit në nivel të ulët. Gjithashtu Roomba 4400 ofron një grup komandash dhe funksionesh të ngjashme me “driver” komandat. Me robotin Roomba 4400 të paraqitur në Fig 5.3, mund të ndërtohen sisteme më të zhvilluara duke shtuar paisje të tjera elektronike si krah robotik, ekrane të vegjël dhe sensorë të

ndryshëm. Edhe në këto raste përsëri përdoruesit kanë hapësirë për të komanduar këto sisteme duke punuar jo në gjuhë të nivelit të ulët por në gjuhë të nivelit të mesëm dhe të lartë.

Fig. 5.3. *Roomba 4400 dhe aksesorë të tjerë.*

Aksesorët që lidhen me Roomba 4400 po i përshkruajmë shumë shkurtimisht më poshtë :

- Remonte Control - shërben për të dërguar komanda direkt në robot prej përdoruesit.

- Virtual Halo for iRobot Create - Kufizon vajtjen e robotit në zona të caktuara, duke shfrytëzuar rezet infrared, ku mund të këtë kafshë apo zona me ushqime, ujë etj.

- Compact Home Base® for Create - Baza e ngarkimit të baterive të robotit paisur me komunikim infrared.

- Advanced Power System (APS) 3000 mAh NiMH Battery.

- Ushqyesi i tensionit me nivel 16 V - Karikon bateritë e robotit në 3 orë.

- BAM - Paisja e komunikimit me valë bluetooth e cila montohet në porta me 25 pine e robotit.

- DEBR (Direct Element Bluetooth Radio) - Paisja e komunikimit me valë bluetooth e cila montohet në kompjuter në një nga portat USB dhe komunikon me BAM pas konfigurimeve të nevojshme.

- Kablli serial për komunikimin midis kompjuterit dhe robotit.

- RCM - Robot Command Module nëpërmjet këtij moduli me ATMega168 microcontroller bëhet e mundur lidhja e robotit me kompjuterin. Ky modul përmban katër porta seriale dhe një USB.

Komandimi i robotit mund të bëhet në dy mënyra nga kompjuteri duke shfrytëzuar :

- Lidhjen seriale nëpërmjet UART (Universal Asynchronous Receiver/Transmitter) të paraqitur në Fig. 5.4 dhe në Fig. 5.5, pjesë e komunikimit tek paisjet kompjuterike kur komunikimet kryhen në portat paralele dhe seriale. Komunikimi nëpërmjet UART përmbledh lidhjet e njohura VNM, RS-232, RS-422 dhe RS-485. Përcaktimi 'Universal' në emërtimin e UART, nënkupton se transmetimi i të dhënave kryhet me shpejtësi të konfigurueshme.



Fig. 5.4. *Portat seriale, kablli serial, porta seriale 25 pin.*

Konfigurimet për komunikimet me robotin janë në vlerat e mëposhtëme :
Baud: 57600 or 19200 ; Data bits: 8; Parity: None; Stop bits: 1; Flow control: None
iRobot Create komunikon në band 57600 bit/sec. N.q.s se jeni duke përdorur mikrocontroller që nuk suporton baud 57600 bit/sec, atëhere ka dy rrugë të konfigurohet iRobot Create në baud 19200 bit/sec.



Fig. 5.5. *Komunikimi i PC me Roomba 4400 sipas nëpërmjet pasijes UART (seriale).*

- RCM (Robot Command Module) një modul me mikrokontroller ATMega168. Për këtë rast komunikimi fizik bëhet nëpërmjet një kablli USB që lidh kompjuterin me RCM. Në këtë material nuk do të trajtojmë zgjidhjen e detyrave të shtruara me ndihmën e këtij moduli.

Komunikimi me robotin nga kompjuteri nëpërmjet objekteve dhe portave seriale mund të realizohet fizikisht në dy mënyra të cilat po i rendisim më poshtë :

- Lidhja kabllore nga portat seriale paraqitur në Fig. 5.6. Në gjuhët e programimit komunikimi i PC me Roomba 4400 realizohet nëpërmjet objekteve seriale.

Fig. 5.6. *Komunikimi i PC me Roomba 4400 me kabël.*

- Lidhja valore realizuar nga dy paisje ndihmëse BAM dhe Direct Element Bluetooth Radio nëpërmjet objekteve seriale, paraqitur skematikisht në Fig. 5.7

Fig. 5.7. *Komunikimi i PC me Roomba 4400 me Bluetooth*

.

Në gjuhët e programimit komunikimi i PC me Roomba 4400 për të dyja rastet realizohet nëpërmjet objekteve seriale te konfiguruar në vlerat :

Baud: 57600 or 19200 ; Data bits: 8; Parity: None; Stop bits: 1; Flow control: None

Në vazhdim të ndërtimit të robotit mund të themi se ai përbëhet nga dy pjesë kryesore :

- Pjesët e lëvizëshme (actuators). Këtu hyjnë pesë motorët e robotit Roomba.

- Sensorët të cilët klasifikohen në tre grupe sipas funksionit që ata kryejnë :
  - Të jashtëm që sjellin në robot informacione nga mjedisi përreth.
    - *Bumper* : Parakolpi është pjesë e luajtshme në pjesën e përparme të Roombas siç tregohen në Fig 5.8 (a). Roboti ka një sensor presioni në çdo anë të parakolpit (gjithsej janë dy), kështu që mund të themi se nëse Roomba përplaset në diçka në anën e majtë apo të djathtë, sensorët japin informacion mbi përplasjen.
    - *Wheeldrops* : Në secilën nga rrotat e robotit ka nga një sensor që sinjalizon nëse rrota është e shkëputur nga toka ose jo, siç tregohen në Fig 5.8 (b). Gjithsej ka tre të tillë .
    - *Wall* : Sensori i murit është një sensor infrared që përcakton nëse roboti është duke ecur ngjitur me murin. Ky sensor është në pjesën e djathtë të përparme të parakolpit të robotit.
    - *Cliff* : Janë katër sensorë të tillë përgjatë parakolpit në pjesën e brendëshme të poshtëme të parakolpit siç tregohen në Fig 5.8 (c). Këta sensorë mund të shikohen pas kthimit përmbys të robotit ku mund të shikohen diodat infrared të plastifikuara. Funksioni i tyre jepet në figurën e mëposhtëme.



- *Virtual wall* : Sensori i murit virtual është një sensor infrared i kapjes së valës në të gjitha drejtimet (omnidirectional), vendosur në pjesën e sipërme të parakolpit. Paisja e murit virtual nxjerr një sinjal të moduluar të valëve infra të kuqe, dhe në qoftë se Roomba merr këtë sinjal ai zbulon murin virtual. Në këtë mënyrë roboti reagon duke ju shmangur kufizimit të murit virtual. Vlera 0 (zero) nënkupton mungesën e murit virtual.
- *Motor Overcurrents* : Sensorët e mbirrymës janë sensorë që lidhen me çdonjërin nga pesë motorët e robotit të cilët janë :
  - Motori i rrotës së majtë
  - Motori i rrotës së djathtë
  - Motori i furçës kryesore
  - Motori i vakumit
  - Motori i furçës anësore

  Kur ndonjë prej motorëve nuk mund të rrotullohet prej pengesave të jashme që shfaqen, në këta motorë mbirrymat që lindin janë shenja që venë në veprim sensorët e mbirrymës.
- *Dirt Dedect* : DD sensor është një disk i vogël bronxi në pjesën e furçës së vakumit që jep informacion mbi madhësinë e ndotjes.



(a) (b) (c)

Fig. 5.8. *Sensorët e jashtëm në Roomba 4400*

- Të brendshëm që sjellin në robot informacione për gjendjen e brendshme të robotit.
  - *Charging state* : Tregon gjendjen e Roombas në ngarkim (ushqim ose në gjuhën popullore karikim): Jo ngarkuar, duke u ngarkuar, gabim ngarkimi.
  - *Voltage* : Tregon nivelin e tensionit në mV. Kjo është normalisht midis 15000 - 17000 mV.

- *Current* : Sensori që jep vlerësim për rrymën që rrjedh në baterinë e robotit. Ajo ka shenjë pozitive kur roboti është duke u ngarkuar dhe negative kur është duke u shkarkuar.
- *Temperature* : Sensori që shpreh temperaturën e baterisë në ^0C .

- Të pozicionit dhe ndërlidhjes të cilët marrin informacione mbi lëvizjen dhe ndërlidhjen (remote control).
  - *Buttons* : Sensorë binarë që kanë dy gjendje 1 (on - shtypur) ose 0 (off - jo shtypur).
  - *Distance* : Jep distancën në *mm* për rrugën që ka kryer roboti që prej kërkesës së fundit për *distancën.*Vlera e dhënë nuk është plotësisht e saktë për të gjitha rastet sepse rrotat e robotit në raste rrëshqitjeje nuk reflektojnë lëvizjen. Distanca është rruga mesatare e kryer e dy rrotave të robotit dhënë në Fig. 5.9 (a,b,c). Pas zerimit, vlera fillon nga zero.
  - *Angle* : Këndi për këtë rast llogaritet nëpërmjet disa formulave specifike të nxjerra nga projektuesit e robotit që marrin parasysh dy leximet e njëpasnjëshme të lëvizjes së robotit. Edhe vlera e këtij sensori si edhe ajo e sensorit *distance* është jo plotësisht e saktë, për të njëjtat arsye që u përshkruan më sipër, që lidhej me rrëshqitjet e rrotave të robotit dhënë në Fig. 5.9 (a,b,c).
  - *Remote Opcode* : Sensori që merr komandat e dërguara nga Remote Control. Gjendja e tij është 255 kur mungojnë komandat.

(a) (b) (c)

Fig. 5.9. *Sensorët e pozicionit në Roomba 4400*

Në Fig. 5.10 jepen katër raste të përdorimit të Roombas dhe paisjeve të tjera së bashku, në zgjidhjen e detyrave që kemi shtruar në këtë material dhe të cilat do të trajtohen më hollësisht në vijim.



Fig. 5.10. *Roomba 4400 lidhur me paisje të tjera laptop, android mobile dhe kamera.*

5.3. Specifikime dhe libraria e komandave në mjedisin Matlab.

iRoboti Create është një model më së miri i programueshëm në Matlab. Ndërtimi i programeve në Matlab bëhet edhe më i thjeshtë pasi për këtë robot është ndërtuar një librari që siguron komunikimet me të. Në këtë librari të ndërtuar nga Joel Esposito, Owen Barton, Joshua Koehler, David Lim, SEAP Interns, jepen të gjithë funksionet e komadimit dhe ato të gjendjes së robotit Roomba [42]. Njohja e kësaj librarie është shumë e rëndësishme sepse ajo do të përbëjë një bazë të rëndësishme të mënyrës se si do të organizohen programet për kryerjen e detyrave të ndryshme si dhe kjo librari do të jetë baza për ndërtimin e librarive në mjedise të tjera programimi që do të përshkruhen në paragrafet në vijim.

Paisjet fizike në realizimin e lidhjes midis PC dhe robotit.

Pavarësisht lidhjes fizike që realizon komunikimin e kompjuterit me robotin si mini-DIN, USB-serial adapter ose Bluetooth, Matlab-i i trajton të gjitha lidhjet si një lidhje në portë seriale. Matlab-i menaxhon portën seriale të komunikimit duke krijuar atë që njihet si 'serial port object'. Ato janë variabla objekt, që përmbajnë të gjithë numrat e portave seriale dhe parametrat që do të duhen për të komunikuar me Roomba 4400 [39].

Funksione te librarise per realizimin e komunikimit te kompjutertit me robotin.

Krijimi i variablit objekt të portës seriale në Matlab bëhet si më poshtë :

```
>> [serialObject] = RoombaInit(1) ;
```

Variabli hyrës në funksion, është një numër i plotë që specifikon numrin e portës, p.sh `RoombaInit(1)` përdoret kur krijohet variabël objekt për portën seriale COM1.

```
function [serPort] = RoombaInit(my_COM);
%[serPort] = RoombaInit(my_COM)
% By; Joel Esposito, US Naval Academy, 2011
global td
td = 0.015;
% This code puts the robot in CONTROL(132) mode, which means does NOT stop
% when cliff sensors or wheel drops are true; can also run while plugged into
charger
Contrl = 132;
% Esposito 9/2008
warning off
%% set up serial comms,
% output buffer must be big enough to take largest message size
comm = strcat('COM', num2str(my_COM));

a = instrfind('port',comm);
if ~isempty(a)
            disp('That com port is in use.   Closing it.')
            fclose(a);
            pause(1)
            delete(a);
            pause(1)
end

disp('Establishing connection to Roomba...');
```

```
% Band rate - defaults at 57600, can change
% Kompjuteri dhe Matlab komunikojnë në 576000 baud. Kjo nënkupton që ka një limit
% se sa shpejt roboti dërgon, merr dhe i përgjigjet komandave.

serPort = serial(comm,'BaudRate', 57600);
set(serPort,'Terminator','LF')
set(serPort,'InputBufferSize',100)
set(serPort, 'Timeout', 1)
set(serPort, 'ByteOrder','bigEndian');
set(serPort, 'Tag', 'Roomba')
disp('Opening connection to Roomba...');

fopen(serPort);                  %% Hapja e portes seriale te gjedhur

%% Confirm two way connumication
disp('Setting Roomba to Control Mode...');

% Start! and see if its alive
Start=[128];
fwrite(serPort,Start);
pause(.1)
fwrite(serPort,Contrl);
pause(.1)
% light LEDS
fwrite(serPort,[139 25 0 128]);
disp('I am alive if my two outboard lights came on')
confirmation = (fread(serPort,4))
pause(.1)
```

Nëse funksioni inicializon drejt robotin, do të shohim dy drita të ndezura në pjesën e sipërme të tij. Nëse dështon inicializimi, fillimisht kontrollohet porta COM, që të mos jetë e zënë prej ndonjë programi tjetër. Pas këtij veprimi, veprimi i radhës është rindezja përsëri e robotit. Në të gjitha rastet duhet të sigurohemi që kablli i ushqimit të mos jetë i lidhur dhe me tension. Funksioni i mësipërm starton robotin në 'full mode'. Output-i i funksionit (`RoombaInit`) është një objekt i portës seriale që përmban të gjitha karakteristikat për të komunikuar me robotin. Nëse kemi disa robotë Roomba që do të dëshironim të operonin në të njëtën kohë, secili prej tyre mund të lidhej me një portë të veçantë. Një mënyrë tjetër komunikimi bëhet nëpërmjet Bluetooth-it, i cili e bën më të thjeshtë, por mund të shfrytëzohen edhe paisjet USB hub ose Serial hub. Në rastin e operimit me dy robotë, do të nevojitej të krijohen objekte për portat seriale për çdo robot [39]. Në rastin e tre robotëve inicializimet do të qenë :

```
>> [ObjectSerialRoomba1] = RoombaInit(1) ;
>> [ObjectSerialRoomba2] = RoombaInit(2) ;
>> [ObjectSerialRoomba3] = RoombaInit(3) ;
```

Janë dy metoda për të lexuar gjendjet e sensorëve :

- Përdorimi i funksionit `AllSensorsReadRoomba`. Ky funksion rikthen shumë shpejt vlerën e të gjithë sensorëve më një kërkesë të vetme. Përgjigja përbën një varg të gjatë string, i cili përmban gjendjen e sensorëve të robotit. Pas thirrjes së këtij funksioni përveç leximit të gjendjeve të sensorëve, bëhet dhe zerimi i vlerave për distancën dhe këndet e lëvizjes. Kjo do të thotë se përdorimi i kësaj komande jo në çdo rast është i përshtatshëm. Në të tilla kushte, përcaktimi i vlerave për distancën dhe këndet e lëvizjes do të bëhet nëpërmjet programeve specifike të ndërtuara nga programues.

- Përdorimi individual i komandave për sensoret si p.sh : DistanceSensorRoomba, AngleSensorRoomba, BatteryVoltgeRoomba, etj. Kjo metodë ka avantazhin se duke përdorur komanda të veçanta bëhet e mundur të informohemi për parametra dhe madhësi të specifikuara, në një kohë të shkurtër. E meta e kësaj metode është se informacionet për parametrat dhe madhësite e kërkuara nuk janë koherente, që do të thotë se ato të grupuara nuk përfaqësojnë gjendjen e robotit në një çast të kohës. Kështu n.q.s do të duhej të informoheshim për këndin e lëvizjes prej funksionit *AngleSensorRoomba* dhe distancën e kryer prej funksionit *DistanceSensorRoomba* , rezultatet e marra do të përfaqësonin vlerat në kohën t_1 dhe t_2 , kohë kur janë ekzekutuar funksionet përkatëse. I njëjti arsyetim nuk do të bëhej për rastet kur do të kërkohej informacion mbi gjendjen e robotit (sensorëve të ndryshëm), për sa kohë nuk ndryshon gjëndja e tyre.

Më poshtë po japim listën e funksioneve inicializuese dhe atyre që përcaktojnë gjëndjen e sensorëve, parametrave kryesorë dhe madhësive që përcaktojnë lëvizjen [39].

- *RoombaInit* Inicializon portën seriale për t'u përdorur me Roomben

Leximi i gjëndjeve të sensorëve :

- *[BumpRight, BumpLeft, BumpFront, Wall, virtWall, CliffLft, ...*
  CliffRgt, CliffFrntLft, CliffFrntRgt, LeftCurrOver, RightCurrOver, ...
  DirtL, DirtR, ButtonPlay, ButtonAdv, Dist, Angle, ...
  Volts, Current, Temp, Charge, Capacity, pCharge] = AllSensorsReadRoomba(serPort);

  Ky funksion lexon të gjithë sensorët e Roombës në të njëjtën kohe. Vlerat e kthyera janë 0 ose 1, për variablat llogjikë të mëposhtëm :

  BumpRight (0/1),
  BumpLeft(0/1),
  BumpFront(0/1),
  Wall(0/1),
  virtWall(0/1),
  CliffLft(0/1),
  CliffRgt(0/1),
  CliffFrntLft(0/1),
  CliffFrntRgt(0/1),
  LeftCurrOver (0/1),
  RightCurrOver(0/1), ...
  DirtL(0/1),
  DirtR(0/1),
  ButtonPlay(0/1),
  ButtonAdv(0/1),
  Dist (metrat që nga thirrja e fundit),
  Angle (këndi në rad që nga thirrja e fundit),
  Volts (V),
  Current (Amps, positive is charging),
  Temp (celcius),

Charge (milliamphours),
Capacity (milliamphours),
pCharge (ngarkesa në %)

Nëse do të duhet të lexojmë disa sensorë në të njëjtën kohë, kjo do të ishte mënyra më e shpejtë, krahasuar me rastin e thirrjeve individuale të funksioneve të sensorëve. Por duhet patur kujdes sepse sa herë që thirret funksioni *AllSensorsReadRoomba*, ai zeron (reset-on) vlerat për sensorët e distancës dhe të këndit. Këta sensorë do të kthejnë distancën e kryer që nga thirrja e fundit.

- *[AngleR]=AngleSensorRoomba(serPort)*
  Këndi që është kthyer Roomba gjatë lëvizjes që prej leximit të fundit. Variabli *serPort* tregon objektin serial nëpërmjet të cilit realizohet lidhja e Roombës me kompjuterin. Rezultati i marrë nga thirrja e këtij funksioni është një numër real (dooble) i cili mund të marrë vlera positive ose negative. Këndet në drejtim të kundërt me akrepat e orës janë positive dhe këndet në drejtimin e akrepave të orës janë negativë.

- *[Charge, Capacity, Percent] =BatteryChargeReaderRoomba(serPort)*
  Funksion për gjendjen e baterisë. Funksion kthen tre vlera të cilat janë :
  - Karikimin e mbetur (milliAmpHours)
  - Kapacitetin maksimal të baterisë (mAH)
  - Përqindjen e mbetur të baterisë

- *[Voltage]=BatteryVoltageRoomba(serPort)*
  Tregon nivelin e tensionit të baterisë në volt (V).

- *[BumpRight,BumpLeft,WheDropRight,WheDropLeft,WheDropCaster,BumpFront] = BumpsWheelDropsSensorsRoomba(serPort)*
  Funksioni kthen gjendjen e sensorëve *të përplasjes (bump)* dhe *rënies së rrotës* (*wheel drop)*. Parakolpi në roboti është pjesë e luajtshme, në pjesën e përparme. Ai ka një sensor presioni në çdo anë të tij (gjithsej janë dy), kështu që mund të themi se nëse Roomba përplaset në diçka në anën e majtë apo të djathtë, sensorët japin informacion mbi përplasjen.
  BumpFront merr vlere kur te dy sensoret *BumpRight* dhe *BumpLeft* kanë marrë vlera. Nëse ndodh kështu, *Right* dhe *Left* marrin vlerat 0 dhe *Front* merr vlerën 1.

- *[ButtonAdv,ButtonPlay] = ButtonsSensorRoomba(serPort)*
  Shfaq gjendjen e butonave Play dhe Advance te Roombes per gjendjet shtypur (1), ose jo shtypur (0).

- *[state] = CliffFrontLeftSensorRoomba(serPort)*
  Gjendja e sensorit *cliff front left*. Variabli *state* merr vlerat 1 (ngacmuar) ose 0 (jo i ngacmuar)

- *[strg] = CliffFrontLeftSignalStrengthRoomba(serPort)*
  Fuqia e sinjalit të sensorit *front left cliff* në % . Vlerat e *strg* janë në intervalin $(0-100)\%$

- *[state] = CliffFrontRightSensorRoomba(serPort)*

Gjendja e sensorit *cliff front right*. Variabli $state$ merr vlerat 1 (ngacmuar) ose 0 (jo i ngacmuar)

- *[strg] = CliffFrontRightSignalStrengthRoomba(serPort)*
  Fuqia e sinjalit të sensorit *front right cliff* në % . Vlerat e $strg$ janë në intervalin $(0-100)\%$

- *[state] = CliffLeftSensorRoomba(serPort)*
  Gjendja e sensorit të *cliff left*. Variabli $state$ merr vlerat 1 (ngacmuar) ose 0 (jo i ngacmuar)

- *[strg] = CliffLeftSignalStrengthRoomba(serPort)*
  Fuqia e sinjalit të sensorit *left cliff* në % . Vlerat e $strg$ janë në intervalin $(0-100)\%$

- *[state] = CliffRightSensorRoomba(serPort)*
  Gjendja e sensorit të *cliff right*. Variabli $state$ merr vlerat 1 (ngacmuar) ose 0 (jo i ngacmuar)

- *[strg] = CliffRightSignalStrengthRoomba(serPort)*
  Fuqia e sinjalit të sensorit *right cliff* në % . Vlerat e $strg$ janë në intervalin $(0-100)\%$

- *[Current] = CurrentTesterRoomba(serPort)*
  Paraqet energjinë (në amper) që rrjedh brenda ose jashtë baterisë. Rryma negative tregon se energjia është duke u konsumuar pra duke "ikur jashtë" baterisë. Rryma positive tregon se është duke u karikuar pra energjia po "shkon drejt" baterisë.

- *[Distance] = DistanceSensorRoomba (serPort)*
  Funksioni kthen madhësinë $Distance$ të kryer gjatë lëvizjes prej robotit të lidhur në portën $serPort$. Kjo distancë llogaritet prej momentit të zerimit të fundit, që lidhet me përdorimin e herës së fundit të këtij funksioni. Kur vlera e marrë prej funksionit është pozitive, kjo nënkupton se drejtimi i lëvizjes është në të njëjtën kahje me lëvizjen paraardhëse. Kur vlera e marrë është negative, kjo nënkupton se drejtimi i lëvizjes është në të kundërt me kahjen e lëvizjes paraardhëse. Vlerat e kthyera janë në diapazonin $(32.768 \div -32.768)\ \mathrm{m}$.

Komandat që mund të dërgohen drejt robotit :

- *DemoCmdsCreate*
  Plays built-in demos

- *SetLEDsRoomba(serPort, LED, Color, Intensity)*
  Diodat LED në pjesën e sipërme të robotit tek butonat *Play* dhe *Advance* janë në gjendjet *on* ose *off* dhe kontrollohen nga variabli $\mathrm{LED} = 0(off) / 1(on), 2(on), 3(on)$.
  1 për të kthyer *Play* jeshile.
  2 për të kthyer *Advance* jeshile.
  3 për të kthyer *Play* dhe *Advance* jeshile.
  $Color$ përcakton se ç'farë ngjyre do të marrë LED . Vlerat e këtij variabli janë :
  $$Color = 0\%(jeshile) \div 100\%(kuqe).$$
  $Intensity$ tregon se sa shumë do të shkëlqejë.

- *SetFwdVelRadiusRoomba(serPort, FwdVel, Radius)*
  Funksioni lëviz robotin duke specifikuar shpejtësinë dhe këndin. Variabli $serPort$ është një objekt serial port e krijuar nga *Roombainit*. $FwdVel$ është shpejtësia përpara në $\frac{m}{s}$ në kufijtë $[-0.5,\ 0.5]$. $Radius$ është në metra, positive në anë të kundërt me akrepat e orës, negative në drejtimin e akrepave të orës. Vlerat merren nga $[-2,\ 2]$.
  Raste speciale :
  - Lëvizje drejtvizore $Radius = Inf$ (infinit ne Matlab)
  - Rrotullohet në vend në kahun e akrepave të orës kur $Radius = -eps$ (eps është një vlerë reale shumë e vogël në Matlab)
  - Rrotullohet në vend në kahun e kundërt të akrepave të orës kur $Radius = -eps$ (eps është një vlerë reale shumë e vogël në Matlab)

- *SetDriveWheelsCreate(serPort, rightWheel, leftWheel)*
  Specifikon shpejtësine lineare të rrotës së majtë $leftWheel$ dhe të djathtë $rightWheel$ në $\frac{m}{s}$ $[-0.5,\ 0.5]$. Shpejtësia negative është lëvizje mbrapsht.

- *SetFwdVelAngVelCreate(serPort, FwdVel, AngVel)*
  Komanda siguron një lëvizjë të robotit me një shpejtësi përpara $FwdVel = (-0.5 \div 0.5)\frac{m}{s}$ dhe në një lëvizje rrethore me shpejtësi këndore $AngVel$.

- *BeepRoomba(serPort)*
  Komanda siguron një sinjal akustik tek roboti. Beep-i është i gjatë 20/64 pjesë të një sekonde. Kur komanda ekzekutohet në mënyrë të përsëritur, sekuencat nuk dallohen nga njëra tjetra duke krijuar idenë e një sinjali akustik të vijushëm. Për të ekzekutuar sinjale akustike të ndarë në kohë nga njeri tjetri përdoret komanda *pause(time)* si në rastin e mëposhtëm :
  >> BeepRoomba(serPort); pause(0.5); BeepRoomba(serPort);

- *travelDist(serPort, speed, distance)*
  Komandon robotin e lidhur në portën $serPort$ të kryejë zhvendosjen *distance* në metra, me një shpejtësi $speed = (0.025 \div 0.5)\frac{m}{s}$.
- *turnAngleturnAngle(serPort, speed, turnAngle)*
  Komandon robotin e lidhur në portën $serPort$ të kryejë rrotullimin në këndin $turnAngle = (-360 \div 360)^0$ me një shpejtësi këndore $speed = (0 \div 0.2)\frac{rad}{s}$.

Për të komanduar robotin prej tastjerës së kompjuterit thirren funksionet e mëposhtëme :

- *[keyPresses , elapsedTime] = RobotHardKeyBoard(CommPort)*

Roomba mund të kontrollohet nga tastierë numerike ose alfabetike. Për të dalë nga kontrolli i robotit nga tastiera, shtypet ne tastjerë butoni '*Q*'.

- Komandimi nga tastiera numerike.



8 – > lëviz 10 cm përpara
5 – > lëviz 5 cm prapa
4 – > kthen majtas 15 gradë
7 – > kthen majtas 5 gradë
6 – > kthen djathtas 15 gradë
9 – > kthen djathtas 5 gradë

- Komandimi nga tastiera alfabetike.



Y – > leviz para 10cm
H – > leviz prapa 5cm
G – > leviz 15 grade majats
T – > leviz 5 grade majtas
J – > leviz 15 grade djathtas
U – > leviz 5 grade djathtas

- *varargout = RobotGuiControl(varargin)*
  Roomba mund të kontrollohet nga shigjetat në ekranin e kompjuterit. Njëlloj si tek funksioni *RobotHardKeyBoard*
  .
  Shigjetat kontrolluese :

Shigjeta e madhe përpara	– >	10 cm
Shigjeta e vogël përpara	– >	5 cm
Shigjeta prapa	– >	5 cm
Shigjeta e madhe majtas	– >	15 grade
Shigjeta e vogël majatas	– >	5 grade
Shigjeta e madhe djathtas	– >	15 grade
Shigjeta e vogel djathtas	– >	5 grade



Duke u mbështetur në listën e gjatë të funksioneve dhe komandave të dhëna në këtë paragraf, bëhet shumë i thjeshtë komandimi i robotit për kryerjen e detyrave të caktuara, ndërmjet të cilave dhe të atyre që janë shtruar për zgjidhje në këtë material. Një pjesë e këtyre funksioneve do të përdoren në realizimin e komandimeve sipas algoritmave të ndërtuar për kontrollin e pozicionit të robotit kundrejt objekteve të tjera në mjedis, objekte në lëvizje ose në prehje.

Në file-in MatlabToolboxiRobotCreate.zip, i cili mund të zbritet nga faqja : *www.usna.edu/Users/weapsys/esposito/roomba.matlab/*, jepen funksionet për komandimin e lëvizjeve të robotit në Matlab zhvilluar nga Joel Esposito, Owen Barton, Joshua Koehler, David Lim, SEAP Interns [39].

5.4. Specifikime dhe libraria e komandave në Visual Studio .Net (VB). Komunikimet me kabëll (wire) dhe me valë (wireless and bluetooth).

iRoboti Create është një model i programueshëm i versionit Roomba Model 4400 [41] që përdoret për qëllime mësimi dhe studimi. Për komandimin e këtij roboti prej PC është e nevojshme shfrytëzimi i portës seriale (7 pin Mini - DIN connector) ose i portës DB 25 pin ku montohet paketa Bluetooth (Fig 5.13). Programet që përbëjnë librarinë e ndërtuar paraqiten nga një grup komandash dhe funksionesh të cilat realizojnë detyra specifike. Kjo librari do të shërbejë si një urë lidhëse ndërmjet robotit dhe përdoruesit kur ai programon detyra specifike në Visual Basic.NET [5], në dërgimin e komandave drej robotit. Komandat përgjithësisht venë robotin në veprim lëvizjeje ndërsa funksionet sjellin tek përdoruesi vlerat e madhësive që karakterizohen si parametra të robotit si psh madhësia e tensionit të baterive, gjendjet e sensorëve të robotit, rrugën e kryer prej tij, etj.

Paisjet fizike në realizimin e lidhjes midis PC dhe robotit.

Dërgimi i instruksioneve dhe komandave drej robotit do të realizohet fizikisht nëpërmjet kabllit serial i cili në PC lidhet në portën COM ndërsa në iRobot Create lidhet në portën seriale 7 pin Mini-DIN connector (Fig 5.13). Pasi është bërë lidhja fizike është e nevojshme konfigurimi i portës COM në PC. Kjo në PC realizohet në Control Panel / System / Hardware / Device Manager / Ports (LPT & COM). Për konfigurin e portës seriale duhet në fillim të përcaktohet cila portë COM është lidhur (COM1, COM2 ...).Në rastin e nje PC desktop parapëlqehet që lidhja ne PC të realizohet në COM1; në rastin e një laptopi i cili nuk përmban fizikisht portë COM, lidhja realizohet nëpërmjet një konvertuesi USB në COM. Lidhja valore me robotin mund të realizohet nëpërmjet paketes Bluetooth të njohur si Element Direct - BAM (Bluetooth Adaptor Module) .



Fig 5.13. *iRobot Create dhe elementi BAM*

Programet e komunikimit te kompjutertit me robotin.

Komandimi i iRobot Create kryhet nëpërmjet një programi të thjeshtë i cili përbëhet nga një dritare ku janë vendosur disa butona me simbolikat e lëvizjeve më të mundëshme të robotit.
Pas cdo butoni që klikohet ekzekutohen komanda dhe funksione të cilat janë në përbërje të librarisë së ndërtuar në Visual Basic .NET. Në një tjetër punim, për ndërtimin e librarisë së komandimit të robotit është shfrytëzuar ActiveComport Serial Port [36]. Për realizimin e komunikimeve me Roomba 4400 në këtë paragraf nëpërmjet portës seriale do të shfrytëzohet libraria e .NET System.IO.Ports [41].

Programimi me librarinë .NET SYSTEM.IO.PORTS.

Problemi i komunikimit nëpërmejt portës seriale edhe pse është një problem i trajtuar në shumë materiale, përsëri ka specifikat e veta. Realizimi i komunikimit duke qenë kompleks ka bërë që kompani të specilizuara të ndërtojnë programe ndihmëse që shërbejnë si ura lidhëse midis programuesve dhe portës seriale. Përdorimi i librarisë së .NET System.IO.Ports është me qëllime të ndryshme si psh komandimi i paisjeve industriale të ndryshme që mund të komunikojnë me kompjuterin nëpërmjet portës seriale, komandimi dhe kontrolli i ruterave të ndryshëm në rrjet, kontrolli i modemave serialë, Bluetooth etj [36]. Kontrolli i paisjeve që lidhen me kompjuterin nëpërmjet portave USB trajtohen si lidhje me porta virtuale seriale. Kjo siguron që përdorimi i teknikave të menxhimit të portave seriale të jetë i rëndësishëm.

Për të krijuar një serial objekt duke përdorur librarinë e .NET System.IO.Ports janë të domosdoshme linjat e mëposhtme :

```
Imports System.IO.Ports
Private m_CommPort As New SerialPort
```

Objekti serial i krijuar duhet të konfigurohet dhe kryhet hapja e portës së komunikimit. Për rastin konkret për komunikimin me iRobot Create, konfigurimi i tij përcaktohet si më poshtë :

```
    Public Function OpenSerialPort(ByVal ComPort As Integer) As Boolean
        Try
            With m_CommPort
                .PortName = "COM" & CStr(ComPort)
                .BaudRate = 57600
                .DataBits = 8
                .Parity = Parity.None
                .StopBits = StopBits.One
                .Handshake = Handshake.None
                .ReadTimeout = 1000
            End With
            ' Hapja e portes seriale e suksesshme
            Return True
        Catch
            ' Problem ne hapjen e portes seriale
            Return False
```

```
        End Try
    End Function
```

Për të kryer procesin e dërgimit të datave në portë komanda e përdorur është si më poshtë :
`m_CommPort.WriteString( "any text")` ose `m_CommPort.WriteByte wByte`
Instruksioni i parë (`m_CommPort.WriteString( "any text")`) dërgon një informacion në portë të organizuar në një string, ndërsa i dyti (`m_CommPort.WriteByte wByte`) dërgon në portë 1 byte informacion (wByte). Në rastin e komunikimit me iRobot Create instruksioni që do të përdoret për dërgimin e datave në portë do të jetë ai i dërgimit byte pas byte.

Për të kryer procesin e marrjes së të dhënave në portë, të dërguara nga paisja e lidhur në anën tjetër të kabllit serial si psh roboti iRobot Create, përdoren instruksionet e mëposhtme:

```
m_CommPort.ReadByte()

m_CommPort.ReadChar()

m_CommPort.ReadLine()

m_CommPort.ReadTo()
```

Blloku i leximit të datave në portën seriale jepet më poshtë :

```
Dim n As Integer = m_CommPort.BytesToRead
Dim buffer As Byte() = New Byte(n - 1) {}
Dim offset As Integer = 0
Dim count As Integer = 4
Dim returnvalue As Integer
If n > 0 Then
   returnvalue = m_CommPort.Read(buffer, offset, count)
End If
```

Mbyllja e portës seriale të komunikimit kryhet nga komanda :

```
m_CommPort.Close()                    ‘ Komanda per mbylljen e portes
```

Mbështetur në sa u përshkruan më sipër po jepen në vijim disa komanda dhe funksione që do të përdoren për të vënë në lëvije iRobot Create.

Komandat e lëvizjes dhe funksionet e gjëndjes së robotit.

Disa nga komandat dhe funksionet më të përdorëshme do të përshkruhen më poshtë.
Hapja e portës seriale për komunikimin me robotin kryhet nga funksioni :
`RoombaInit “COM3”`
Ndërtimi i këtij funksioni jepen në vijim :

```
Public Function RoombaInit(my_COM As String) As Boolean
   Public Function IsPortAIRobotCreate(ByVal ComPort As Integer) As Boolean
        Try
            With m_CommPort
                .PortName = "COM" & CStr(ComPort)
                .BaudRate = CInt(frmMain.cmbBaud.SelectedItem)
```

```
                .DataBits = 8
                .Parity = IO.Ports.Parity.None
                .StopBits = IO.Ports.StopBits.One
                .Handshake = IO.Ports.Handshake.None
                .ReceivedBytesThreshold = 1
                .RtsEnable = True
                .ReadTimeout = 1000
                .ReadBufferSize = 1000
            End With
            Try
                m_CommPort.Open()
            Catch ex As Exception
                MessageBox.Show(ex.Message)
            End Try
            ' Write an 128 Command to the Port.
            m_CommPort.Write({128}, 0, 1)
            System.Threading.Thread.Sleep(100)
            ' Write an 132 Command to the Port.
            m_CommPort.Write({132}, 0, 1)
            System.Threading.Thread.Sleep(100)
            ' light LEDS
            Dim LedsBytes() As Byte = {139, 25, 0, 128}
            m_CommPort.Write(LedsBytes, 0, 4)
            System.Threading.Thread.Sleep(100)
            Erase LedsBytes
            ' set song
            Dim SongBytes() As Byte = {140, 1, 1, 48, 20}
            m_CommPort.Write(SongBytes, 0, 5)
            System.Threading.Thread.Sleep(50)
            ' sing it
            Dim SingBytes() As Byte = {141, 1}
            m_CommPort.Write(SingBytes, 0, 2)

            ' Lidhja me iRobot Create OK
            Return true
        Catch exc As Exception
            MsgBox("Problem lidhjeje me iRobot Create.", MsgBoxStyle.OkOnly)
            Return False
        End Try
    End Function
```

Funksioni kthen mbrapsh vlerat True ose False për rastet kur lidhja realizohet me robotin ose jo. Lëvijet para, prapa si dhe majtas, djathtas me shpejtësi lineare të përcaktuara për secilën rrotë të robotit jepet nga komanda :

```
SetDriveWheelsCreate ShpejtesiaRrotesMajtas, ShpejtesiaRrotesDjathtas
```

Ku parametrat `ShpejtesiaRrotesMajtas` dhe `ShpejtesiaRrotesDjathtas` përcaktojnë shpejtësitë e rrotës së majtë dhe të djathtë të robotit (Fig 5.14). Shpejtësia lineare e rotave të robotit përcaktohet në vlerat (-500 – 500 mm/s) [37].



Fig 5.14. *Rrotat e iRobot Create dhe shpejtesitë lineare të tyre*

Kur kërkohet lëvizja perpara e robotit pas përcaktimit të shpejtësisë me të cilën ai do të lëvize, mjafton të ekzekutojmë komandën :

```
SetDriveWheelsCreate vLevisjeje, vLevisjeje ‘Shpejtesia  vLevisjeje =[0, 500] mm/s
```

Për lëvizjen prapa do të ekzekutonim komandën :

```
SetDriveWheelsCreate vLevisjeje, vLevisjeje ‘Shpejtesia  vLevisjeje =[-500 , 0] mm/s
```

Rrotullimet me 90 gradë majtas dhe djathtas do të kryheshin nga ekzekutimi i komandave :

```
SetDriveWheelsCreate 0, vLevisjeje   ‘Shpejtesia  vLevisjeje =[0 , 500] mm/s
SetDriveWheelsCreate vLevisjeje, 0   ‘Shpejtesia  vLevisjeje =[0 , 500] mm/s
```

Rrotullimi me 180 gradë majtas dhe djathtas do të kryheshin nga ekzekutimi i komandave :

```
SetDriveWheelsCreate - vLevisjeje, vLevisjeje      ‘Shpejtesia vLevisjeje =[0 , 500] mm/s
SetDriveWheelsCreate vLevisjeje, - vLevisjeje      ‘Shpejtesia vLevisjeje =[0 , 500] mm/s
```

Duke njohur distancën midis rrotave të robotit si dhe shpejtësitë lineare të rrotave jemi në gjendje të përcaktojmë rrotullime në kënde të dëshiruara të sistemit robotik. Për këtë do të shfrytëzojmë disa formula të thjeshta të fizikës. Problemi do të shtrohej në formën : sa duhet të jetë shpejtësia lineare e lëvizjes së rrotave në momentin kur kërkohet rrotullimi i robotit me këndin α ?
Duke u mbështetur në formula të njohura që lidhin shpejtësinë këndore me atë lineare dhe shpejtësine lineare me kohën mund të shkruajmë :

$$\omega = \frac{v}{r} = \frac{2 \cdot v}{d} \qquad (1)$$

$$\omega = \frac{\alpha}{t} \qquad (2)$$

Nisur nga 1 dhe 2 mund të llogaritim shpejtësinë lineare të rrotës për një rrotullim me këndin α të robotit gjatë kohës t.

$$\alpha = \frac{2 \cdot v \cdot t}{d} \qquad (3)$$

Ku d është distanca midis rrotave të robotit Fig 5.15.



Fig 5.15. *Rrotullimi i iRobot Create*

Një komandë për lëvizje të përberë në forme harku rrethi për iRobotCreate jepet si më poshtë :

```
SetFwdVelRadiusRoomba  vLevisjeje, rRezja
```

ku :

`vLevisjeje` është shpejtësia lineare e robotit
`rRezja` është rezja e trajektores që do të përshkruaje roboti (Fig 5.16).



Fig 5.16. *Lëvizja e përbërë e iRobot Create*

Për të ndaluar robotin mund të përdoren komandat :
`SetDriveWheelsCreate 0, 0` ose `SetFwdVelRadiusRoomba 0,1`

Për të dy komandat e përshkruara më sipër madhësitë `vLevisjeje, rRezja` janë numra nga 16 bit pra 4 byte në total. Për rastin kur shpejtësia do të jetë -200 mm/s dhe rezja 500 mm, informacioni që do të dërgohet në portë do të jetë i renditur në byte si në vijim :
`[137] [255] [56] [1] [244]`
Komanda [137] i vendos rrotat e robotin në kontroll për një lëvizje në formë harku.
Vargu i mësipërm përfitohet nga zbërthimi i madhësive sipas formës së mëposhtme [38] :

```
vLevisjeje = -200 = hex FF38 = [hex FF] [hex 38] = [255] [56]
rRezja = 500 = hex 01F4 = [hex 01] [hex F4] = [1] [244]
```

Për të përfituar zbërthimin e mësipërm në Visual Basic .NET do të shfrytëzojmë funksionet `HIBYTE (intParameter)` dhe `LOBYTE (intParameter)` të përshkruara më poshtë :

```
Public Function HIBYTE(ByVal Intg As Integer) As Byte
    HIBYTE = CByte((Intg And &HFF00&) / 256)
End Function

Public Function LOBYTE(ByVal Intg As Integer) As Byte
    LOBYTE = CByte(Intg And &HFF&)
End Function
```

Për të përcaktuar distancën që përshkon roboti thirret funksioni `DistanceSensorRoomba()` i cili kthen mbrapsh metrat e përshkruara.

Për të vënë robotin Roomba në gjendjen beep (tingull zanor) ekzekutohet komanda : `BeepRoombaVBNET().`

Për të marë informacion mbi nivelin e baterive të robotit ekzekutohen komandat : `BatteryChargeReaderRoombaVBNET()` ose `BatteryVoltageRoombaVBNET()` të cilat kthejnë vlerën e tensionit të paketës burim.

Realizimi eksperimental i komunikimit të PC me iRobot Create.

Për të realizuar komandimin e robotit programi i ndërtuar në Visual Basic .NET përbëhet nga një formë (dritare) e paraqitur në Fig 5.17 dhe prej 12 modulesh ku secili prej tyre përmban komanda , funksione që lidhen me komunikimin e robotit si dhe funksione ndihmëse të tjera.



Fig 5.17. *Programi i komandimit të lëvizjes së robotit*

Funksionimi i programit është i thjeshtë. Në dritaren e portës së komunikimit (Fig 5.17) zgjidhet numri i portes seriale. Në rastin kur PC lidhet me robotin me ndihmën e kabllit serial, në portën e komunikimit zgjidhet COM1 ose COM2. Kur lidhjen midis PC dhe robotit e kryejmë në mënyrë valore atëhere në portën e komunikimit zgjidhet COM3 – COM8 (kjo zgjedhje përcaktohet nga bluetooth pas instalimit të saj).

Si përfundim :

- Nëpërmjet këtij paragrafi përshkruam se si mund të realizohet komandimi i robotit prej portës seriale duke shfrytëzuar librarinë e komandave të ndërtuar për këtë qëllim.
- Programi i ndërtuar tregon mënyrën se si mund të shfrytëzohet librarina e .NET System.IO.Ports në Visual Basic .NET.
- Nëpërmjet programit të ndërtuar në Visual Basic .NET tregohet se si mund të thirren komandat për vënien e robotit në lëvizje drejtvizore dhe rrotulluese në mënyrë të kontrolluar.

Në Shtojcën-9 po japim librarinë e komandimit të lëvizjeve të robotit në Visual Basic .NET bazuar në librarinë .NET System.IO.Ports të Microsoft.

5.5. Specifikime dhe libraria e komandave në Visual Studio 6 (VB). Komunikimet me kabëll (wire) dhe me valë (wireless and bluetooth)

Për komandimin e robotit prej PC është e nevojshme shfrytëzimi i portës seriale (7 pin Mini-DIN connector) ose i portës 25 pin (DB 25 pin connector) ku montohet paketa Bluetooth (Fig 5.18), si dhe në paragrafin e mëparshëm. Libraria e ndërtuar përbëhet prej komandash dhe funksionesh të cilat realizojnë detyra specifike. Kjo librari do të shërbejë për dërgimin e komandave prej përdoruesit drej robotit. Komandat përgjithësisht venë robotin në veprim lëvizjeje ndërsa funksionet sjellin tek përdoruesi vlerat e madhësive që karakterizohen si parametra të robotit.

Paisjet fizike në realizimin e lidhjes midis PC dhe robotit.

Dërgimi i instruksioneve dhe komandave drejt robotit do të realizohet fizikisht nëpërmjet kabllit serial i cili në PC lidhet në portën COM ndërsa në iRobot Create lidhet në portën seriale 7 pin Mini-DIN connector (Fig 5.18). Pasi është bërë lidhja fizike, është i nevojshëm konfigurimi i portës COM në PC. Kjo në PC realizohet në Control Panel / System / Hardware / Device Manager / Ports (LPT & COM). Për konfigurin e portës seriale duhet në fillim të përcaktohet cila portë COM është lidhur (COM1, COM2 ...).Në rastin e një PC desktop parapëlqehet që lidhja ne PC të realizohet në COM1; në rastin e një laptopi i cili nuk përmban fizikisht portë COM, lidhja realizohet nëpërmjet një konvertuesi USB në COM. Lidhja valore me robotin mund të realizohet nëpërmjet paketës Bluetooth të njohur si Element Direct - BAM (Bluetooth Adaptor Module).



Fig 5.18. *iRobot Create dhe elementi BAM*

Programet e komunikimit të kompjutertit me robotin.

Komandimi i iRobot Create kryhet nëpërmjet një programi të thjeshtë i cili përbëhet nga një dritare ku janë vendosur disa butona me simbolikat e lëvizjeve më të mundëshme të robotit.
Pas çdo butoni që klikohet ekzekutohen komanda dhe funksione të cilat janë në përbërje të librarisë së ndërtuar në Visual Basic 6.0 [4] dhe Visual Basic .NET [5]. Libraria e komandimit te robotit

është ndërtuar duke shfrytëzuar ActiveComport Serial Port [36]. Për realizimin e komunikimeve me iRobot Create nëpërmjet portës seriale PC, mund të shfrytëzohej edhe Microsoft Comm Control 6.0 (ActiveX Control për Visual Basic 6.0). Në të dy rastet struktura bazë e komunikimeve do të qe e njëjtë me ndryshime të vogla.

Programimi me ACTIVECOMPORT SERIAL PORT

Problemi i komunikimit nëpërmjet portës seriale edhe pse është një problem i trajtuar në shumë materiale, përsëri ka specifikat e veta. Realizimi i komunikimit duke qenë kompleks ka bërë që kompani të specilizuara të ndërtojnë programe ndihmëse që shërbejnë si ura lidhëse midis programuesve dhe portës seriale [36]. Një i tillë program ndihmës që në gjuhën e programimit quhet kompoment COM është dhe ActiveComport Serial Port. Ky komponent COM është ndërtuar për të ndihmuar programuesit në gjuhët e programimit VBScript, Visual Basic 6.0 [4], Visual Basic .Net [5] dhe Visual C ++ [6]. Përdorimi i ActiveComport Serial Port është me qëllime të ndryshme si psh komandimi i paisjeve industriale të ndryshme që mund të komunikojnë me PC nëpërmjet portës seriale, komandimi dhe kontrolli i ruterave të ndryshëm në rrjet, kontrolli i modemave serialë, Usb, Bluetooth etj [36].

Për të krijuar një serial objekt COM janë të domosdoshme linjat e mëposhtme :
VB6 :

```
Dim objComport As ACOMPORTLib.ComPort
Set objComport = CreateObject("ActiveXperts.ComPort")       ‘Krijon nje Comport instance
```

.NET :

```
Public objComport As ACOMPORTLib.ComPort
Try
   objComport = CreateObject("ActiveXperts.ComPort")
   objComport.ComTimeout = 1000
Catch
   MsgBox("Problem ne procesin e krijimit te objectit ActiveXperts.ComPort", vbCritical,
            Application.ProductName)
End Try
```

Objekti serial i krijuar duhet të konfigurohet. Për rastin konkret për komunikimin me iRobot Create, konfigurimi i tij përcaktohet si më poshtë :

VB6:

```
 objComport.Device = “COM1”     ‘Perdor porten COM1 direkt pa ndermjetesine e driverave te Windows_it
 objComport.ComTimeout = 100                    ‘ Koha jashte komunikimit ( timeout )
 objComport.LogFile = App.Path & "\Errors.Log"  ‘ Log file ku rruhen mesazhe gabimesh
 objComport.BaudRate = 57600                    ‘ BoudRate ne bps (te mundeshme 19200 ose 57600)
 objComport.HardwareFlowControl = 0                  ‘
 objComport.SoftwareFlowControl = 0                  ‘
 objComport.DataBits = objComport.asDATABITS_8       ‘
 objComport.StopBits = objComport.asSTOPBITS_1 ‘
 objComport.Parity = objComport.asPARITY_NONE‘
objComport.Open                                      ‘ Komanda per hapjen e portes seriale
```

.NET

```
comm = "COM1"
```

```
objComport.Device = comm
objComport.ComTimeout = 100
objComport.LogFile = System.Windows.Forms.Application.ExecutablePath & "\Errors.Log"
objComport.BaudRate = 57600
objComport.HardwareFlowControl = 0
objComport.SoftwareFlowControl = 0
objComport.DataBits = objComport.asDATABITS_8
objComport.StopBits = objComport.asSTOPBITS_1
objComport.Parity = objComport.asPARITY_NONE
objComport.Open()
```

Për të kryer procesin e dërgimit të datave në portë komanda e përdorur është si më poshtë :
objComport.WriteString("any text") ose objComport.WriteByte wByte
Instruksioni i parë (objComport.WriteString("any text")) dërgon një informacion në portë të organizuar në një string, ndërsa i dyti (objComport.WriteByte wByte) dërgon në portë 1 byte informacion (wByte). Në rastin e komunikimit me iRobot Create instruksioni që do të përdoret për dërgimin e datave në portë do të jetë ai i dërgimit byte pas byte.

Për të kryer procesin e marrjes së të dhënave në portë, të dërguara nga paisja e lidhur në anën tjetër të kabllit serial si psh roboti iRobot Create, përdoren instruksionet e mëposhtme :

VB6 dhe vb .NET:

```
objComport.ComTimeout = 100          ‘ Koha pas se ciles ka TimeOut

str = objComport.ReadString          ‘ Lexon nje informacion text nga porta

wByte = objComport.ReadByte          ‘ Lexon nje informacion byte nga porta

wByte = objComport.ReadBytes         ‘ Lexon nje varg informacioni byte nga porta
```

Mbyllja e portës seriale të komunikimit kryhet nga komanda :

```
objComport.Close                     ‘ Komanda per mbylljen e portes
```

Mbështetur në sa u përshkruan më sipër po jepen në vijim disa komanda dhe funksione që do të përdoren për të vënë në lëvije iRobot Create.

Komandat e lëvizjes dhe funksionet e gjëndjes së robotit.

Disa nga komandat dhe funksionet më të përdorëshme do të përshkruhen më poshtë.
Hapja e portës seriale për komunikimin me robotin kryhet nga funksioni :

RoombaInit “3” ku “3” shpreh numrin e portës seriale ku do të bëhet komunikimi

Ndërtimi i këtij funksioni jepen në vijim :

```
Public Function RoombaInit(my_COM As String) As Boolean
```

```
    Dim Key                 As Integer
    Dim s                   As String
    Dim comm                As String

' Output buffer must be big enough to take largest message size
    If IsNumeric(my_COM) = False Then
       MsgBox "Porte komunikimi e pa percaktuar.", vbInformation, App.Title
       RoombaInit = False
    End If

    ' Percakton porten e komunikimit me robotin Roomba
    comm = "COM" & my_COM
    objComport.Device = comm
    objComport.ComTimeout = 1000
    objComport.LogFile = App.Path & "\Errors.Log"
    objComport.BaudRate = 57600
    objComport.HardwareFlowControl = 0
    objComport.SoftwareFlowControl = 0
    objComport.DataBits = objComport.asDATABITS_8
    objComport.StopBits = objComport.asSTOPBITS_1
    objComport.Parity = objComport.asPARITY_NONE
    objComport.Open

    confirmation = GetResult

    If objComport.IsOpened = True And objComport.LastError = 0 Then
       Key = 128: objComport.WriteByte (Key):DoSleep 0.1
       Key = 132: objComport.WriteByte (Key): DoSleep 0.1

      ' light LEDS
       Key = 139: objComport.WriteByte (Key)
       Key = 25: objComport.WriteByte (Key)
       Key = 0:objComport.WriteByte (Key)
       Key = 128:objComport.WriteByte (Key)
       ' set song
       Key = 140:objComport.WriteByte (Key)
       Key = 1:objComport.WriteByte (Key)
       Key = 1:objComport.WriteByte (Key)
       Key = 48:objComport.WriteByte (Key)
       Key = 20:objComport.WriteByte (Key):DoSleep 0.05
       ' sing it
       Key = 141:objComport.WriteByte (Key)
       Key = 1:objComport.WriteByte (Key)
       RoombaInit = True
    Else
       MsgBox  "Pamundesi ne hapjen e portes se komunikimit.", vbInformation, App.Title
       RoombaInit = False
    End If
End Function
```

Funksioni kthen mbrapsh vlerat True ose False për rastet kur lidhja realizohet me robotin ose jo. Lëvijet para, prapa si dhe majtas, djathtas me shpejtësi lineare të përcaktuara për secilën rrotë të robotit jepet nga komanda :

```
SetDriveWheelsCreate ShpejtesiaRrotesMajtas, ShpejtesiaRrotesDjathtas
```

ku parametrat `ShpejtesiaRrotesMajtas` dhe `ShpejtesiaRrotesDjathtas` përcaktojnë shpejtësitë e rrotës së majtë dhe të djathtë të robotit (Fig 5.19). Shpejtësia lineare e rotave të robotit përcaktohet në vlerat (-500 – 500 mm/s) [37].



Fig 5.19. *Rrotat e iRobot Create dhe shpejtesite lineare te tyre*

Kur kërkohet lëvizja perpara e robotit pas përcaktimit të shpejtësisë me të cilën ai do të lëvize, mjafton të ekzekutojmë komandën :

```
SetDriveWheelsCreate vLevisjeje, vLevisjeje          'Shpejtesia  vLevisjeje =[0, 500] mm/s
```

Për lëvizjen prapa do të ekzekutonim komandën :

```
SetDriveWheelsCreate vLevisjeje, vLevisjeje          'Shpejtesia  vLevisjeje =[-500 , 0] mm/s
```

Rrotullimet me 90 gradë majtas dhe djathtas do të kryheshin nga ekzekutimi i komandave :

```
SetDriveWheelsCreate 0, vLevisjeje          'Shpejtesia  vLevisjeje =[0 , 500] mm/s
SetDriveWheelsCreate vLevisjeje, 0          'Shpejtesia  vLevisjeje =[0 , 500] mm/s
```

Rrotullimi me 180 gradë majtas dhe djathtas do të kryheshin nga ekzekutimi i komandave :

```
SetDriveWheelsCreate - vLevisjeje, vLevisjeje        'Shpejtesia  vLevisjeje =[0 , 500] mm/s
SetDriveWheelsCreate vLevisjeje, - vLevisjeje        'Shpejtesia  vLevisjeje =[0 , 500] mm/s
```

Duke njohur distancën midis rrotave të robotit si dhe shpejtësitë lineare të rrotave jemi në gjendje të përcaktojmë rrotullime në kënde të dëshiruara të sistemit robotik. Për këtë do të shfrytëzojmë disa formula të tjeshta të fizikës. Problemi do të shtrohej në formën : sa duhet të jetë shpejtësia lineare e lëvizjes së rrotave në momentin kur kërkohet rrotullimi i robotit me këndin α ?
Duke u mbështetur në formula të njohura që lidhin shpejtësinë këndore me atë lineare dhe shpejtësine lineare me kohën mund të shkruajmë :

$$\omega = \frac{v}{r} = \frac{2 \cdot v}{d} \qquad (1)$$

$$\omega = \frac{\alpha}{t} \qquad (2)$$

Nisur nga 1 dhe 2 mund të llogaritim shpejtësinë lineare të rrotës për një rrotullim me këndin α të robotit gjatë kohës t.

$$\alpha = \frac{2 \cdot v \cdot t}{d} \qquad (3)$$

Ku d është distanca midis rrotave të robotit Fig 5.20.



Fig 5.20. *Rrotullimi i iRobot Create*

Një komandë për lëvizje të përbërë në formë harku rrethi për iRobotCreate jepet si më poshtë :

```
SetFwdVelRadiusRoomba  vLevisjeje, rRezja
```

ku : `vLevisjeje` është shpejtësia lineare e robotit
`rRezja` është rrezja e trajektores që do të përshkruajë roboti (Fig 5.21).



Fig 5.21. *Lëvizja e përbërë e iRobot Create*

Për të ndaluar robotin mund të përdoren komandat :
`SetDriveWheelsCreate 0, 0` ose `SetFwdVelRadiusRoomba 0,1`

Për të dy komandat e përshkruara më sipër madhësitë `vLevisjeje`, `rRezja` janë numra nga 16 bit pra 4 byte në total. Për rastin kur shpejtësia do të jetë -200 mm/s dhe rrezja 500 mm, informacioni që do të dërgohet në portë do të jetë i renditur në byte si në vijim :
`[137] [255] [56] [1] [244]`
Komanda `[137]` i vendos rrotat e robotit në kontroll për një lëvizje në formë harku.
Vargu i mësipërm përfitohet nga zbërthimi i madhësive sipas formës së mëposhtme [38] :
`vLevisjeje = -200 = hex FF38 = [hex FF] [hex 38] = [255] [56]`
`rRezja = 500 = hex 01F4 = [hex 01] [hex F4] = [1] [244]`

Për të përfituar zbërthimin e mësipërm në Visual Basic 6.0 dhe Visual Basic .NET do të shfrytëzojmë funksionet HIBYTE (intParameter) dhe LOBYTE(intParameter) të përshkruara më poshtë :

```
Public Function HIBYTE(ByVal Intg As Integer) As Byte
          HIBYTE = (Intg And &HFF00&) / 256
End Function

Public Function LOBYTE(ByVal Intg As Integer) As Byte
          LOBYTE = Intg And &HFF&
End Function
```

Për të përcaktuar distancën që përshkon roboti thirret funksioni DistanceSensorRoomba()
i cili kthen mbrapsh metrat e përshkruara.

Për të vënë robotin Roomba në gjendjen beep (tingull zanor) ekzekutohet komanda :
`BeepRoombaVB6VBNet ().`

Për të marë informacion mbi nivelin e baterive të robotit ekzekutohen komandat :
`BatteryChargeReaderRoombaVB6VBNet()` ose `BatteryVoltageRoombaVB6VBNet()` të cilat kthejnë vlerën e tensionit të paketës burim.

Realizimi eksperimental i komunikimit të PC me iRobot Create.

Për të realizuar komandimin e robotit programi i ndërtuar në Visual Basic 6.0 përbëhet nga një formë (dritare) e paraqitur në Fig 5 dhe prej 12 modulesh ku secili prej tyre përmban komanda , funksione që lidhen me komunikimin e robotit si dhe funksione ndihmëse të tjera. Funksionimi i programit është i thjeshtë. Në dritaren e portës së komunikimit (Fig 5.22) zgjidhet numri i portës seriale. Në rastin kur PC lidhet me robotin me ndihmën e kabllit serial, në portën e komunikimit zgjidhet COM1 ose COM2. Kur lidhjen midis PC dhe robotit e kryejmë në mënyrë valore atëherë në portën e komunikimit zgjidhet COM3 – COM8 (kjo zgjedhje përcaktohet nga bluetooth pas instalimit të saj).



Fig 5.22. *Programi i komandimit te levizjes se robotit (a)-VB6, (b)-VB .NET*

Si përfundim :

- Nëpërmjet këtij paragrafi përshkruam se si mund të realizohet komandimi i robotit prej portës seriale duke shfrytëzuar librarinë e komandave të ndërtuar për këtë qëllim.
- Programi i ndërtuar tregon mënyrën se si mund të shfrytëzohet ActiveComport Serial Port në Visual Basic 6.0 dhe Visual Basic .NET.
- Nëpërmjet programit të ndërtuar në Visual Basic 6.0 dhe Visual Basic .NET tregohet se si mund të thirren komandat për vënien e robotit në lëvizje drejtvizore dhe rrotulluese në mënyrë të kontrolluar.

Në Shtojcën 10 po japim librarinë e komandimit të lëvizjeve të robotit në Visual Basic 6.0 dhe Visual Basic .NET bazuar në librarinë ActiveComport Serial Port.

5.6. Specifikime dhe libraria e komandave në Basic4Androide (Java). Komunikimet me kabëll (wire) dhe me valë (wireless and bluetooth)

Për komandimin e robotit prej PC është e nevojshme shfrytëzimi i portës seriale (7 pin Mini - DIN connector) ose i portës DB 25 pin ku montohet paketa Bluetooth (Fig 5.23). Programet që përbëjnë librarinë e ndërtuar paraqiten nga një grup komandash dhe funksionesh të cilat realizojnë detyra specifike. Kjo librari do të shërbejë si një urë lidhëse ndërmjet robotit dhe përdoruesit kur ai programon detyra specifike në Basic4Androide, në dërgimin e komandave drej robotit. Komandat përgjithësisht venë robotin në veprim lëvizjeje ndërsa funksionet sjellin tek përdoruesi vlerat e madhësive që karakterizohen si parametra të robotit si psh madhësia e tensionit të baterive, gjendjet e sensorëve të robotit, rrugën e kryer prej tij etj.

Paisjet fizike në realizimin e lidhjes midis paisjes Android dhe robotit.

Dërgimi i instruksioneve dhe komandave drej robotit do të realizohet fizikisht nëpërmjet paisjes së komunikimit bluetooth e cila në paisjen Androide është e inkorporuar ndërsa në iRobot Create lidhet në portën 25 pin (DB 25 pin connector) ku montohet paketa bluetooth i quajtur Element Direct BAM (Bluetooth Adaptor Module) (Fig 5.23). Në paisjen Android hapi i parë është deklarimi i një objekti serial i cili do të deklarohet si një objekt global. Pas inicializimit të objektit serial kërkohet lidhja në paisjen robotike.



Fig 5.23. *iRobot Create dhe elementi BAM*

Programet lidhëse midis paisjes Android dhe robotit.

Komandimi i iRobot Create kryhet nëpërmjet një programi të thjeshtë i cili përbëhet nga një dritare ku janë vendosur disa butona me simbolikat e lëvizjeve më të mundshme të robotit.
Pas cdo butoni që klikohet ekzekutohen komanda dhe funksione të cilat janë në përbërje të librarisë së ndërtuar në Basic4Androide [40]. Për realizimin e komunikimeve me Roomba 4400 në këtë material do të shfrytëzohet komunikimi bluetooth, i cili shfrytëzon librarinë Androide 2.0 (API level 5) ose versione më lart. Programi që realizon këto komunikime i njohur si Basic for Androide

Programimi me librarinë SERIALE ANDROID 2.0.

Problemi i komunikimit nëpërmjet portës seriale edhe pse është një problem i trajtuar në shumë materiale, përsëri ka specifikat e veta. Realizimi i komunikimit duke qenë kompleks ka bërë që kompani të specilizuara të ndërtojnë programe ndihmëse që shërbejnë si ura lidhëse midis programuesve dhe portës seriale. Përdorimi i librarisë seriale Androide 2.0 është me qëllime të ndryshme si psh komandimi i paisjeve industriale të ndryshme që mund të komunikojnë me paisjet Android nëpërmjet portës seriale dhe Bluetooth [40]. Kjo siguron që përdorimi i teknikave të menaxhimit të portave seriale të jetë i rëndësishëm.

Për të krijuar një objekt serial dhe për të kryer inicializimet e nevojshme duke përdorur librarinë seriale Androide 2.0 janë të domosdoshme linjat e mëposhtme :

```
Sub Process_Globals
    Dim admin     As BluetoothAdmin
    Dim serial1   As Serial              ' deklarim i objktit serial
    Dim out       As OutputStream
    Dim Inp       As InputStream
End Sub
Sub Activity_Create(FirstTime As Boolean)
      Activity.LoadLayout("bluetooth")
      If FirstTime Then
            admin.Initialize("admin")
            serial1.Initialize("serial1")
      End If
End Sub
```

Objekti serial i krijuar duhet të konfigurohet dhe kryhet hapja e portës së komunikimit. Për rastin konkret për komunikimin me iRobot Create, konfigurimi i tij përcaktohet më poshtë. Pas klikimit të butonit `btnSearchForDevices`, nis procesi i identifikimit të paisjeve që mund të lidhen me paisjen Android. Në ekran të paisjes Android shfaqet lista e mundësive të lidhjeve nga e cila përdoruesi zgjedh atë me emërtim Element Direct BAM [39]. Kjo e fundit përfaqëson lidhjen bluetooth me iRobot Create.
Komanda `serial1.Connect(connectedDevice.Mac)` realizon lidhjen me paisjen me emër `connectedDevice.Name` dhe mac adresë `connectedDevice.Mac`

```
Sub btnSearchForDevices_Click
      foundDevices.Initialize
      If admin.StartDiscovery    = False Then
         ToastMessageShow("Error starting discovery process.", True)
      Else
         ProgressDialogShow("Searching for devices...")
      End If
End Sub
Sub Admin_DiscoveryFinished
```

```
        ProgressDialogHide
        If foundDevices.Size = 0 Then
           ToastMessageShow("Nuk gjendet paisje per lidhje.", True)
        Else
               Dim l As List
               l.Initialize
               For i = 0 To foundDevices.Size - 1
                      Dim nm As NameAndMac
                      nm = foundDevices.Get(i)
                      l.Add(nm.Name)
               Next
               Dim res As Int
               res = InputList(l, "Zgjidh paisjen per lidhje", -1)
               If res <> DialogResponse.CANCEL Then
                      connectedDevice = foundDevices.Get(res)
                      ProgressDialogShow("Lidhja realizuar tek : " &
                      connectedDevice.Name & " (" & connectedDevice.Mac & ")")
                      serial1.Connect(connectedDevice.Mac)
               End If
        End If
End Sub
```

Konfirmimi i lidhjes përcaktohet nga pjesa e kodeve në vazhdim :

```
Sub Serial1_Connected (Success As Boolean)
        ProgressDialogHide
        Log("Konfirmi lidhjeje : " & Success)
        LogMessage("", " Konfirmi lidhjeje : " & Success)
        If Success = False Then
           Log(LastException.Message)
           ToastMessageShow("Gabim lidhjeje : " & LastException.Message, True)
           SuccessConnection=False
        Else
           out = serial1.OutputStream
           Inp = serial1.InputStream
           SuccessConnection=True
        End If
End Sub
```

Për të kryer procesin e dërgimit të datave në portë komanda e përdorur është si më poshtë :

```
out.WriteBytes(wByte,0,uBound(wByte)-1)
```

Instruksioni `out.WriteBytes(wByte,0,uBound(wByte)-1)` dërgon në portë `uBound(wByte)-1` byte informacion (`wByte`). Në rastin e komunikimit me iRobot Create instruksioni që do të përdoret për dërgimin e datave në portë do të jetë dërgimit byte pas byte. Instruksionet do të jenë si më poshtë :

```
Dim bufferarray() As Byte = Array As Byte(128)
Main.out.WriteBytes(bufferarray,0,1)
```

Për të kryer procesin e marrjes së të dhënave, të dërguara nga roboti iRobot Create, përdoren instruksionet e mëposhtme:

```
If Main.inp.BytesAvailable >0 Then
   Dim buffer(Main.inp.BytesAvailable) As Byte
   Main.inp.ReadBytes( buffer,0, Main.inp.BytesAvailable )
```

```
   s = BytesToString(buffer,0,buffer.Length ,"Windows-1253")
   Msgbox( s,"")
End If
```

Mbyllja e portës seriale të komunikimit kryhet nga komanda :

```
serial1.Disconnect                              ‘ Komanda per mbylljen e portes
```

Mbështetur në sa u përshkruan më sipër po jepen në vijim disa komanda dhe funksione që do të përdoren për të vënë në lëvije iRobot Create.

Komandat e lëvizjes dhe funksionet e gjëndjes së robotit.

Disa nga komandat dhe funksionet më të përdorëshme do të përshkruhen më poshtë.
Hapja e lidhjes për komunikimin me robotin kryhet nga funksioni :

```
BeepRoombaConnect
```

Ndërtimi i këtij funksioni jepen në vijim :

```
Public Sub BeepRoombaConnectB4A() as Boolean
       Dim boolBeepRoombaConnectB4A     as Boolean

       If Main.out.IsInitialized = True Then

              Dim bufferarray () As Byte

              Bufferarray(0) = 128: Main.out.WriteBytes(Bufferarray,0,1)
              modMAin.Sleep(100)
              Bufferarray(0) = 132: Main.out.WriteBytes(Bufferarray,0,1)
              modMAin.Sleep(100)
              Bufferarray(0) = 139: Main.out.WriteBytes(Bufferarray,0,1)
              Bufferarray(0) = 25: Main.out.WriteBytes(Bufferarray,0,1)
              Bufferarray(0) = 0: Main.out.WriteBytes(Bufferarray,0,1)
              Bufferarray(0) = 128: Main.out.WriteBytes(Bufferarray,0,1)
              modMAin.Sleep(100)
              Bufferarray(0) = 140: Main.out.WriteBytes(Bufferarray,0,1)
              Bufferarray(0) = 1: Main.out.WriteBytes(Bufferarray,0,1)
              Bufferarray(0) = 48: Main.out.WriteBytes(Bufferarray,0,1)
              Bufferarray(0) = 20: Main.out.WriteBytes(Bufferarray,0,1)
              modMAin.Sleep(100)
              Bufferarray(0) = 141: Main.out.WriteBytes(Bufferarray,0,1)
              Bufferarray(0) = 1: Main.out.WriteBytes(Bufferarray,0,1)
              modMAin.Sleep(100)

              boolBeepRoombaConnectB4A = True
       else
              boolBeepRoombaConnectB4A = False
       End If

       RETURN boolBeepRoombaConnectB4A
End Sub
```

Funksioni kthen mbrapsh vlerat True ose False për rastet kur lidhja realizohet me robotin ose jo.

Lëvijet para, prapa si dhe majtas, djathtas me shpejtësi lineare të përcaktuara për secilën rrotë të robotit jepet nga komanda :

```
SetDriveWheelsCreateB4A ShpejtesiaRrotesMajtas, ShpejtesiaRrotesDjathtas
```

Ku parametrat `ShpejtesiaRrotesMajtas` dhe `ShpejtesiaRrotesDjathtas` përcaktojnë shpejtësitë e rrotës së majtë dhe të djathtë të robotit (Fig 5.24). Shpejtësia lineare e rotave të robotit përcaktohet në vlerat (-500 – 500 mm/s) [36].



Fig 5.24. Rrotat e iRobot Create dhe shpejtesitë lineare të tyre

Kur kërkohet lëvizja perpara e robotit pas përcaktimit të shpejtësisë me të cilën ai do të lëvizë, mjafton të ekzekutojmë komandën :

```
SetDriveWheelsCreateB4A vLevisjeje, vLevisjeje     'Shpejtesia  vLevisjeje =[0, 500] mm/s
```

Për lëvizjen prapa do të ekzekutonim komandën :

```
SetDriveWheelsCreateB4A vLevisjeje, vLevisjeje     'Shpejtesia   vLevisjeje  =[-500  ,  0]
mm/s
```

Rrotullimet me 90 gradë majtas dhe djathtas do të kryheshin nga ekzekutimi i komandave :

```
SetDriveWheelsCreateB4A 0, vLevisjeje       'Shpejtesia  vLevisjeje =[0 , 500] mm/s
SetDriveWheelsCreateB4A vLevisjeje, 0       'Shpejtesia  vLevisjeje =[0 , 500] mm/s
```

Rrotullimi me 180 gradë majtas dhe djathtas do të kryheshin nga ekzekutimi i komandave :

```
SetDriveWheelsCreateB4A - vLevisjeje, vLevisjeje   'Shpejtesia vLevisjeje =[0 , 500] mm/s
SetDriveWheelsCreateB4A vLevisjeje, - vLevisjeje   'Shpejtesia vLevisjeje =[0 , 500] mm/s
```

Duke njohur distancën midis rrotave të robotit si dhe shpejtësitë lineare të rrotave jemi në gjendje të përcaktojmë rrotullime në kënde të dëshiruara të sistemit robotik. Për këtë do të shfrytëzojmë disa

formula të tjeshta të fizikës. Problemi do të shtrohej në formën : sa duhet të jetë shpejtësia lineare e lëvizjes së rrotave në momentin kur kërkohet rrotullimi i robotit me këndin α ?
Duke u mbështetur në formula të njohura që lidhin shpejtësinë këndore me atë lineare dhe shpejtësine lineare me kohën mund të shkruajmë :

$$\omega = \frac{v}{r} = \frac{2 \cdot v}{d} \qquad (1)$$

$$\omega = \frac{\alpha}{t} \qquad (2)$$

Nisur nga 1 dhe 2 mund të llogaritim shpejtësinë lineare të rrotës për një rrotullim me këndin α të robotit gjatë kohës t .

$$\alpha = \frac{2 \cdot v \cdot t}{d} \qquad (3)$$

Ku d është distanca midis rrotave të robotit Fig 5.25.



Fig 5.25. *Rrotullimi i iRobot Create*

Një komandë për lëvizje të përbërë në formë harku rrethi për iRobotCreate jepet si më poshtë :

```
SetFwdVelRadiusRoombaB4A  vLevisjeje, rRezja
```

ku `vLevisjeje` është shpejtësia lineare e robotit dhe `rRezja` është rrezja e trajektores që do të përshkruajë roboti (Fig 5.26).



Fig 5.26. *Lëvizja e përbërë e iRobot Create*

Për të ndaluar robotin mund të përdoren komandat :

```
SetDriveWheelsCreateB4A  0, 0        ose    SetFwdVelRadiusRoombaB4A 0,1
```

Për të dy komandat e përshkruara më sipër madhësitë `vLevisjeje`, `rRezja` janë numra nga 16 bit pra 4 byte në total. Për rastin kur shpejtësia do të jetë -200 mm/s dhe rezja 500 mm, informacioni që do të dërgohet në portë do të jetë i renditur në byte si në vijim :

```
[137]  [255] [56]  [1] [244]
```

Komanda `[137]` i vendos rrotat e robotit në kontroll për një lëvizje në formë harku.
Vargu i mësipërm përfitohet nga zbërthimi i madhësive sipas formës së mëposhtme [38] :

```
vLevisjeje = -200 = hex FF38 = [hex FF] [hex 38] = [255] [56]
rRezja = 500 = hex 01F4 = [hex 01] [hex F4] = [1] [244]
```

Për të përfituar zbërthimin e mësipërm në Basic4Androide [37] do të shfrytëzojmë funksionet `HIBYTE (Intg)` dhe `LOBYTE (Intg)` të përshkruara më poshtë :

```
Public Sub HIBYTE( Intg As Int) As Int
       Dim andBit    As Int
       andBit = Bit.AND(Intg ,0xFF00)
       andBit = andBit / 256
    Return andBit
End Sub

Public Sub LOBYTE( Intg As Int) As Int
   Dim andBit As Int
   andBit = Bit.AND(Intg ,0xFF)
   Return andBit
End Sub
```

Për të përcaktuar distancën që përshkon roboti thirret funksioni `DistanceSensorRoombaB4A()` i cili kthen mbrapsh metrat e përshkruara.

Për të vënë robotin Roomba në gjendjen beep (tingull zanor) ekzekutohet komanda :

```
BeepRoombaB4A().
```

Për të marë informacion mbi nivelin e baterive të robotit ekzekutohen komandat :
`BatteryChargeReaderRoombaB4A()` ose `BatteryVoltageRoombaB4A()` të cilat kthejnë vlerën e tensionit të paketës burim.

Realizimi eksperimental i komunikimit të paisjes Androide me iRobot Create.

Për të realizuar komandimin e robotit programi i ndërtuar në Basic4Androide Version 2.52 përbëhet nga nje forme (dritare) e paraqitur në Fig 5.27 dhe prej 8 modulesh ku sejcili prej tyre përmban komanda, funksione që lidhen me komunikimin e robotit si dhe funksione ndihmëse të tjera.



Fig 5.27. *Programi i komandimit të lëvizjes së robotit Roomba 4400 (iRobot Create)*

Funksionimi i programit është i thjeshtë. Në dritaren e portës së komunikimit (Fig 5.27) klikohet në butoni 'Kërkim per paisje me bluetooth' pas së cilës shfaqet pas një kërkimi lista e paisjeve me të cilat mund të kërkojmë komunikim (a). Pas klikimi të butonit 'Hapje porte komunikimi' sigurohet kërkesa për lidhje me paisjen e zgjedhur në listën (a). Lëvizja e robotit më tej bëhet duke punuar me butonat që si pamje të tyre kanë drejtimin e lëvizjes.

Si përfundim mund të themi se :

- Nëpërmjet këtij paragrafi përshkruam se si mund të realizohet komandimi i robotit prej portës virtuale seriale bluetooth duke shfrytëzuar librarinë e komandave të ndërtuar për këtë qëllim.
- Programi i ndërtuar tregon mënyrën se si mund të shfrytëzohet librarina seriale Androide 2.0 në Basic4Androide Version 2.52.
- Nëpërmjet programit të ndërtuar në Basic4Androide Version 2.52 tregohet se si mund të thirren komanadat për vënien e robotit në lëvizje drejtvizore dhe rrotulluese në mënyrë të kontrolluar.

Në Shtojcën 11 po japim librarinë e komandimit të lëvizjeve të robotit në Basic4Androide bazuar në librarinë seriale Androide 2.0.

Si përfundim të kapitullit mund të themi se :

Realizuam programet, pra pjesën software të përbehet nga dy pjesë :

- Programi i komandave, i cili shpreh detyrën që duhet të kryhet, nëpërmjet një algoritmi të caktuar.
- Programet e komunikimit me robotin që përfaqësojnë një librari funksionesh dhe komandash, të ndërtuara për mjedise të ndryshme programimi dhe konkretisht për mjediset Matlab, Visual Basic 6.0, Visual Studio 2005, 2008, 2010, 2012 .Net dhe Basic4Androide (Java)

KAPITULLI VI

Hyrje

iRoboti Create është një model i programueshëm i versionit Roomba Model 4400 që përdoret për qëllime mësimi dhe studimi. Për realizimin e kontrollit të pozicionit të këtij roboti prej PC është shfrytëzuar porta DB 25 pin ku montohet moduli bluetooth BAM, dhënë në Fig 6.1. Një sistem point lazer është i instaluar poshtë pllakës të mbështetur në katër shufrat vertikale mbajtëse të konstruksionit.
Dërgimi i komandave prej kompjuterit drejt robotit do të kryhet nëpëmjet paisjeve bluetooth të montuara në kompjuter dhe robot. Në robot është instaluar një kamera (ose dy të tilla) Wi-Fi si në Fig 6.1, e cila do të japë imazhe digitale që do të përpunohen në kompjuter prej nga do të formulohen dhe komandat për drejtimin e robotit drejt pozicionit të dëshiruar.
Programi në kompjuter në mënyrë të përmbledhur realizon këto detyra :

- përpunon imazhet grafike të dërguara prej kamerës Wi-Fi.
- formulon komandat për robotin.
- dërgon komandat për ekzekutim nëpërmjet paisjeve Bluetooth në robot.



Fig 6.1. iRobot Create, kamera, gjeneruesi lazer dhe elementi BAM

Detyra që mund të kryhen nëpërmjet një sistemi të tillë janë të shumta. Ndër përdorimet më të spikatura prej shfrytëzimit të sistemeve të tilla mund të përmendim disa të cilat po i paraqesim në vijim.

6.1. Përdorimi i sistemit robotik iRobot Create në fusha të ndryshme sociale.

Disa prej mundësive të përdorimit të sistemit robotik iRobot Create në fusha të ndryshme sociale po i përshkruajmë si më poshtë :

- Komandimi prej kompjuterit me kabëll ose valor (bluetooth) i iRobot Create si një sistemi robotik vëzhgimi dhe komunikimi Fig 6.3.

Fig 6.2 *Përdorimi i iRobot Create si një sistem robotik vëzhgimi.*

- Përdorimi i sistemit robotik për rastet kur ndërtesat janë të dëmtuara nga tërmetet dhe njerëzit e kanë të pamundur të hyjnë në këto objekte.

- Komandimi i robotit në distancë dhe marrja e pamjeve të kamerave të montuara mbi robot, në kompjuter Fig 6.3.



Fig 6.3 *Skema bazë për përdorimin i iRobot Create si një sistem robotik vëzhgimi dhe komunikimi.*

- Ndjekja e objekteve dhe kontrolli i distancës prej tyre si objekte në vëzhgim.

Në pjesën në vijim jepet ndjekja në rrafshin plan të një objekti qëllim, prej iRobot Create sipas metodës klasike të ndjekjes përcaktuar nga shpejtesia e lëvizjes së objektit që ndiqet.

6.2. Ndjekja e një objekti prej iRobot Create sipas metodave klasike të ndjekjes përcaktuar nga shpejtësia e lëvizjes së objektit.

Qëllimi i këtij paragrafi është dhënia e disa informacioneve mbi një mënyrë kontrolli pozicioni për robotin Roomba Model 4400 (iRobot Create) me ndihmën e një ose dy kamerash vëzhgimi. Qëllimi është realizimi i një sistemi (robot & kamera) si në Fig 6.1 i cili përpiqet të ndjekë në një distancë të pa ndryshuar një objekt të paracaktuar, si në Fig 6.4. Objekti mund të jetë një sferë të vogël me ngjyrë të cilësuar apo një diodë ndricuese led, montuar në një objekt të lëvizshëm si mbi një robot tjetër.



Fig 6.4. *Ndjekja e objektit duke ruajtur një distancë të kërkuar*

Për të gjtha sa u tha deri tani, qëllimi përfundimtar është realizimi i një sistemi inteligjent ndjekës.

Baza teorike.

Për të realizuar kontrollin e robotit është e nevojshme të njihet modeli matematik i tij. Për rastin e robotit në përdorim, duke qenë se ai ka dy rrota të pavarura në lëvizje nga njëra-tjetra (sejcila prej

tyre vihet në lëvizje nga një motor me hapa i veçantë), si model matematik mund të shfrytëzohet ai i robotit me rrota të diferencuara. Tipi i lëvizjes së robotit është i kushtëzuar nga shpejtësia e rrotave të tij. Konkretisht, duke i rrotulluar rrotat me shpejtësi të njëtë, roboti lëvizë në vijë të drejtë (lëvizje drejtvizore). Nëse një rrotë rrotullohet me shpejtësi më të vogël se tjetra, roboti do të rrotullohet në anën e rrotës me shpejtësi më të vogël. Rasti i fundit i lëvizjes është rasti kur një rrotë rrotullohet në kahje të kundërt me rrotën tjetër. Në këtë rast roboti rrotullohet në formë spirale.
Për modelimin matematik më të thjeshtë të robotit, në lëvizjen 2D, është e nevojshme njohja e vetëm dy parametrave konstruktivë, distanca ndërmjet rrotave d dhe rrezja e rrotave r.
Për të kontrolluar pozicionin e rrobotit në planin 2D është e nevojshme të kontrollojmë tek roboti shpejtësitë e rrotave v_{majtas} dhe $v_{djathtas}$. Dy hyrje (inpute) si parametra të kontrollit për robotin do të jenë shpejtësitë e rrotave v_{majtas} dhe $v_{djathtas}$, dhe dalje (output) janë koordinatat x, y dhe këndi i rrotullimit φ (shpejtësi këndore ω). Modeli matematik do të realizojë lidhjen midis variablave të hyrjes dhe të daljes.



Fig 6.5. *Rrotullimi i iRobot Create dhe parametrat për pozicionimin në 2D.*

Madhësitë x, y dhe këndi i rrotullimit φ, përbëjnë variablat e gjendjes së sistemit.
Kinematika e lëvizje së rrobotit do të përshkruhej nga ekuacionet e mëposhtëme :

$$\dot{x} = \frac{r}{2} \cdot (v_{majtas} + v_{djathtas}) \cdot \cos(\varphi)$$
$$\dot{y} = \frac{r}{2} \cdot (v_{majtas} + v_{djathtas}) \cdot \sin(\varphi) \qquad (1)$$
$$\dot{\varphi} = \frac{r}{d} \cdot (v_{djathtas} - v_{majtas})$$

Në rastin e lëvizjes së një pike materiale (qëndra e gravitetit e një trupi) me shpejtësi v dhe kënd rrotullimi φ (shpejtësi këndore ω), ekuacionet e kinematikës do të jenë :

$$\begin{aligned} \dot{x} &= v \cdot \cos(\varphi) \\ \dot{y} &= v \cdot \sin(\varphi) \\ \dot{\varphi} &= \omega \end{aligned} \qquad (2)$$

Duke qenë se robotin ne mund ta trajtojmë në disa raste si një pikë mase, duke barazuar anë për anë ekuacionet (1) dhe (2) kemi relacionet e mëposhtëme :

$$\begin{aligned} v &= \frac{r}{2} \cdot (v_{majtas} + v_{djathtas}) \\ \omega &= \frac{r}{d} \cdot (v_{djathtas} - v_{majtas}) \end{aligned} \qquad (3)$$

Prej ekuacioneve (3) mund të përcaktojmë v dhe ω në funksion të d , r , v_{majtas} dhe $v_{djathtas}$.

$$\begin{aligned} v_{djathtas} &= \frac{1}{r} \cdot (v + \frac{d}{2} \cdot \omega) \\ v_{majtas} &= \frac{1}{r} \cdot (v - \frac{d}{2} \cdot \omega) \end{aligned} \qquad (4)$$

Ekuacionet (4) tregojnë mardhënien ndërmjet shpejtësisë lineare të rrotave të robotit dhe shpejtësisë lineare dhe këndore të qendrës së masës v dhe ω.

Për llogaritjen e pozicionit të robotit $x, y, \varphi(orientimi)$ në 2D, kur rrotat e tij kanë shpejtësitë lineare v_{majtas} dhe $v_{djathtas}$, do të shfrytëzojmë kalkulimet e mëposhtëme. Gjatë intervalit kohor Δt, secila rrotë gjatë lëvizjes përshkruan një hark. Shënojmë D_{rm} gjatësinë e harkut të kryer nga rrota e majtë dhe D_{rd} është gjatësia e harkut e kryer nga rrota e djathtë. Qëndra e robotit do të përshkruajë gjatësinë e harkut D_c. Llogaritja e D_c bëhet sipas formulës së mëposhtëme :

$$D_c = \frac{D_{rm} + D_{rd}}{2} \qquad (5)$$

Duke njohur gjendjen e vjetër $x_v, y_v, \varphi_v(orientimi)$ si dhe distancën D_c të kryer nga qendra e robotit gjatë intervalit kohor Δt, mund të njihen vlerat e reja të gjendjes së robotit $x_r, y_r, \varphi_r(orientimi)$ në fund të këtij intervali kohe**.**

$$\begin{aligned} x_r &= x_v + D_c \cdot \cos(\varphi) \\ y_r &= y_v + D_c \cdot \sin(\varphi) \\ \varphi_r &= \varphi_v + \frac{D_{rl} - D_{rd}}{d} \end{aligned} \qquad (6)$$

Problemin e shfrytëzimit të të dhënave për të përcaktuar pozicionin e objektit e trajton odometria.

Odometria

Odometria është përdorimi i të dhënave të përftuar nga sensorët, për të përcaktuar ndryshimin e pozicionit të objektit në varësi të kohës. Nëpërmjet odometrisë mund të marrim informacione mbi pozicionimin e robotit në hapësirën dy dimensionale (2D) pra koordinatat $x, y, \varphi(orientimi)$ ose tre dimensionale (3D) pra koordinatat x, y, z dhe për orientimin φ, r **.**

Për marrjen e këtij informacioni duhen sensorët të cilët mund të jenë të jashtëm ose të brendshëm. Sensorë të jashtëm, janë sensorët që japin informacion për mjedisin rrethues të robotit, si p.sh distancën e robotit prej një objekti ose distancën nga destinacioni qëllim. Si të tillë mund të përmendim sensorët ultratinguj, infrared, vizualë (kamerat), skanerat me lazer, pajisjet GPS etj.
Në grupin e sensorëve të brendshëm futen sensorët që japin informacion për gjendjen faktike të robotit, pozicionin dhe orientimin e tij. Të tillë sensorë janë akselerometrat, xhiroskopët, enkoderët.

Realizimi praktik.

Objekti në vëzhgim i treguar në Fig 6.6 dhe Fig 6.7 paraqet një trup sferik të vogël me ngjyrë të kuqe i vendosur mbi një objekt të lëvizshëm si psh mbi një tjetër robot. Në këtë rast problemi do të shtrohej në ndjekjen e një roboti prej një roboti të dytë. Për kamerën dhe objektin në vëzhgim njihen lartësitë prej bazës D_1 dhe D_2 (Fig 6.8). Në këto kushte mund të themi $h = D_1 - D_2$.

Zgjidhja e problemit do të realizohet në disa etapa :

1. Lokalizohet objekti që ndiqet në imazhin e sjellë prej kamerës.
2. Rrotullim i sistemit robotik duke sjellë vendosjen e objektit në vëzhgim në mes të imazhit (llogaritja e këndit të rrotullimit dhe shpejtësisë këndore të rrotullimit)
3. Përcaktimi i distancës nga objekti në vëzhgim.
4. Vlerësimi i ndryshimit midis vlerës së kërkuar dhe asaj faktike.
   Llogaritja e masës së zhvendosjes kundrejt objektit në vëzhgim si dhe e shpejtësisë lineare të zhvendosjes.
5. Formulimi i komandave për robotin që ai të pozicionohet sipas kërkesës.

Sejcilën prej etapave po e trajtojmë në vazhdim.

1. Për të kryer lokalizimin e objektit në vëzhgim në imazhin e sjellë prej kamerës mund të përdoren metoda të ndryshme në funksion të problemit konkret që shtrohet. Në rastin tonë objekti që ndiqet nuk është një trup i rastësishëm por një objekt i targuar i cili është i dallueshëm prej mjedisit përreth psh me ngjyrë të kuqe në një mjedis të çelët. Duke qenë i tillë lokalizimi i tij në imazhin e kamerës është një problem më i thjeshtë. Pas lokalizimit përcaktohet qendra gjeometike e drejkëndëshit që përfaqëson dhe koordinatat e qendrës së objektit si në Fig 6.6.



Fig 6.6. *Pamje nga lokalizimi i një objekti brenda imazhit të kamerës, në Matlab.*

2. Në Fig 6.7 jepen tre pamje të njëpasnjëshme të mara prej kameras në kohët t_0 , t_1 dhe t_2 . Gjatë intervalit kohor $\Delta t = t_2 - t_0$, objekti në vëzhgim zhvendoset me madhësinë :

$$\Delta pfch = pfch_2 - pfch_0$$

në pixel ku $pfch_2$ jep numrin e pixelëve prej qendrës sipas drejtimit horizontal për pamjen Fig 6.7 - 3, $pfch_0$ jep numrin e pixelëve prej qendrës sipas drejtimit horizontal për pamjen Fig 6.7 - 1.

Shpejtësia lineare e lëvizjes së objekti në vëzhgim do të llogaritet sipas formulës :

$$v_{pixel\_objektit} = \frac{\Delta pfch}{\Delta t}$$

ose (1)

$$v_{pixel\_objektit} = \frac{pfch_2 - pfch_1}{t_2 - t_0}$$

Nisur prej $v_{pixel\_objektit}$ jemi në gjendje të përcaktojmë $v_{cm\_objektit} = v_{pixel\_objektit} \cdot koef_{pixelTOcm}$ si dhe shpejtësinë këndore të rrotullimit të sistemit robotik e cila do të duhet të jetë sa $\varpi_{robotit}$:

$$\varpi_{robotit} = \frac{v_{cm\_objektit}}{D} = \frac{v_{pixel\_objektit} \cdot koef_{pixelTOcm}}{D}$$

ku : D distanca midis kameras dhe objekti në vëzhgim Fig 6.7.



Fig 6.7. *Pamje nga kamera:*
pamja 0 koha $t_0 = 0$, *pamja A koha* t_1 *dhe pamja B koha* t_2 *si dhe objekti në vëzhgim*

Eshtë e kuptueshme se pas çdo pamjeje të marë nga kamera roboti rregullon shpejtësinë këndore, llogaritur sipas formulave të mësipërme duke tentuar të vendosë objektin në vëzhgim në pozicionin e dhënë në pamjen Fig 6.7 - 1.

3. Gjetja e distancës D mund të kryhet duke u bazuar në një nga tre metodat e përshkruara në kapitullin III.
Duke u bazuar në metoda e gjetjes së distancës me ndihmën e kameras dhe një lazeri pikësor të dhënë në Fig 6.8, formula llogaritëse mëposhtëme :

$$D = \frac{h}{\tan(\theta)}$$

Për të përcaktuar distancën e panjohur është e kuptueshme që duhet të njohim këndin θ. Përcaktimi i tij bëhet nëpërmjet formulimeve të mëposhtëme :

$$tg(\theta) = \frac{h}{D}$$

$$\theta = pfc \cdot rpc + r_0$$

ku :

pfc - pika prej qëndrës deri tek projeksioni i objektit.

rpc - radianë për pixel.

r_o - vlerë korrigjuese për mbulimin e gabimit të këndit.

Mund të themi se shprehja llogaritëse përfundimtare do të jetë si më poshtë [6], [7]:

$$pfc \cdot rpc + r_0 = arctg(\frac{h}{D})$$

Përfundimisht mund të shkruajmë :

$$D = \frac{h}{\tan(pfc \cdot rpc + r_0)}$$



Fig 6.8. *Roboti, kamera, lazeri dhe objekti në vëzhgim.*

Madhësia pfc përcaktohet nga analiza e imazheve te siguruara nga kamera.

Madhësitë rpc dhe r_o përcaktohen në mënyrë eksperimentale duke shfrytëzuar distanca të njohura.

4. Vlerësimi i ndryshimit midis vlerës së kërkuar dhe asaj faktike pas përcaktimit të asaj faktike është një proces i thjeshtë. Madhësia përcaktohet si më poshtë :

$$\Delta D = D_0 - D$$

Ku :

D_0 - vlera e kërkuar

D - vlera e faktike

ΔD - ndryshimi midis vlerës së kërkuar dhe asaj faktike

Vlera ΔD pjesëtuar me kohën e këtij ndryshimi do të japë shpejtësinë lineare të nevojshme të robotit për lëvizjet drejtvizore para – prapa.

$$v_{robotit} = \frac{\Delta D}{\Delta t}$$

ose (2)

$$v_{robotit} = \frac{D_0 - D}{\Delta t}$$

Ku Δt përcaktohet nga intervali kohor midis dy pamjeve të kamerës.

5. Eshtë e kuptueshme se drejtim i levizjes rrotulluese dhe asaj para-prapa në Roomba 4400 do të përcaktohet nga llogaritjet e pikave 1, 2 dhe 3.

Kur do të kërkohet rrotullimi i robotit komanda që do të jepet do të jetë :

```
If ObjectIsLeftRightCenter = majtas Then
   ' levizja e robotit duhet kryhet majtas
    SetDriveWheelsCreate -ShpejtesiaLineare, ShpejtesiaLineare
    HistorikLevizje = majtas
    lMessage.AddItem "Levizja majtas (-) " & ShpejtesiaLineare
ElseIf ObjectIsLeftRightCenter = djathtas Then
   ' levizja e robotit duhet kryhet djathtas
    SetDriveWheelsCreate ShpejtesiaLineare, -ShpejtesiaLineare
    HistorikLevizje = djathtas
    lMessage.AddItem "Levizja djathtas (-) " & ShpejtesiaLineare
ElseIf ObjectIsLeftRightCenter = ndaluar Then
    ' stop the robot
    SetFwdVelRadiusRoomba 0, 1
    HistorikLevizje = ndaluar
    lMessage.AddItem "Qendrim ne vend () " & ShpejtesiaLineare
End If
```

Me shkronja italike janë paraqitur komandat për lëvizjen e robotit.

PAISJET PER REALIZIMIN E EKSPERIMENTIT.

Paisjet që u përdorën për kontrollin e pozicionit të sistemit robotik janë paisje standarte të një niveli normal. Sistemi kompjuterik së bashku me sistemin robotik përbëhet prej :

- Toshiba harman/kardon Laptop
- Bluetooth Adaptor Module for PC
- Roomba Model 4400 (iRobot Create)
- Element Direct BAM (Bluetooth Adaptor Module)
- Kamera Model Hamy M200 Wireless Camera
- Pointer Laser

PROGRAMI DHE FUNKSIONALITETI I TIJ

Për të realizuar komandimin e robotit programi i ndërtuar në Visual Basic 6.0 [4] përbëhet nga nje forme (dritare) e paraqitur në Fig 6.9 dhe prej 12 modulesh ku sejcili prej tyre përmban komanda, funksione që lidhen me komunikimin e robotit si dhe funksione ndihmëse të tjera. Funksionimi i programit është i thjeshtë. Në dritaren e portës së komunikimit (Fig 5) zgjidhet numri i portës seriale. Në rastin kur PC lidhet me robotin me ndihmën e kabllit serial, në portën e komunikimit zgjidhet COM1 ose COM2. Kur lidhjen midis PC dhe robotit e kryejmë në mënyrë valore atëhere në portën e komunikimit zgjidhet COM3 – COM8 (kjo zgjedhje përcaktohet nga bluetooth pas instalimit të saj).
Lëvizja manuale e robotit më tej bëhet duke punuar me butonat që si pamje të tyre kanë drejtimin e lëvizjes.



Fig 6.9. *Programi i kontrollit të pozicionit të robotit Roomba 4400 (iRobot Create)*

Funksionimi i programit për kontrollin e distancës është i thjeshtë. Në dritaren e portës së komunikimit (Fig 6.9) klikohet në butoni ‘Aktivizim i sistemit të kameras’ pas së cilës shfaqet pamja e marrë prej kamerës në dritaren e programit. Pas vendosjes së vlerës së kërkuar të distancës

në textbox_in me përshkrimin ‘Distanca nga objektivi’, klikohet te butoni ‘Aktivizim i sistemit të ndjekjes’.

Pas këtij veprimi programi kryhen dy detyra :

- Pozicionon objektin në vëzhgim në mes të pamjes së kamerës duke kryer rrotullime majtas – djathtas në vend.
- Llogarit distancën prej objektit në vëzhgim dhe pas krahasimit me vlerën e kërkuar kryhen lëvizjen para ose prapa të robotit deri sa ndryshimi nga distanca e kërkuar të jetë brenda një kufiri të pranuar si gabim i lejuar.

Modulin kryesor të programit të ndërtuar në Visual Basic 6.0 do e japim në Shtojcën 12.

Si përfundim mund të themi se :

- Nëpërmjet këtij paragrafi u tregua se si mund të realizohet komandimi i robotit prej portës seriale dhe virtuale seriale bluetooth duke shfrytëzuar librarinë e komandave të ndërtuar për këtë qëllim.

- Programi i ndërtuar tregon mënyrën se si mund të kontrollohet pozicioni i robotit kundrejt një objekti të paracaktuar.

- Ekperimentet e kryera tregojnë se algoritmi i ndërtuar mbështetur në idenë e dhënë më lart, funksionon në mënyrë korekte. Probleme shfaqen në rastin e fluktacioneve të dritës në fushën e pamjes së kamerës. Në këto raste humbet pozicioni i objektit në vëzhgim dhe si rezultat programi llogarit vlera të pa sakta për pozicionin. Mënjanimi i vlerave të gabuara në këto raste kryhet nëpërmjet një sistemi krahasimi me vlerat e një hapi përpara. Kur ndryshimet me këto vlera (paraardhëse) janë shumë të thekësuara është e kuptueshme që programi llogaritës ka probleme në gjetjen e objektit në fushën e kamerës.

- Mënjanimi i vlerave të gabuara në raste kur objekti është më i shpejtë se roboti, kryhet nëpërmjet një sistemi krahasimi me vlerat e hapve më përpara. Kur ndryshimet me këto vlera (paraardhëse) vijnë duke u rritur, është e kuptueshme që programi llogaritës ka probleme në gjetjen e objektit në fushën e kamerës ose nuk ka fuqi motorike për ndjekje.

KAPITULLI VII

Hyrje

Rrjetet neurale (NN-të) dhe algoritmat gjenetike (GA-të) janë përdorur nga disa kërkues për të zgjidhur problemin e komandimit të lëvizjeve të robotëve. Në këtë drejtim janë për t’u përmendur punët mjaft të rëndësishme të Mondada & Floreano (1995) [43], Yamada (2005) [44], Capi (2007) [45].

Performanca e një rrjeti neural bazohet në ndërtimin e tij dhe konektimin sinaptik të peshave. Zgjedhja optimale e peshave është një punë jo e lehtë. Algoritmi "back-propagation" është metoda më e mirë për të përmirësuar rrjetin neural, por mund të ketë problemin e minimumit lokal. Metodat si : simulated annealing (SA) (Goffe et al., 1994 [47]), programimi gjenetik (GP) (Koza, 1992 [48]), algoritmat gjenetike (GA) (Goldberg, 1989 [49]) janë përdorur nga disa kërkues për qëllimin e shprehur më sipër. Duhet thënë se GA-të sëbashku me rrjetet neurale kanë shtuar një dimension të ri në fushën e kërkimeve të robotikës, të quajtur robotikë evolucionare (Pratihar, 2003 [46]). Këtu, një strukturë e përshtatshme e rrjetit neural është zhvilluar duke përdorur një GA përmes bashkëveprimeve të përshtatshme me mjedisin. Pratihar (2003) mundësoi një përmbledhje të qartë në aspekte të ndryshme të robotikës evolucionare. Pas zbulimit të avantazheve të lidhjes GA–NN, Hui dhe Pratihar (2004) studiuan performancën e saj për të zgjidhur problemet e navigimit të një roboti si makinë me anë të simulimeve kompjuterike. Ndryshe nga punët më përpara, në eksperimentin e kryer në këtë material, ne marrim parasysh evolucionin e kontrolluesve neuralë për navigimin e robotit në mjedise të caktuara. Në mëtodën që përshkruhet ne vazhdim të këtij kapitulli, ne përpunojmë imazhet ose konvertojmë imazhet e marra në imazhe binare, të cilat më pas përdoren si inpute për kontrolluesin neural.
Pjesa më e madhe e kërkuesve të mësipërm testuan algoritmin e tyre të planifikimit të lëvizjes me anë të simulimeve kompjuterike. Megjithate, rëndësia e zhvillimit të eksperimenteve dukë përdorur robotë të vërtetë për të testuar performancën e planifikimit të lëvizjes është një detyrë që është shtruar nga shumë kërkues. Duhet thënë se simulimi i sensorëve vizualë është shumë i vështirë. Për shkak të kushteve të dritës, kontrolluesit neuralë të zhvilluar në simulim, shpesh kanë një performancë të dobët kur transferohen në robotë të vërtetë. Për të zgjidhur këtë problem, janë zhvilluar kontrolluesit neuralë "online" duke përdorur robotë të vërtetë.

7.1. Teoria e algoritmatve neuronikë (ANN).

Në këtë paragraf do të japim një përshkrim të shkurtër të rrjetave neuronike si dhe algoritmave neuronikë. Qëllimi kryesor është njohja e funksionimit të kontrolluesve neuralë, pra e rrjetave neuronike (NN-të), me qëllimin e vetëm, marrjen e rezultateve sa më të mira në ndjekjen e objekteve të caktuara prej robotit. Informacionet për NN-të sot janë të pafundme, rrjedhojë e një numri shumë të madh kërkuesish në këtë fushë. Materiali në vazhdim mbështetet kryesisht në 'Neural Network Toolbox' të autorëve: Howard Demuth dhe Mark Beale [50].

Ç'janë rrjetat neuronike.

Një rrjet nervor artificial (RNA) është një model i përpunimit të informacionit që është i frymëzuar nga mënyra biologjike se si sistemi nervor dhe sidomos truri, përpunon një informacion. Pika kyçe e këtij modeli është struktura e sistemit të përpunimit të informacionit. Struktura është e formuar nga një numër i madh neuronesh të lidhur me njeri-tjetrin në një mënyrë shumë efektive, të cilët punojnë së bashku për të zgjidhur probleme specifike. Rrjetat neuronike janë grupe neuronesh të organizuara në shtresa. Çdo neuron paraqet një funksion i cili duke vepruar mbi një madhësi në hyrje (input), e cila mund të jetë skalare ose vektoriale jep në dalje (output) një madhësi tjetër gjithashtu skalare ose

vektoriale. Këto output-e varen qoftë nga forma e funksionit transferues, qoftë edhe nga "peshimi" që i jepet vlerave hyrëse, para se mbi to të veprojë funksioni i transferimit.
Disa elemente, me analogët e tyre natyrorë, që do të përdorim në materialin tonë po i paraqesim në vijim :

- Neuronet - analogët e nyjeve nervore.
- Koefiçientët peshë - ekuivalentë të sinapseve nervore.
- Funksionet e transferimit - funksione analogë "imitues" me ata të përpunimit që truri i bën sinjalit nervor.

Një ose disa neurone përbëjnë shtresën neuronike. Disa shtresa neuronike përbëjnë të ashtuquajturën 'Rrjetë Artificiale Neuronike'/ Artificial Neural Networks/ ANN. Neuronet e së njëjtës shtresë nuk lidhen me njëri-tjetrin, ndërkohë që neuronet e shtresave të tjera lidhen midis tyre me anën e peshave neuronike. Sinjali hyrës në një rrjetë neuronike, shpërdahet në të gjithë neuronet e rrjetës njëkohësisht, ashtu si një informacion shpërdahet në nyjet nervore të trurit tonë.
Funksionimi në paralel është tipari kryesor i rrjetave neuronike.
Të gjithë elementët përbërës të rrjetës neuronike do të analizohen më poshtë për të dhënë një ide më të qartë mbi ndërtimin dhe funksionin e tyre.

Neuroni i thjeshtë.

Një neuron i thjeshtë jepet në Fig 7.1. Madhësia në hyrje x e cila përfaqëson një madhësi skalare e cila nëpërmjet një shumëzimi me madhësinë skalare peshë w (weight), jep produktin $w \times x$, përsëri një një madhësi skalare. Produkti $w \times x$ përbën argumentin e funksionit të transferimit f, i cili jep në dalje madhësinë skalare Y. Neuroni i paraqitur në Fig 7.1 është rasti i neuronit më të thjeshtë i cili në një model më të kompletuar jepet në Fig 7.2. Në Fig 7.2 hyrja x e amplifikuar me madhësinë skalare të peshës w, mblidhet nga nyja shumatore me madhësinë skalare $b \times 1$, ku b njihet me emrin devijues (bias). Devijuesi b lidh hyrjen e dytë me koeficient 1 me neuronin. Produkti $w \times x + b$ përbën për këtë rast argumentin e funksionit të transferimit f, i cili jep në dalje madhësinë skalare Y.



Fig 7.1. *Neuroni i thjeshtë (hyrja x-skalare, dalja Y-skalare)*



Fig 7.2. *Neuroni i thjeshtë (hyrja x-skalare, devijuesi b, dalja Y-skalare)*

Funksioni i transferimit f paraqet një funksion linear ose jolinear. Funksionet më të përdorshëm janë hardlim, purelin, sigmoid, tansig etj, që transformojnë hyrjen për të dhënë në dalje madhësinë Y. Madhësitë w dhe b janë parametra rregullues të neuronit.
Në Fig 7.3 jepet modeli i një neuroni më të zhvilluar që ofron akoma më shumë me neuronet e trurit.



Fig 7.3. *Neuroni (hyrja X-vektoriale, devijuesi b, dalja Y-skalare)*

Në neuron hyrja $X=[x_1 \quad ... \quad x_R]$ përfaqëson një vektor me R elementë, ku secili element në hyrje shumëzohet me peshat përkatëse $w_{1,1}$, .. , $w_{1,R}$ të cilat përbëjnë vektorin e peshave W, dhe produktet shumohen në pikën e takimit. Vektori rresht i peshave $W=[w_{1,1} \quad .. \quad w_{1,R}]$ dhe vektorit kolonë $X=[x_1 \quad ... \quad x_R]'$ shumëzohen dhe më pas mblidhen me madhësinë b, duke përcaktuar madhësinë $W\times X+b$. Kjo e fundit përbën argumentin e funksionit transmetues f i cili në dalje jep madhësinë Y. Duhet thënë se $w_{1,1}$, .. , $w_{1,R}$ njihen me emrin koefiçientët peshë ($\frac{dw}{dt}=0$) ose funksione peshë ($\frac{dw}{dt}\neq 0$) dhe identifikohen si 'sinapset' e rrjetave neuronike. Pra, ashtu si nyjet nervore në trurin e njerut lidhen me anën e sinapseve, tek rrjetat neuronike elementet lidhen me njëri-tjetrin me anën e peshave. Peshat janë vlera fillimisht të vendosura në mënyrë apriori, më tej ato llogariten sipas disa algoritmave të caktuar.

Funksionet e transferimit.

Për sa i takon funksioneve të transferimit mund të themi se lista e plotë e tyre gjendet në mjaft literatura. Në Matlab ai gjendet në librarinë TFG (transfer function graphs).
Funksionet e transferimit më të përdorshme jepen të përshkruara më poshtë :

- Funksioni transferues *hardlim* njihet me emrin funksioni shkallë dhe kufizon vlerat në dalje të neuronit midis 0 dhe 1. Në qoftë se argumenti hyrës në funksionin transferues është ≥ 0 atëhere limiti është 1, në të kundërt kur argumenti hyrës <0, dalja është 0.
- Funksioni i transformimit linear 'Linear Transfer Function'. Neuronet e këtij tipi përdoren si përafrues linearë në filtrat linearë.
$$'\text{purelin}' \rightarrow Linear \rightarrow f(x)=f_0(x)=x$$
- Funksioni i transformimit *sigmoid*, merr në hyrje të gjitha vlerat e intervalit $]-\infty,+\infty[$.

- Për funksionin *logsig* daljet janë në intervalin $]0,1[$.
- Për funksionin *tansig* daljet janë në intervalin $]-1,+1[$.

Funksionet transferues *logsig* dhe *tansig* përdoren shpesh në rrjetat "*feed-forward"* në të cilat përdoret algoritmi i llogaritjes së peshave "*backpropagation*". Meqënëse në këtë algoritëm përdoren derivatet e para të funksioneve transferues, kushti kryesor është që këta funksione të jenë të derivueshëm.

$$\text{'logsig'(Logistic Sigmoid)} \rightarrow f(x) = f_0(x) = \frac{1}{1+e^{-\lambda \cdot x}}$$

$$\text{'tansig'(Hyperbolik Tangent Sigmoid)} \rightarrow f(x) = f_0(x) = \frac{e^{\lambda \cdot x} - e^{-\lambda \cdot x}}{e^{\lambda \cdot x} + e^{-\lambda \cdot x}}$$

Shpesh shënimi i funksionit f zëvendësohet me simbolet e dhëna në Fig 7.4 për të dhënë më qartë rolin e këtyre funksioneve transferues në strukturën e rrjetave neuronike.



Fig 7.4. *Funksionet transferues hardlim, purelin, logsig*

Rrjetat "*feed-forward*"

Rrjetat "*feed-forward"* janë rrjeta që lejojnë sinjalin të kalojë vetëm në një anë, nga hyrja në dalje. Nuk ka kthime mbrapa. Rrjetat "*feed-forward"* kanë tendence të jenë të drejtperdrejta në lidhjen e hyrjeve me daljet. Ato përdoren gjerësisht në trajtimet e problemeve të ndryshme.

Rrjetat "*feedback"*

Rrjetat "*feedback"* mund të kenë sinjale që qarkullojnë në të dy drejtimet. Rrjetat "*feedback"* janë shumë të fuqishme dhe gjithashtu shumë të komplikuara. Ato janë dinamike, gjendja e tyre ndryshon vazhdimisht derisa arrijnë në një gjendje ekuilibri. Qëndrojnë në gjendje ekuilibri derisa të dhënat hyrëse ndryshojnë, e me tej kalohet në një ekuilibër të ri. Arkitekturat "*feedback"* gjithashtu njihen si interactive ose të ripërsëritura, megjithëse termi i fundit shpesh përdoret për të përcaktuar lidhjet "*feedback*" në organizime njështresore.

Ndërtimi i modeleve dhe arkitektura e rrjetës neuronike.

Dy ose më shumë neurone mund të kombinohen në një strukturë që quhet shtresë. Një rrjetë neuronike mund të përmbajë një ose më shumë shtresa të tilla. Në fillim le të trajtojmë një shtresë neuronike me R elementë në hyrje dhe me S neurone në shtresë, si në Fig 7.5.



Fig 7.5. *Rrjeta me një shtresë neuronike.*

Në këtë rrjetë çdo element i vektorit X në hyrje, është lidhur me çdo neuron nëpërmjet matricës peshë W. Elementët e matricës peshë W jepen të organizuar si më poshtë :

$$W = \begin{vmatrix} w_{1,1} & w_{1,2} & \dots & w_{1,R} \\ w_{2,1} & w_{2,2} & \dots & w_{2,R} \\ \dots & \dots & \dots & \dots \\ w_{S,1} & w_{S,2} & \dots & w_{S,R} \end{vmatrix}$$

Indekset e rreshtit në elementet e matricës W tregojnë destinacionin neuronik të peshës, pra indeksi rjesht tregon neuronin me të cilin do të lidhet pesha. Indekset e kolonës tregojnë se kush janë burimet hyrëse të këtyre peshave. Kështu, madhësia $w_{m,n}$ përcakton peshën që lidh meuronin e m-të me hyrjen e n-të. Vektori X është me përmasa $R \times 1$, vektori ndikues b me përmasa $S \times 1$ dhe matrica W me përmasa $S \times R$. Çdo shtresë ka një matricë peshë W, një vektor ndikues b, dhe vektorin që merret në dalje Y. Për të bërë dallimin midis matricave peshë W, vektorëve ndikues b, vektorëve dalës Y dhe funksioneve të transferimit f të shtresave të ndryshme, do t'u shtojmë këtyre vektorëve dhe matricave nga një indeks në pjesën lart i cili do të tregojë numrin e shtresës së cilës i përket variabli që na intereson. Kjo bëhet pasi duhet të bëjmë një dallim midis matricave peshë të cilat janë të lidhura në hyrje dhe matricave peshë që janë të lidhura midis shtresave, gjithashtu duhet të identifikojmë burimin dhe destinacionin për një matricë peshë. Do të emërtojmë matrica peshë të lidhura në hyrje si pesha hyrëse dhe do të emërtojmë pesha të shtresës matricat

peshë që dalin nga shtresat. Do të përdorim indekset lart për të identifikuar burimin (indeksi i dytë) dhe destinacionin (indeksi i parë) për peshat e ndryshme dhe elementë të tjerë të rrjetës.



$$Y^1 = f^1(IW^{1,1} \times X + b^1)$$

Fig 7.6. *Rrjeta me një shtresë neuronike e grupuar.*

Në Fig 7.6 përshkruhet një shtresë neuronike dhe pikërisht shtresa e parë së bashku me elementet e saj si :

- Matrica peshë e lidhur me vektorin X si matrica peshë hyrëse (Input Weight matrix $IW^{1,1}$, matrica me peshat fillestare që lidhen me vlerat hyrëse) që ka si burim 1 dhe si destinacion 1.
- Vektorët b, n dhe X kanë indeksin 1 lart për të treguar se të gjithë këta elementë i përkasin shtresës së parë.

Shënimi që përdoret në këtë rast në Matlab për një peshë të dhënë është :

$$IW^{1,1} \rightarrow net.IW\{1,1\}$$

Llogaritja e madhësisë pas shumatores do të kryhej nga kodi i dhënë në vazhdim :

$$n\{1\} = net.IW\{1,1\} * X + net.b\{1,1\};$$

Në Fig 7.7 jepen rrjeta neuronike tre shtresore me të gjithë elementët e saj. Mund të bëjmë një ndarje në disa pjesë të rrjetës si vijon :

- Hyrjet
- Shtresa 1 ose shtresa hyrëse në rrjetë.
- Shtresa 2 ose shtresa e fshehur.
- Shtresa 3 ose shtresa dalëse në rrjetë.
- Daljet

Vihet re se shtresat janë të lidhura midis tyre në një formë të tillë që daljet e njërës shtresë janë hyrje për shtresën tjetër. Shtresat kanë numër të ndryshëm neuronesh, kështu p.sh. shtresa hyrëse ka S^1 neurone, shtresa e dytë ka S^2 neurone dhe e treta S^3. Mardhëniet midis madhësive në dalje kundrejt atyre në hyrje përshkruhen nga ekuacionet e mëposhtme :

Shtresa 1 : $Y^1 = f^1(IW^{1,1} \times X + b^1)$

Shtresa 2 : $Y^2 = f^2(LW^{2,1} \times Y^1 + b^2)$

Shtresa 3 : $Y^3 = f^3(LW^{3,2} \times Y^2 + b^3)$

Mardhënien midis daljes dhe hyrjes, duke u mbështetur në ekuacionet e mesipërme, e shprehim në formën e dhënë më poshtë :

$$Y^3 = f^3(LW^{3,2} \times (f^2(LW^{2,1} \times (f^1(IW^{1,1} \times X + b^1)) + b^2)) + b^3)$$



$$Y^1 = f^1(IW^{1,1} \times X + b^1);\ \ Y^2 = f^2(LW^{2,1} \times Y^1 + b^2);\ \ Y^3 = f^3(LW^{3,2} \times Y^2 + b^3)$$

$$Y^3 = f^3(LW^{3,2} \times (f^2(LW^{2,1} \times (f^1(IW^{1,1} \times X + b^1)) + b^2)) + b^3)$$

Fig 7.7. *Rrjeta neuronike tre shtresore.*

Në Fig 7.8 jepet rrjeta neuronike tre shtresore e grupuar duke përshkruar madhesitë vektoriale dhe matricore me përmasat e tyre.



$$Y^1 = f^1(IW^{1,1} \times X + b^1);\ \ Y^2 = f^2(LW^{2,1} \times Y^1 + b^2);\ \ Y^3 = f^3(LW^{3,2} \times Y^2 + b^3)$$

$$Y^3 = f^3(LW^{3,2} \times (f^2(LW^{2,1} \times (f^1(IW^{1,1} \times X + b^1)) + b^2)) + b^3)$$

Fig 7.8. *Rrjeta neuronike tre shtresore e grupuar.*

Si përfundim mund të themi se rrjetat janë kombinim i neuroneve pra i peshave, vektorëve zhvendosës, funksioneve të transferimit etj. Por e veçanta në ndërtimin e rrjetës qëndron në funksionin që ajo do të kryejë. Nisur nga ky funksion, rrjetat klasifikohen në rrjetat e perceptimit,

rrjetat e parashikimit etj. Këto të fundit janë përdorur në studimin tonë dhe do të trajtohen gjërësisht.

Rrjeti neural në zgjidhje të një detyre të caktuar.

Për të bërë një rrjet neural që performon një detyrë të caktuar, duhet të zgjedhim sesi janë të lidhura njësitë me njëra-tjetrën dhënë në Fig 7.7, Fig 7.8 dhe duhet të vendosim në mënyrën e duhur peshat në këto lidhje. Lidhjet vendosin nëse është e mundur që një njësi të ndikojë mbi një tjetër. Peshat përcaktojnë fuqinë e ndikimit.
Ne mund të "mësojmë" një rrjet neural prej tre shtresash të bëjë një detyrë të caktuar duke përdorur procedurën e mëposhtme :

- I "*prezantojmë*" rrjetit shembuj trajnimi, të cilët konsistojnë në formën e aktivitetit të njësive hyrëse (inputs) se bashku me formën e dëshiruar të aktivitetit të njësive dalëse (outputs).
- Përcaktojmë se sa afër output-it aktual të rrjetit janë output-et e dëshiruara.
- Ndryshojmë peshat e lidhjeve në mënyrë që rrjeti të prodhojë në mënyrë më të përafërt output-in e kërkuar.

Për të trajnuar rrjetin, ne japim një gjendje hyrjeje dhe e krahasojmë aktivitetin aktual të daljeve me aktivitetin e dëshiruar. Më pas llogarisim gabimin, që shprehet si katrori i ndryshimit midis aktivitetit actual dhe atij të dëshiruar. Më pas ne ndryshojmë peshat e çdo lidhjeje në mënyrë që të zvogëlojmë gabimin. E përsërisim këtë proçes për hyrje të ndryshme deri kur rrjeti të arrijë që të klasifikoje çdo dalje në mënyrën e duhur.
Për ta implementuar këtë procedure ne duhet të llogarisim ndryshimin e gabimit për peshën (EW) në mënyrë që të ndryshojmë peshën në një masë e cila do të jetë në përpjestim të drejtë me shkallën me të cilin ndryshon gabimi, ndërkohë që ndryshon dhe pesha. Një mënyrë për të llogaritur EW-në është duke influencuar nga pak në vlerat e peshave duke vëzhguar se si ndryshon gabimi. Por kjo mënyrë është e pamjaftueshme sepse kërkon një influencim të veçantë në secilën peshë.
Një mënyrë tjetër për të llogaritur EW-në është duke përdorur algoritmin "*back-propagation*" i cili është përshkruar më poshtë dhe në ditët e sotme është një nga mënyrat më të mira për të trajnuar rrjetet neurale. Ky algoritëm është zhvilluar në mënyrë të pavarur nga dy skuadra, njëra : Fogelman-Soulie, Gallinari dhe Le Cun në Francë dhe tjetra : Rumelhart, Hinton dhe Williams në SH.B.A.

Algoritmi "*Back-propagation*"

Në mënyrë që të trajnohet nje rrjet neural për të performuar një detyrë te caktuar, duhet që të rregullohen peshat e secilës njësi në mënyrë që gabimi midis output-it të dëshiruar dhe atij aktual të zvogëlohet. Kjo diferencë shënohet shkurtimisht me EA. Për këtë duhet që rrjetat neurale të llogarisin ndryshimin e gabimeve të peshave (EW-ve) d.m.th të llogaritin sesi ndryshon gabimi (EA-ja) me rritjen ose uljen e secilës peshë. Algoritmi "*back-propagation*" është metoda më e përdorur për të përcaktuar EW-në.
Algoritmi "*back-propagation*" është më i lehtë për t'u kuptuar sikur të gjitha njësitë e rrjetit të ishin lineare. Algoritmi llogarit çdo EW-vë duke llogaritur si fillim EA-në, ritmin me të cilin ndryshon gabimi ndërsa aktiviteti i një njësie ndryshon. Për njësitë dalëse, EA-ja është thjesht diferenca midis output-it aktual dhe atij të dëshiruar. Për të llogaritur EA-në për një njësi të fshehur në shtresën para shtresës së output-it, ne si fillim identifikojmë të gjitha peshat midis asaj njësie të fshehur dhe njësive dalëse me të cilat është e lidhur. Më pas i shumëzojmë ato pesha me EA-të e atyre njësive dalëse dhe mbledhim prodhimet. Kjo shumë është e barabartë me EA-në e njësisë së fshehtë. Pasi

kemi llogaritur të gjitha EA-të në shtresën e fshehtë përpara shtresës së output-it, ne mund të llogarisim EA-të për shtresat e tjera, duke lëvizur nga shtresa në shtresë në drejtim të kundërt me shpërhapjen e aktivitetit të rrjetit. Prej këtej e merr emrin dhe ky algoritëm. Në çastin që kemi llogaritur EA-në për një njësi, mund të llogarisim EW-të për çdo lidhje të ardhshme të njësisë. EW-ja është prodhimi i EA-së dhe aktivitetit të lidhjeve pasuese.
Duhet vene re që për njësi jo lineare, algoritmi "*back-propagation*" ka nevojë për hapa shtesë [54].

7.2. Teoria e algoritmatve gjenetikë (GA).

Algoritmi Gjenetik (GA) është një algoritëm optimizimi me disa përdorime të rëndësishme në fusha të ndryshme të teknikës. Algoritmi gjenetik bazohet parimisht në teorinë klasike të evolucionit të Darwinit, në teorinë e seleksionimit natyral të Weismannit dhe konceptin e gjenetikës së Mendelit, të cilat së bashku njihen si teoria Neo-Darwiniane [51].
Neo-Darwinismi bazohet në proceset e riprodhimit, mutacionit dhe selektimit. Aftësia për të riprodhuar është një cilësi thelbësore e jetës. Aftësia për të ndryshuar (mutacioni) garantohet në çdo organizëm të gjallë që riprodhon veten në një mjedis që ndryshon vazhdimisht. Proçeset e selektimit zenë vend në botën natyrale ku popullata që zgjerohen të llojeve të ndryshme kufizohen në një hapsirë të fundme.
Në vitet 1970 John Holland prezantoi konceptin e algoritmave gjenetike (GA). Qëllimi i tij që të realizonte nëpërmjet kompjuterit procese përzgjedhjesh dhe evolucioni, të njëjta si ato që realizohen prej natyrës. Algoritmat Gjenetike të dhënë nga Holland mund të paraqiten nëpërmjet një procedure për kalimin nga një popullatë e "kromozomeve" artificiale tek një popullatë e re. Ky algoritëm përdor selektimin "natyror" dhe teknika të përdorura nga gjenetika të njohura si crossover (kryqëzimi) dhe mutacion (ndyshimet). Çdo kromozon konsiston në një numër "genesh" dhe cdo gen paraqitet me 0 ose 1. Meqënese GA-të përdorin një metodë kërkimi stokastik, përshtatshmëria e një popullate mund të mbetet e pandryshueshme për një numër të gjeneratave përpara se të shfaqet një kromozom superior. Kjo në disa raste e bën problematik plotësimin e një kriteri përfundimtar. Një praktikë e zakonshme është të përfundosh algoritmin gjenetik pas një numri të përcaktuar të gjeneratave dhe pastaj të zgjedhësh kromozomet më të mira në popullatën e fundit. Nëse një zgjidhje e kënaqshme nuk gjendet, algoritmin gjenetik rifillon me një popullatë te re. Algoritmi gjentik siguron mbajtjen konstante të numrit të individëve të popullatës, dhe në të njëjtën kohë siguron përmirësimin e përshtatshmërisë së saj në vlerë mesatare. Gjatë ekzekutimit të algoritmit gjenetik, kryhen dy procese të rëndësishme, përcaktuse ne rezultatin perfundimtar, që njihen si crossover dhe mutacion. Operatori crossover zgjedh rastësisht një pozicion te të dy kromozonet 'prinder'dhe më tej shkëmben informacioni pas këtij pozicioni. Si rezultat krijohen dy pasardhës të rinj. Vlerësimi i kryqëzimeve jepet zakonisht nga vlera propabilitare 0.7 që konsiderohet një vlerë optimale për ecurinë normale të algoritmit. Nëse një çift kromozomesh nuk kryqëzohen atëhere shfaqen kromozomet e klonuara dhe pasardhësit krijohen kopje të sakta të cdo 'prindi'. Mutacioni i cili ndodh rrallë në natyrë, paraqet një ndryshim në gene, i cili mund të sigurojë përmirësime domethënëse në përshtatshmërinë e individeve, por edhe mund të sjellë rezultate të dëmshme. Mutacioni si një element i rëndësishëm siguron që algoritmi i kërkimit të mos mbetet në një optimum lokal. Hapat e zgjedhjeve të popullatave dhe operacionet crossover mund të ndalin në ndonjë bashkësi homogjene të zgjidhjeve. Nën kushte të tilla të gjitha kromozomet janë identike dhe kështu përshtatshmëria mesatare e popullatës nuk mund të përmirësohet. Pra algoritmi i kërkimit nuk është i aftë të proçedojë më tej. Mutacioni është i njëvlershëm me një kërkim të rastit dhe na ndihmon në shmangien e shkatërrimit të ndryshimeve gjenetike. Mutacionet gjenetike në 'kromozomet' e popullatës janë të ralla dhe kjo shprehet me një propabilitet në kufijtë nga 0.001

deri në 0.01. Algoritmi gjenetik do të përfundojë llogaritjet atëhere kur do të jetë plotësuar një prej dy kritereve të përcaktuara. Kriteri i parë është plotësimi i kushtit i funksionit qëllimor dhe i dyti plotësimi i numrit maksimal të interacioneve të përcaktuara.
Përfundimisht mund të themi se GA-ja vepron nëpërmjet një cikli të thjeshtë të përbërë nga 4 faza siç tregohet në Fig 7.9. Çdo cikël prodhon një brez të ri të zgjidhjeve të mundshme për një problem. Në fazën e parë, një popullsi fillestare me zgjidhje potenciale është krijuar si pikë fillimi për kërkimin. Në fazën pasardhëse, përformanca e çdo individi vlerësohet në bazë të kufizimeve të vendosura nga problemi. Bazuar në performancën e secilit individ, një mekanizëm selektiv zgjedh prindërit për operatorët e kryqëzimit dhe mutacionet. Operatori i kryqëzimit merr dy kromozome dhe shkëmben pjesë të informacionit të tyre gjenetik në mënyrë që të prodhojë kromozome të reja. Operatori i mutacionit krijon struktura të reja në popullsi duke modifikuar në mënyrë rastësore disa nga gjenet, duke ndihmuar në këtë mënyrë algoritmin kërkimor që të arrijë të shmanget nga pengesat e minimumit local. Pasardhësit e prodhuar nga proceset gjenetike të manipulimit janë popullsia e ardhshme e cila do vlerësohet. GA-ja mund të zëvendësojë ose të gjithë popullsinë ose vetëm pjesëtarët më pak të përfshirë. Cikli krijim-vlerësim-zgjedhje-manipulim vazhdon deri kur një zgjidhje e kënaqëshme gjendet ose kur disa kërkesa të tjera takohen. Për çdo teknikë revolucionare duhet një përfaqësim kromozomi për të përshkruar çdo individ në popullatë [52] [53].



Fig 7.9. *Operacionet në GA*

Bllokskema dhe algoritmi për përcaktimin e koefiçientëve të modelit.



Fig 7.10. *Përcaktimi i koeficientëve të modelit me GA*

Funksioni qëllimor për përcaktimin e koeficienteve të modelit mbështetur në algoritmin gjenetik .

Funksionet qëllimore që do të përdoren për përcaktimin e koeficientëve të modelit, nuk do të jenë veçse kritert integrale dhe mesatare të gabimit në përgjigjen në dalje të modelit, të cilat janë jo pak të njohura.

Kriteret integerale dhe mesatare të gabimit shprehen në këto forma:

- Integrali i gabimit kuadratik (IGK) e cila në literaturën e huaj njihet me emrin ISE.

$$IGK = \int_0^\infty \varepsilon^2(t)dt$$

- Integrali i gabimit absolut (IGA) e cila në literaturën e huaj njihet me emrin IAE.

$$IGA = \int_0^\infty |\varepsilon(t)|\, dt$$

- Integrali i gabimit absolut sipas kohës (IGAt) e cila në literaturën e huaj njihet me emrin ITAE.

$$IGAt = \int_0^\infty t \cdot |\varepsilon(t)|\, dt$$

- Integrali i gabimit kuadratik sipas kohës (IGKt) e cila në literaturën e huaj njihet me emrin ITSE.

$$IGKt = \int_0^\infty t \cdot \varepsilon^2(t)dt$$

- Mesatarja e katrorit të gabimit (MKG) e cila në literaturën e huaj njihet me emrin MSE.

$$MSE = \frac{1}{n} \cdot \sum_{t=1}^{n} \varepsilon^2(t)$$

ku $\varepsilon(t) = r(t) - y(t)$

Përdorimi i kësaj teknike do të thotë përcaktimi i koefiçientëve të modelit, në mënyrë të tillë që të minimizojnë IGK , IGA , $IGAt$, $IGKt$ ose MSE .

7.3. Përdorimi i algoritmave neuronikë (ANN) në realizimin e orientimit dhe kontrollit të distancës së iRobot Create prej një objekti në lëvizje.

Përdorim i algoritmave neuronikë në kontrollin e distancës së një roboti prej një objekti në lëvizje lidhet me llogaritjen nëpërmjet tyre të trajektores dhe shpejtësisë të lëvizjes së robotit. Për të realizuar këtë detyre rrjetat neuronike që mund të përdoren janë të ndryshme, në funksion të modelit robotik në përdorim dhe rastit konkret të problemit që do të shtrohet për zgjidhje. Do të trajtojmë dy raste të përdorimit të rrjetave neuronike (NN), që lidhen me problemin në shqyrtim, për llogaritjen e shpejtësive të rrotave të robotit në ndjekjen e një objekti në lëvizje dhe orientimit të lëvizjes së robotit drejt një zonë të paracaktuar.

Llogaritja e shpejtësive të rrotave të robotit në ndjekjen e një objekti në lëvizje me ndihmën e rrjetave neuronike (NN).

Modeli i robotit në shqyrtim jepet në Fig 7.11 për të cilin është folur në kapitujt e mësipërm. Ai përbëhet nga dy rrota të lidhura me dy motorë të pavarur në lëvizjen e tyre. Për të realizuar lëvizjen e robotit, sipas një trajektoreje të caktuar dhe me shpejtësi lëvizjeje të ndryshueshme, mjafton që të kontrollojmë madhësitë v_{majtas} dhe $v_{djathtas}$. Rasti më i përgjithshëm do të qe ai i paraqitur nëpërmjet pamjeve të simulimeve të dhëna në Fig 7.12.



Fig 7.11. *Modeli i robotit.*

Në Fig 7.12 jepen dy objekte të cilët kanë kryer trajektore të pavarura. Objekti me ngjyrë blu përfaqëson objektin lëvizës. Objekti me ngjyrë të kuqe (të plotë), përfaqëson robotin i cili ka për detyrë të qëndrojë në një distancë të caktuar nga objekti lëvizës. Sipas Fig 7.12 është e kuptueshme që pozicionet e qëndrimit të robotit për të ruajtur distancën nga objekti në lëvizje janë të pafundme. Ato teorikisht janë në të gjitha pikat e rrethit me rreze sa distanca e kërkuar me qendër objektin lëvizës. Praktikisht për modelin në shqyrtim pozicionet e qëndrimit të robotit janë në harkun që kalon nëpër qendrën e rrathëve të kuq të pa mbushur, brenda zonës së pamjes së kameras (zona me blu të çelët). Rrathët e kuq të vegjel përfaqësojnë disa pozicionime të robotit kundrejt objektit lëvizës. Përfundimisht mund të themi se pozicioni i robotit kundrejt objektit do të përcaktohet nga dy parametra : distanca e kërkuar dhe nga këndi kundrejt objektit lëvizës. Në simulimet dhe realizimet ekperimentale do të kryejmë kontrollin e distancës për tre mundësi pozicionimi të robotit kundrejt objektit :

- në të majtë të objektit.
- në qendër të objektit.
- në të djathtë të objektit.



Fig 7.12. *Simulimi i ndjekjes prej robotit i një objekti në lëvizje.*

Rrjeta neuronike (NN) që do të përdorim në këtë rast do të jetë një rrjete model NN (input 3/ hidden 3 / output 2). Ajo do të ketë në hyrje (inputs) tre madhësi : distancën (distance), këndin (angle) dhe drejtimin (direction) të konvertuara në njësi relative në përputhje me kërkesat e NN për shtresën hyrëse të përbërë nga tre neurone, një shtresë të fshehur me tre neurone dhe në dalje një shtresë me dy neurone, pra dy dalje që janë madhësitë v_{majtas} dhe $v_{djathtas}$ për rotat e robotit. Vlerat në dalje konvertohen në $\frac{cm}{sek}$ përfundimisht. Rrjeta neuronike (NN) e përdorur jepet në Fig 7.13.



Fig 7.13. *Rrjeta neuronike e përdorur për kontrollin e shpejtësisë së rrotave, në kontrollin e distancës.*

Programi që realizon në Matlab 2013b llogaritjen e madhësive në dalje prej atyre të hyrjes dhe peshave të rrjetës $W\_i\_h(15)$ jepet në vijim :

```
% Funksioni i ndertuar per llogaritjen e NN.
% nn = struct('W_i_h',[], 'nr_i',3, 'nr_h',3, 'nr_o',2);
% W_i_h(1:1:15) - peshat
% nr_i - numri i neuroneve ne shtresen e hyrjes (distanca, kendi, drejtimi)
% nr_h - numri i neuroneve ne shtresen e fshehur
% nr_o - numri i neuroneve ne shtresen e daljes (Vmajtas, Vdjathtas)

%function [aVelL, aVelR, n_act]=NN_A(nn, MaxSpeed)
function [aVelL, aVelR]=NN_A(nn, MaxSpeed)

for i=1:nn.nr_h
   Out_H(i)=0;
   for j=1:nn.nr_i
       Out_H(i)=Out_H(i)+nn.Input_V(j)*nn.W_i_h(i,j);
   end
```

```
    Out_H(i)=logsig(Out_H(i));
end

for i=1:nn.nr_o
  Out_Sum(i)=0;

  for j=1:nn.nr_h
    Out_Sum(i)=Out_Sum(i)+Out_H(j)*nn.W_h_o(i,j);
  end
  if i==1
     aVelR=MaxSpeed*logsig(Out_Sum(i));
  else
     aVelL=MaxSpeed*logsig(Out_Sum(i));
  end
end
%n_act=[nn.Input_V Out_H logsig(Out_Sum(1)) logsig(Out_Sum(2))];
```

Bllok-skema bazë që realizon ndjekjen e një objekti në lëvizje me ndihmën e rrjetave neuronike (NN) jepet në Fig 7.14.



Fig 7.14. *Ndjekja e një objekti në lëvizje me ndihmën e rrjetave neuronike (NN)*

Që një sistem i tillë i përshkruar të funksionojë duke plotësuar kërkesat e shtruara është absolutisht i domosdoshëm zgjedhja e saktë e peshave të duhura për rrjetin neural (NN) të zgjedhur. Gjetja e vlerave të sakta të tyre është një detyrë jo e lehtë, të cila për rastin konkret llogariten sipas algoritmit gjenetik (GA).

Programin e ndërtuar në Matlab2013b do e japim në Shtojcën 13.

Orientimi i lëvizjes së robotit drejt një zone të paracaktuar me ndihmën e rrjetave neuronike (NN).

Një rast i rëndësishëm që lidhet me orjentimin e lëvizjes së robotit drejt një zone destinacion sipas rrugës më të shkurtër, përshkruhet nëpërmjet Fig 7.18. Eshtë e kuptueshme dhe pa asnjë diskutim se të gjithë do të ndërtonin një drejtëz që lidh robotin me zonën destinacion për të treguar rrugën më të shkurtër.



Fig 7.15. *Orjentimet e lëvizjes drejt një zone destinacion.*

Problemi do të ndërlikohej nqs në këtë rrugë do të shfaqeshin pengesa për robotin. Në këtë rast do të kërkohej që ato të anash kaloheshin. Kjo do të siguronte që roboti të arrinte në destinacion sipas rrugës më të shkurtër. Kjo pjesë do të përbënte për ne një sfide që do të qe punë e së ardhmes. Në pjesën në vazhdim do të tregojmë se si përdoren rrjetat neural (NN) në orientimin e lëvizjes së robotit drej zonës destinacion, kur mungojnë pengesat në rrugën e robotit.
Rrjeta neuronike (NN) që do të përdorim në këtë rast do të jetë një rrjete model NN (input 2/ hidden 4 / output 4). Ajo do të ketë në hyrje (inputs) dy madhësi : rob-x dhe rob-y për shtresën hyrëse të përbërë nga dy neurone, një shtresë të fshehur me katër neurone dhe në dalje një shtresë me katër neurone, pra katër drejtimet e lëvizjes që janë madhësitë $h_{lëviz\_majtas}$, $h_{lëviz\_djathtas}$, $h_{lëviz\_lart}$ dhe $h_{lëviz\_poshtë}$. Rrjeta neuronike (NN) e përdorur jepet në Fig 7.16.



